

KONFERENCA KOMBËTARE

**FORCIMI I SISTEMIT TË MBROJTJES
SË FËMIJËVE, TË RINJVE DHE FAMILJES
NË SHQIPËRI**

Shtator 2007



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale
dhe Shanseve të Barabarta,

unicef 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale
dhe Shanseve të Barabarta,



Raport

Konferenca Kombëtare:
Forcimi i Sistemit të Mbrojtjes
së Fëmijëve, të Rinjve dhe Familjes
në Shqipëri

Përgatiti: Dr. Zana LITA

24 – 25 shtator, 2007

Hotel Tirana

Falënderime

Konferenca Kombëtare: Forcimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve, të Rinjve dhe Familjes në Shqipëri u zhvillua në Tiranë, në datat 24 – 25 shtator, 2007. Konferenca u organizua nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe UNICEF-it në Shqipëri.

Gjate dy ditëve të konferencës, u prezantuan një sërë studimesh, të dhënash, përvojash dhe modelesh. Ne falenderojmë të gjithë pjesëmarrësit për punën e tyre parapërgatitore si dhe për pjesëmarrjen aktive gjatë diskutimeve.

Një falenderim tepër i veçantë është për Z. Kosta Barka, Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Znj. Carrie Auer, Përfaqësuese Diplomatike e UNICEF-it në Shqipëri, të cilët kanë patur një rol të rëndësishëm në nxitjen dhe mbështetjen e nismave të tilla, të cilat kanë kontribuar në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri,

Falënderojme veçanërisht të gjithë prezantuesit për prezantimet e tyre në ditën e parë të konferencës dhe konkretisht:

Znj. Marjeta Zaçe, Z. Jeremy Berland, Znj. Valerie Moretti, Znj. Lantona Sado, Znj. Suela Kusi, Znj. Arda Lazareni, Znj. Bilbil Keraj, Znj. Nikoleta Çapollari; përfaqësuesit e zyrës së Zëvendës Kryeministrit dhe përfaqësuesit e zyrës së Presidentit; anëtarët e Komitetit Këshillimor: Znj. Ilda Poda, Znj. Miranda Pashaj, Z. Gëzim Tushi, Znj. Suzana Sakiqi, Znj. Irena Taga, Znj. Alma Gjurgji, Znj. Eriketa Korini, Znj. Pranvera Kamani, Znj. Elda Kalaja, Znj. Nedime Ceka, Znj. Ariana Çela, Znj. Enila Hasani, Znj. Ogerta Manastirliu, Znj. Anduena Shkurti, Znj. Vasilika Laçi, Znj. Raimonda Bozo, Z. Alex Maouche.

Në mënyrë të veçantë u shprehim mirënjohjen tonë personave që patën një rol shumë të rëndësishëm gjatë diskutimeve në grup, lehtësuesit, personat teknikë dhe raportuesit. Gjithashtu, shprehim falënderimin tonë të veçantë për pjesëmarrësit në grupet e diskutimit.

Stafi i zyrës së UNICEF-it Tiranë ka luajtur një rol të rëndësishëm në lehtësimin e procesit përgatitor të konferencës.

Shprehim mirënjohje të veçantë për Znj. Galit Wolfensohn, UNICEF dhe Znj. Floriana Hima, UNICEF për rolin e tyre të rëndësishëm në këtë nismë.

Përmbajtja

1. Hyrje.....	9
2. Qëllimi i konferencës.....	11
3. Objektivat e konferencës.....	11
4. Programi i konferencës.....	12-14
5. Fillimi i punimeve të Konferencës dhe fjala e Z. Kosta Barka.....	15-17
6. Fjala e Ministrit të Shëndetësisë, Z. Nard Ndoka.....	18-20
7. Fjala e Znj. Carrie Auer, Përfaqësuese e UNICEF-it në Shqipëri.....	21-25
8. Përvojakanadeze, Z.JeremyBerland.....	27-34
9. Angazhimi i Komunitetit në Mbrojtjen e Fëmijëve, Znj. Valeria Moretti.....	35-39
10. Reforma e Mirëqënies Sociale në Shqipëri, Znj. Marjeta Zaçe.....	40-44
11. Mbrojtja sociale e fëmijëve dhe informacioni statistikor, Znj.Lantona Sado.....	45-51
12. Kuadri ligjor shqiptar dhe analiza e zbatimit të dispozitave ligjore lidhur me identifikimin, regjistrimin, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës kundër fëmijëveZnj. Suela Kusi.....	52-57
13. Mekanizmat institucionalë që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, Znj Arda Lazareni.....	58-61
14. Përvoja e zyrës për mbrojtjen e fëmijëve, Bashkia e Kukësit, BilbiKeraj.....	62-66
15. Përvoja e njësisë së mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Bashkia e Korçës, Znj Nikoleta Capollari.....	67-68
16. Seanca pyetje-përgjigje rreth diskutimeve dhe prezantimeve.....	69-71
17. Projekti i Bankës Botërore.....	72-73
18. Konkluzionet rreth diskutimeve të ditës së parë të konferencës.....	74-75
19. Punë në grup sipas sektorëve.....	76
20. Kushtet e Referencës Për Grupet e Punës Sektoriale.....	77-78
21. Pyetje për diskutim në grupin e punës.....	79-80
22. Raste për studim.....	81-82
23. Sektori i Arsimit, Konkluzione dhe Rekomandime.....	83-86
24. Sektori i Shëndetit, Konkluzione dhe Rekomandime.....	87-89
25. Sektori i Drejtësisë, Konkluzione dhe Rekomandime.....	90-95
26. Sektori i Mbrojtjes dhe Policisë, Konkluzione dhe Rekomandime.....	96-103
27. Sektori Ndërsektorial, Konkluzione dhe Rekomandime.....	104-107
28. Seancë pyetje – përgjigje.....	108-110
29. Konkluzione përfundimtare.....	111-112
30. Lista e pjesëmarrësve në Konferencë.....	113-116

Shkurtime

- AK** – Aftësi të Kufizuara
- BB** -Banka Botërore
- BKTF** –Koalicioni të gjithë sëbashku kundër trafikimit të fëmijëve
- DART** – Drejtoria Arsimore Rajonale e Tiranës
- GP** – Grupi i Punës
- KDF** – Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
- ILO-IPEC** - Organizata Botërore e Punës
- INSTAT** – Instituti i Statistikës
- IOM** – International Organisation for Migration (Organizata Botërore për Migracionin)
- ISHP** – Instituti i Shëndetit Publik
- LSMS** – Studimi i Matjes së Standarteve të Jetesës
- MICS** – Studim i treguesve të shumfishtë

MSH	– Ministria e Shëndetësisë
MPCSSH	– Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
NDF	- Nënseksioni për të Drejtat e Fëmijëve, pranë Avokatit të Popullit
NE	– Ndihmë Ekonomike
OBSH	– Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJF	– Organizata JoFitimprurëse
OJQ	– Organizata JoQeveritare
OSBE	– Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PAK	- Persona me Aftësi të Kufizuara
PAMECA	– Police Assistance Mission of the European Community to Albania (Misioni i Asistencës Policore të Komisionit Evropian në Shqipëri)
PBB	- Prodhimi i Brendshëm Bruto
QKPVT	- Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit
QKZHM	– Qendra Kombëtare për Zhvillimin e Fëmijëve
QSHLPI	– Qendra e Shërbimeve Ligjore dhe Praktikave të Integruara
RHS	– Studimi i treguesve të riprodhimit
SciA	– Save the Children Albania (Shpëtoni Fëmijët, Shqipëri)
SIDA	– Agjencia e Zhvillimit Suedez
SRC	– Qendra e Kërkimeve Sociale
SSH	– Specialist i Shërbimeve Psikosociale
SHVF	– Shkalla e Vdekshmërisë Foshnore
TACT	– Transnational Actions against Child Trafficking (Veprimet Transnacionale kundër Trafikimit të Fëmijëve)
TLAS	– Tirana Legal Aid Services (Shërbimet për Ndihmën Ligjore në Tiranë)
UNFPA	– Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNODC	– Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
ZMF	- Zyra për Mbrojtjen e Fëmijëve



Hyrje

Ndryshimet e mëdha politike dhe socio-ekonomike këto 14 vitet e fundit kanë rritur mundësinë e ekspozimit të fëmijëve ndaj fenomeneve si dhuna, shfrytëzimi, abuzimi apo neglizhimi. Ashtu sikurse ka ndodhur në shumë vende në tranzicion, theksi që i është vënë reformave makroekonomike, ka çuar në përkeqësimin e shërbimeve sociale, ndërkohë që në të njëjtën kohë ndryshimet e mëdha demografike i kanë dobësuar rrjetet komunitare tradicionale të mbrojtjes. Për më tepër, presioni ndaj familjeve në nevojë, duke përfshirë rritjen e përjashtimit socio-ekonomik, i kufizojnë mundësitë e tyre për të siguruar një mjedis mbrojtës për fëmijët. Rezultati ka qënë rritja e numrit të fëmijëve të prekur nga dhuna, shfrytëzimi, abuzimi dhe neglizhimi, dhe ulja e kapaciteteve të familjes, komunitetit dhe strukturave shtetërore për t'ju përgjigjur situatës.

Në Shqipëri nuk ekziston një sistem që të funksionojë si i plotë. Ndërkohë që strukturat e mbrojtjes ekzistuese janë të kufizuara, edhe mekanizmat për identifikimin, vlerësimin, referimin dhe sigurimin e shërbimeve të përshtatshme janë të kufizuara për të mos thënë që nuk ekzistojnë. Si rezultat fëmijët, të cilët vuajnë dhunën, shfrytëzimin, abuzimin dhe neglizhimin, janë lënë shpesh jashtë vëmendjes, dhe për ata që janë të identifikuar ekzistojnë shërbime të kufizuara. Qeveria Shqiptare është duke e konsideruar mbrojtjen e fëmijëve si një çështje të rëndësishme, ndërkohë që ky është ende një koncept i ri. Reformat në sektorët kryesorë, përfshirë edhe shërbimet sociale, janë një mundësi unike për të ndihmuar në formësimin e sistemit kombëtar të mbrojtjes të fëmijëve dhe familjes.

Për këtë qëllim, MPCSSHB, në bashkëpunim me UNICEF-in, organizuan Konferencën Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve të Rinjve dhe Familjes në Shqipëri, me synimin që të bashkojnë aktorët kryesorë nga i gjithë vendi që të reflektojnë e analizojnë situatën aktuale të mbrojtjes dhe të formulojnë një vizion për të ardhmen.



Qëllimi i konferencës

- Forcimi i sistemit kombëtar të mbrojtjes të fëmijëve dhe familjes në Shqipëri, duke bashkuar aktorët kryesorë, si një hap i parë në procesin e planifikimit.

Objektivat e konferencës

- Të biem dakort për një kuadër konceptual mbi “mbrojtjen e fëmijëve”;
- Të vlerësojmë Sistemin Kombëtar aktual të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Familjes në Shqipëri, dhe të identifikohen pikat e forta dhe të dobëta;
- Të prezantohen dhe diskutohen modelet e një sistemi mbrojtjeje për fëmijët;
- Të hartohet një listë rekomandimesh të cilat informojnë politikat dhe planifikimin e sektorëve dhe ndërsektorëve përkatës;
- Të sigurohet vullneti i sektorëve kryesorë në qeveri për të trajtuar çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve dhe familjes dhe të identifikohen hapat e mëtejshëm.

4

Programi i konferencës

Dita 1 – E hënë 24 shtator, 2007

09.30-10.00 Regjistrimi i pjesëmarrësve

10.00-10.30 Fjala e mirëseardhjes (Z Koço Barka, Ministër i Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Z Nard Ndoka, Ministër i Shëndetësisë, Znj. Carrie Auer, Përfaqësuese e UNICEF-it, Shqipëri).

10.30 – 10.45 Prezantimi i programit të konferencës (Znj. Galit Wolfensohn, Përgjegjëse për Programin për Mbrojtjen e Fëmijëve)

10.45–11.30 **Seanca I:** Hartimi i një kuadri konceptual të përbashkët mbi mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri.

Lehtësuere: Znj. Marjeta Zaçe, Zv.Ministre e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Diskutim në seancë plenare

Prezantimi 1: Mbrojtja e Fëmijëve, parimet dhe praktikat kryesore–
(Z Jeremy Berland, ekspert)

Prezantimi 2: Mbrojtja e Fëmijëve në praktikë – roli i sektorëve kryesore në Mbrojtjen e Fëmijëve (Dr. Valerie Moretti, eksperte)

11.30-12.00 *Pushim kafeje*

12h00-13.45 **Sesioni II:** Aktualiteti i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri – Hartëzimi dhe mungesat në sistem.

Lehtësues: Z Jeremy Berland, Ekspert.

Diskutim në seancë plenare

Prezantimi 3: Vlerësimi i Reformës së Sistemit të Mirëqënies së Fëmijëve në Shqipëri (Znj. Marjeta Zaçe, ZvMinistre e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta)

Prezantimi 4: Analiza e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve (Znj. Lantona Sado, INSTAT)

Prezantimi 5: Kuadri ligjor i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve (Znj. Suela Kusi, Fakulteti i Shkencave Sociale)

13.45-14.45 *Pushimi i drekës*

14.45-15.45 **Sesioni III:** Vizioni për Sistemin e Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri – Modelet, strategjite dhe strukturat ekzistuese.

Lehtësues: Robert Carr, UNICEF

Diskutim në seancë plenare

Prezantimi 6: Mekanizmat institucional që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (Znj. Arda Lazareni, Sekretariati Teknik, MPÇSSHB)

Prezantimi 7: Shëmbuj të praktikave pozitive në Shqipëri në fushën e mbrojtjes së fëmijëve – Niveli rajonal (Z Bilbil Keraç, Bashkia Kukës dhe Znj. Nikoleta Çapollari, Bashkia e Korçës)

15.45-16.15 *Pushim kafeje*

16.15-17.00 Konkluzione

Përmbledhje e ditës së parë– Planifikimi për të ardhmen e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve (MPÇSSHB)

Prezantim i ditës së dytë – Caktimi në grupet përkatës dhe shpërndarja e fletëve të informacionit

DITA 2 – E martë 25 shtator, 2007

Sesioni IV: Identifikimi i fushave prioritare për të ndërhyrë

09.30-09.40 Hyrje në ditën e dytë dhe ndarja në Grupet e Punës (UNICEF)
Grupi i punës 1: Sektori i shërbimeve sociale

Grupi i punës 2: Sektori arsimit

Grupi i punës 3: Sektori shëndetit

Grupi i punës 4: Sektori i mbrojtjes dhe policisë

Grupi i punës 5: Drejtësia

Grupi i punës 6: Koordinimi ndërsektorial

09.40 – 11.10 Diskutim në Grupe Pune

11.10 – 11.30 *Pushim Kafeje*

11.30 – 13.00 Diskutim në Grupe Pune (vazhdimi)

13.00 – 14.00 *Pushimi i drekës*

14.00 – 15.30 *World Café* - Rishikimi dhe diskutimi i rekomandimeve të Grupeve: Shërbimet Sociale, Arsimit, Shëndeti (30 minuta secili)

15.30 – 16.00 *Pushimi i drekës*

16.00– 17.30 *World Café* - Rishikimi dhe diskutimi i rekomandimeve të Grupeve: Policia, Drejtësia, Ndërsektorial (30 minuta secili)

17.00 - 17.30 Hapat e mëtejshëm dhe konkluzione (MPÇSSHB dhe UNICEF)



Fillimi i punimeve të Konferencës dhe fjala e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barbarta, Z. Kosta Barka

Punimet e konferencës i hapi Zv Ministrja e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Znj. Marjeta Zaçe, e cila, pasi përshëndeti pjesëmarrësit në Konferencë, prezantoi temën e konferencës dhe theksoi rëndësinë e kësaj konference për vetë temën që trajton. Më pas, Znj. Zaçe ja dha fjalën Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barbarta, Z. Kosta Barka, i cili tha:

Të nderuar pjesëmarrës,

Ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë Konferencë, e cila shqyrton, në një këndvështrim të ri, problemin më madhor e parësor të politikave që lidhet me ngritjen dhe forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.

Brenda këtij viti është hera e dytë që mblihdemi dhe diskutojmë në një konferencë kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve dhe natyrisht që, për një çështje të tillë, nuk do të reshtim së punuari asnjëherë.

Ministria e Punës në bashkëpunim dhe me mbështetjen e UNICEF ranë dakord që në këtë konferencë të prezantohen rezultatet e ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendas, lidhur me përmirësimin dhe forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.

Kjo është arsyeja që në këtë auditor, për dy ditë rresht, janë ftuar të marrin pjesë të gjithë aktorët përgjegjës, në nivel qendror dhe vendor, shoqëria civile dhe operatorë të tjerë publik dhe privatë, që janë angazhuar me shërbime të drejtpërdrejta apo që kanë detyrime për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është njohur me rezultatet kryesore e nxjerra nga ekspertët ndërkombëtarë dhe vendas për vlerësimin e situatës aktuale të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, me konsideratat që ato japin për shërbimet që ofrohen si dhe me konkluzionet dhe rekomandimet e tyre për përmirësimin e këtij sistemi në të ardhmen.

Me gjithë punën e nisur në këto dy vitet e fundit për reformimin e sistemit të mbrojtjes sociale, të pagesave dhe shërbimeve, për reduktimin e varfërisë dhe garantimin e përfshirjes sociale, konstatohet se ende mbetet një hendek midis objektivave të përcaktuar në Strategjinë ndërsektoriale të fëmijëve dhe mundësive e përpjekjeve për plotësimin e tyre nga ministritë e linjës dhe strukturat përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor.

Është e nevojshme që të bëhen përmirësime sidomos në çështje që lidhen me ngritjen e një sistemi kombëtar referimi; ngritjen e strukturave dhe përcaktimin e përgjegjësive të tyre; shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e të gjithë këtyre veprimtarive dhe institucioneve që kanë detyrime ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e fëmijëve.

Ndonëse në këto dy vitet e fundit po ngrihen dhe po zhvillohen shërbime të reja komunitare, është rritur pjesëmarrja e pushtetit vendor dhe e shoqërisë civile në ofrimin e tyre, por këto shërbime ende nuk ofrojnë atë që në Evropën perëndimore konsiderohet si një sistem proaktiv i mbrojtjes së fëmijëve.

Për këtë arsye e të tjera, jemi këtu të gjithë së bashku për të diskutuar dhe zhvilluar idetë e reja që ofrojnë studjuesit e huaj dhe profesionistët tanë në terren, lidhur me ndërtimin e një sistemi modern të mbrojtjes së fëmijëve.

Mbrojtja e fëmijëve dhe mirëqenia sociale e tyre është pjesë e programit dhe e prioriteteve të politikave të Qeverisë. Ligji i ri “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i përcakton fëmijët si grupin më parësor që duhet të përfitojnë shërbime sociale, ashtu si dhe fëmijët jetim dhe prindërit që lindin më shumë se dy fëmijë njëherësh mbështeten me pagesa dhe shërbime sociale.

Në strategjinë sektoriale të mbrojtjes sociale, në Strategjitë Kombëtare ndërsektoriale për Fëmijët, për PAK, Strategjinë Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit janë parashikuar objektiva ambiciozë për mbrojtjen e fëmijëve jetimë, fëmijëve me një prind ose pa kujdes prindëror, fëmijët e braktisur të rrugës, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët që punojnë, fëmijët e trafikuar, fëmijët romë, etj.

Në themel të reformimit të sistemit të mbrojtjes sociale qendron filozofia e inkurajimit të politikave sociale parandaluese, duke krijuar kushte për zhvillimin e lirë dhe plotësimin e nevojave për jetesë e zhvillim të të gjithë individëve, grupeve sociale e komuniteteve.

Duke e konsideruar varfërinë si një ndër faktorët kryesorë që lidhet me kujdesin dhe mirërritjen e fëmijëve, në strategjinë sektoriale të mbrojtjes sociale, parashikohet që, në vitin 2013, masa mesatare e asistencës sociale të rritet me rreth 4 herë më shumë se sa ajo që jepet aktualisht. Realizimi i këtij

objektivi do të ndikojë në rreth 240 mijë fëmijë që bëjnë pjesë në familjet e varfëra, të cilat aktualisht jetojnë në nivelin e varfërisë absolute, prej 2 \$ për frymë në ditë.

Për fëmijët me aftësi të kufizuara, parashikohet të përshtatet modeli social dhe sistemi ndërkombëtar i klasifikimit dhe vlerësimit të aftësisë së kufizuara me synim plotësimin e nevojave dhe të drejtat për integrim, barazi dhe përfshirje.

Përfundimi i procesit të decentralizimit dhe kalimi i institucioneve rezidenciale të fëmijëve në varësi të pushtetit vendor, fuqizimi i njësive të deinstitutionalizuara për fëmijët dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, ngritja e shërbimeve të reja komunitare për fëmijët dhe shtrirja e tyre edhe në njësitë vendore dhe ato periferike të vendit, përfshirja e shoqërisë civile dhe të ofruesve të tjerë privatë në shërbimet sociale janë komponentët kryesorë të reformës së ndërmarrë.

Gjatë vitit 2006 janë ngritur dhe funksionojnë 10 qendra të reja shërbimesh komunitare për fëmijët dhe po punohet që brenda vitit 2007 të vihen në funksionim edhe 12 shërbime të tjera komunitare. Po ashtu u ngritën 7 modelet e para të shërbimeve në “shtëpi-familje” në Shkodër e Durrës dhe po punohet që ky model të zgjerohet në përputhje me mundësitë që do të krijohen.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në bashkëpunim me UNICEF sapo kanë përfunduar një strategji të veçantë për kujdestarinë si një shërbim alternativ për fëmijët jetim dhe pa kujdes prindëror. Kujdestaria për fëmijët do të pilotohet në qarkun e Tiranës dhe të Shkodrës dhe, duke u bazuar në përvojën e tyre, do të merren masa për shtrirjen e tij edhe në rajone të tjera.

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve në qendrat rezidenciale dhe ditore, “shtëpi-familje” apo kujdestari përbën objektivin kryesor të punës së institucioneve të Ministrisë së Punës dhe të operatorëve publikë dhe privatë që ofrojnë shërbime për fëmijët.

Qeveria ka miratuar standartet e reja të shërbimeve për fëmijët, të cilat tashmë janë bërë pronë e të gjithë ofruesve të shërbimeve, përdoruesve, dhe OJF-ve. Këto standarte janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë operatorët.

Rritja e cilësisë së shërbimeve për fëmijët nëpërmjet zbatimit të standarteve do të monitorohet dhe kontrollohet nga strukturat e inspektoriatit të shërbimeve sociale që veprojnë në nivel qendror dhe vendor.

Më lejoni me këtë rast të falenderoj UNICEF-in për mbështetjen që ka dhënë jo vetëm për hartimin dhe botimin e standarteve për fëmijët, por edhe për rritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve, në qendrat rezidenciale dhe ditore të profesionistëve që janë angazhuar me ofrimin e shërbimeve për fëmijët. Ministria e Punës shpreson që ky bashkëpunim me UNICEF-in do të zhvillohet deri në vitin 2010, në përputhje me marrëveshjen dypalëshe, që kemi nënshkruar.

Gjej rastin të falenderoj të gjithë aktorët e shoqërisë civile, që bashkëpunojnë me Ministrinë e Punës dhe që janë angazhuar me shërbimet sociale për fëmijët.

Gjithashtu, më lejoni të ftoj të gjithë bashkëpunëtorët dhe pjesëmarrësit e tjerë të institucioneve qendrore dhe vendore për të vazhduar bashkëpunimin, për të koordinuar veprimtaritë tona për zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga objektivat e Strategjisë Kombëtare të Fëmijëve, për shkëmbimin e informacionit, raportimin periodik pranë Sekretariatit Teknik të Fëmijëve, me qëllim që së bashku të raportojmë dhe propozojmë politika të reja në Komitetin Ndërmnistror, që drejtohet nga Zëvendëskryeministri, Zoti Oketa.

6

Fjala e Ministrit të Shëndetësisë, Z. Nard Ndoka

Të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni të shpreh gadishmërinë e Ministrisë së Shëndetësisë për të kontribuar në këtë Konferencë mbi këtë temë kaq të rëndësishme “Forcimin e sistemit kombëtar të mbrojtjes së fëmijës”, e cila përbën një detyrim serioz jo vetëm për shëndetësinë por për të gjithë shoqërinë shqiptare.

Shëndeti dhe mirëqenia e fëmijës, si një e drejtë e tyre, është një nga objektivat parësore të punës së kujdesit shëndetësor. Mbrojtja e këtyre të drejtave dhe interesave fillon me mbrojtjen e tyre nga abuzimi, dhuna, keqtrajtimi dhe neglizhenca.

Tashmë, të gjithë e kemi më se të qartë se dhuna ndaj fëmijëve në përgjithësi, e veçanërisht dhuna në familje, është një fenomen që po prek ndjeshëm shoqërinë tonë. Abuzimi, neglizhenca me fëmijën është si një virus që sulmon organizmin e fëmijës dhe e ndryshon atë fizikisht. Më pas, ky virus shumëzohet dhe “ infektimi” krijon një spirale që kalon nga brezi në brez dhe çdo viktimë ka të ngjarë të infektojë gjithnjë e më shumë viktima të tjera. Kjo sepse fëmijët që mbijetojnë abuzimin, kur të rriten, ka shumë gjasa që të abuzojnë, neglizhojnë dhe braktisin fëmijët e tyre.

Dhuna dhe keqtrajtimi i fëmijës nuk duhet konsideruar vetëm si një vepër kriminale. Lufta ndaj tyre është prioritet edhe i shëndetit publik në vendin tonë. Nuk duhet të harrojmë se pasojat dhe efektet në shëndetin fizik dhe mendor, tek një fëmijë të keqtrajtuar,

janë mjaft të rënda dhe vazhdojnë për një kohë të gjatë edhe pasi ai është vendosur në një mjedis të sigurtë.

Dhuna, neglizhenca dhe braktisja e fëmijës mund të prekin shumë aspekte të shëndetit dhe zhvillimit të tij si për shembull: prapambetje në zhvillim fizik, ulje të aftësisë për të mësuar, mundësi që të përvetësojnë sjellje të rrezikshme, shtatzani të padëshiruara tek adoleshentët, abuzim me alkolin dhe lëndët e dëmshme, etj. dhe cikli rritet gjithnjë e më shumë duke ndikuar në jetën e fëmijës dhe të çdo anëtarit të familjes.

Çfarë mund të bëjmë ne për ta ndryshuar këtë situatë?

Mendoj se secili nga ne që ndodhemi sot këtu, duhet të jetë pjesë e zgjidhjes së këtij problemi. Ne duhet të koordinojmë të gjitha përpjekjet dhe burimet tona për parandalimin e këtij fenomeni të dëmshëm për të gjithë shoqërinë tonë. Të gjithë së bashku duhet të kuptojmë se fëmijët janë një vlerë e madhe dhe se duhet të arrijmë në një konsensus për parandalimin e çdo forme dhune dhe abuzimi ndaj tyre. Çdonjëri nga ne duhet të kuptojë se fëmijët janë pasuria jonë më e çmuar dhe ne duhet t'i mbrojmë ata.

Aktualisht, Ministria e Shëndetësisë ka filluar punën për përgatitjen e ndërhyrjeve konkrete që synojnë në parandalimin e pasojave imediate dhe afatgjata të dhunës në familje dhe në veçanti të dhunës ndaj grave dhe fëmijëve, ku përparësi ka parandalimi i dëmtimeve, i sëmundjeve dhe i pasojave shëndetësore që vijnë nga keqtrajtimi i grave dhe fëmijëve.

Personeli ynë i kujdesit shëndetësor ka një rol kyç në parandalimin e këtyre fenomeneve të dëmshme, duke inkurajuar aksesin për kujdes shëndetësor, parandalimin e traumave si rrjedhojë e dhunës, kapjen dhe trajtimin e dëmtimeve dhe abuzimit të fëmijëve, ofrimin e kujdesit parandalues me qëllim që të ndiqet rritja dhe zhvillimi fizik dhe psikomotor.

Strategjitë kryesore për parandalimin e fenomeneve të dhunës, neglizhencës, dhe braktisjes së fëmijëve do të përqëndrohen në:

- rritjen e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor, veçanërisht atij parësor;
- zgjerimin dhe përmirësimin e koordinimit të punës së shërbimeve shëndetësore me ato sociale; përmirësimin e aftësive të personelit shëndetësor për identifikimin dhe trajtimin e problemeve fizike dhe psikologjike që rrjedhin nga abuzimi i fëmijës;
- parandalimin e lindjes së padëshiruara.

Parandalimi i fenomenit të abuzimit dhe braktisjes së fëmijës mund të arrihet më mirë kur përdoren strategji edukimi dhe promovimi që i ndihmojnë prindët të mbrojnë dhe rrisin fëmijët e tyre. Pikërisht këto strategji dhe ndërhyrje, të parashikuara nga Ministria e Shëndetësisë në nivelin e familjes dhe komunitetit, do të synojnë të ndihmojnë prindërit që të plotësojnë nevojat e tyre bazë, të identifikojnë problemet lidhur me abuzimet me drogat, alkolin, abuzimin me bashkëshortin si dhe t'i edukojnë prindërit mbi sjelljen e fëmijës, disiplinën, zhvillimin e tij fizik dhe psikomotor.

Me keqardhje duhet të them se, deri në momentin aktual, shërbimet tona shëndetësore nuk i janë përgjigjur si duhet manaxhimit të rasteve të fëmijëve që janë viktime të keqtrajtimit të dhunës, pasi kjo nuk ka qenë në prioritetet e punës së këtyre shërbimeve. Punonjësit e kujdesit shëndetësor kanë nevojë për trajnime, me qëllim që të rrisin njohuritë për udhëzime dhe protokolle për ndjekjen dhe referimin e rasteve.

Për sa më sipër, aktualisht në kuadrin e reformës së filluar, këtë vit, në kujdesin tonë shëndetësor parësor po përgatite n protokollat e punës së mjekut të familjes dhe paketa e shërbimeve të ofruara nga këto qendra. Në to janë përfshirë edhe ndjekja, trajtimi dhe parandalimi i dhunës ndaj grave dhe

fëmijëve.

Një drejtim tjetër me rëndësi i punës së Ministrisë së Shëndetësisë do të konsistojë në edukimin e familjes dhe komunitetit prej profesionistëve të edukimit dhe promovimit shëndetësor për një prindësi të mirë, çka është mjaft e rëndësishme për zhvillimin e personalitetit të fëmijës, sepse lidhjet e ngushta afektive me një të rritur në vitet e fëmijërisë së hershme dhe dashuria e kujdesi, janë themeli që përcaktojnë një rritje dhe zhvillim të shëndetshëm dhe luftojnë keqtrajtimin, neglizhencën dhe braktisjen e fëmijës.

Së fundi, dëshiroj të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen për UNICEF-in dhe për të gjithë specialistët shqiptarë e të huaj, që kontribuan në përgatitjen e dokumentit mbi analizën e sistemit shqiptar të mbrojtjes së fëmijës. Ky dokument na njeh me gjendjen aktuale dhe problemet që lidhen me sistemin e mbrojtjes së fëmijës në vendin tonë.

Në këtë kuadër, edhe Konferenca e sotme, e cila ka mbledhur të gjithë aktorët dhe partnerët kryesorë të interesuar për forcimin e këtij sistemi, është një mundësi e shkëlqyer për të diskutuar dhe shkëmbyer eksperiencat midis profesionistëve, specialistëve dhe partnerëve tanë kombëtarë dhe ndërkombëtarë lidhur me ndërhyrjet sa më efektive për përmirësimin e sistemit kombëtar të mbrojtjes së fëmijës.

Konkluzionet që do të dalin nga ky takim do të shërbejnë për të përmirësuar më tej ndërhyrjet tona për mbrojtjen e shëndetit të fëmijës dhe në veçanti mbrojtjen e tij nga dhuna, neglizhenca dhe braktisja, sepse shëndeti i vendit dhe i gjithë shoqërisë nuk mund të sigurohet, përsakohë të drejtat e fëmijëve për barazi dhe shëndet nuk janë siguruar plotësisht.

Në përfundim të fjalimit të Ministrit Ndoka, Znj. Zaçe vlerësoi fjalën e tij si një tregues se qeveria shqiptare ka një fizionomi të qartë për mbrojtjen e fëmijëve, duke i cilësuar fëmijët si pasuria më e çmuar e kombit.



Fjala e Znj. Carrie Auer, Përfaqësuese e UNICEF-it në Shqipëri

UNICEF është krenar që organizon për herë të parë një Konferencë Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijës, Rinisë dhe Familjes në partneritet me MPÇSSHB.

Kur hedh sytë rreth e rrotull në sallë shoh shumë fytyra të njohura, njerëz që kanë punuar, për shumë vite, drejtpërsëdrejti për çështjet e mbrojtjes së fëmijës në Shqipëri. Por shoh edhe fytyra të reja, njerëz që kanë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e fëmijës dhe familjes, por që nuk kanë pasur mundësi të koordinojnë punën e tyre me aktorë të tjerë për këtë çështje më parë.

Ju urojmë të gjithëve mirëseardhjen dhe shpresojmë në një angazhim të frutshëm gjatë dy ditëve të konferencës në debate dhe diskutime.

Qëllimi kryesor i kësaj konference është që **të kontribuojë në forcimin e sistemit për mbrojtjen e fëmijëve, rinisë dhe familjes në Shqipëri** duke nxitur debatin, arritjen e një mendimi lidhur me këtë çështje dhe problematikë, dhënia e rekomandimeve sipas sektorëve dhe përfitim të ndihmës nga ana e niveleve të larta të qeverisë për të siguruar që këto rekomandime do të çohen më tej.

Kjo konferencë nuk shihet si qëllim në vetvete, por si një hap i rëndësishëm, ndër shumë hapa të bëra, në procesin e planifikimit të punës. Ne jemi të kënaqur me përfaqësimin e larmishëm dhe në nivele të larta në këtë sallë, gjë që tregon përkushtimin e qeverisë shqiptare dhe Ministrive përkatëse për t'i çuar më tej rekomandimet e kësaj konference. Gjithashtu na gëzon pjesëmarrja e gjerë e aktorëve të shoqërisë civile, të cilët kanë lidhje më të drejtpërdrejta dhe të përditshme me fëmijët dhe familjet e rrezikuara.

Do të dëshëroja të theksoja tri çështje të rëndësishme, të cilat duhet t'i keni parasysh gjatë diskutimeve.

1. Mbrojtja e fëmijëve është përgjegjësi e të gjithëve.

Ndërsa kjo tradicionalisht është e lidhur me sistemin e mirëqënies sociale, që një sistem mbrojtjeje të funksionojë duhet që të gjithë sektorët që kanë lidhje me të si shëndetësia, arsimi, shërbimet sociale, policia dhe drejtësia, të luajnë rolin e tyre – duke e koordinuar punën e tyre.

Një bashkëpunim i tillë midis sektorëve nuk mund të bëhet në mënyrë rastësore, por duhet të institucionalizohet për të siguruar që asnjë fëmijë të mos mbetet jashtë. Ngandonjëherë “përgjegjësia e të gjithëve” do të thotë “përgjegjësia e askujt”. Për t’ju kundërvënë kësaj tendence del nevoja që, urgjentisht, të përcaktohen personat përgjegjës në institucionet që merren me mbrojtjen e fëmijës dhe familjes, në secilin sektor, në nivelin lokal dhe qendror të qeverisjes.

Gjithashtu, është e nevojshme që të përgatiten protokolle të qarta për përgjegjësitë dhe veprimet, me qëllim që njerëzit të jenë të qartë për detyrat e tyre dhe të dinë se ku duhen referuar rastet dhe me kë duhet ta koordinojnë punën.

2. Qeveria lokale duhet të luajë një rol gjithnjë e më të madh në mbrojtjen e fëmijës, në mënyrë të veçantë në kuadrin e decentralizimit. Në punën tonë të përditshme shohim që qeveritë lokale punojnë shumë, por që mundohen shumë për të marrë përgjegjësi të reja. Kjo pjesërisht vjen si rezultat i një mjedisi ku ka paqartësi për procedurat dhe direktivat e reja dhe funksionet administrative, dhe ku burimet njerëzore dhe materiale janë të pakta për të përmbushur detyrat që dalin para. Kërkohej shumë punë për të mbështetur qeverinë lokale, me qëllim që ajo të përmbushë detyrimet e saj në kuadrin e këtyre sfidave.

3. Pa fondet e nevojshme, asnjë nga ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijëve nuk mund të jetë e qëndrueshme. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës dhe familjes duhet të parashikohen në buxhet dhe të mbështeten për një periudhë të gjatë. Në këtë mënyrë, investimi për masat parandaluese nëpërmjet një Sistemi Mbrojtës Kombëtar, në një hark kohor afatgjatë, si në aspektin shoqëror edhe atë financiar, do të jetë më pak i kushtueshëm.

Ditën e parë të konferencës, prezantuesit do të ndalen më gjatë për këto çështje dhe do të krijohet mundësia që ato të diskutohen me sektorët e tjerë, më me hollësi, në ditën e dytë të konferencës.

Konferenca na jep një mundësi ne, përfaqësuesve të sektorëve dhe niveleve të ndryshme administrative, si nga qeveria edhe nga shoqëria civile, të mblidhemi bashkë dhe të shkëmbejmë mendimet dhe përvojat tona të ndryshme, me qëllim që të përcaktohet rruga e duhur për mbrojtjen e fëmijëve dhe familjeve.

Paraprakisht, ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj aktive dhe ju uroj dy ditë të suksesshme, në të cilat do të zhvillohen diskutime dhe debate të rëndësishme.

Duke falënderuar Znj. Auer për fjalën e saj, Znj. Zaçe e cilësoi atë si promotorren për mbrojtjen e fëmijëve pasi ka birësuar dy fëmijë shqiptarë. Më pas fjalën e mori përgjegjësja për programin për mbrojtjen e fëmijëve në UNICEF, Znj. Galit Wolfensohn.

Fillimisht Znj. **Galit Wolfensohn** prezantoi metodologjinë e punës në konferencë, lidhur me çfarë do të bëhej dhe si do bëhej? Diskutimin e saj ajo e filloi me një histori për një fëmijë të gjetur në rrugë dhe të gjitha institucionet, të cilat duhej të merreshin me të, u shmangën nga përgjegjësia. Ajo i sensibilizoi pjesëmarrësit se ka shumë fëmijë që abuzohen në mënyra të ndryshme dhe nuk u jepet mbështetja e duhur.

Më pas Znj. Wolfensohn shpjegoi përse konferencës i është vënë një titull i tillë duke sqaruar se **familja** është shumë e rëndësishme për mbrojtjen e fëmijës. Ajo theksoi se është bërë shumë punë, por mbetet ende shumë për të bërë për të ngritur një sistem që t'i mbështesë këta fëmijë.

Më tej Znj. Wolfensohn iu bëri të njohur pjesëmarrësve në konferencë qëllimet dhe objektivat e konferencës.

QËLLIMI: Të kontribuojë në forcimin e Sistemit Kombëtar të Mbrojtjes së Fëmijës, Rinisë dhe Familjes nëpërmjet:

- arritjes së një kuptimi të përbashkët lidhur me Sistemin Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- vlerësimit të masave aktuale që janë marrë për mbrojtjen e fëmijëve;
- identifikimit të rekomandimeve konkrete dhe masat që duhen marrë në të ardhmen;
- angazhimit në nivele të larta të qeverisë për këtë problem.

Më pas Znj. Wolfensohn shpjegoi axhendën e konferencës.

Dita e parë: Prezantimi në Panel

Seanca I: Zhvillimi i një kuptimi të përbashkët të Sistemit për Mbrojtjen e Fëmijëve;

Seanca II: Vlerësimi i pikave të dobëta dhe boshllëqet në masat që janë marrë deri tani për mbrojtjen e fëmijëve;

Seanca III: Përshkrimi i disa praktikave më të mira duke përvijuar rrugën që do të ndiqet në të ardhmen.

Në ditën e dytë, pjesëmarrësit punuan në grupe pune sektoriale *World Cafe*, dhe konkretisht:

1. Shërbimi social
2. Arsimi
3. Shëndeti
4. Drejtësia
5. Rendi/Policia
6. Ndër-sektoriale

Secilit grup iu kërkua që, në përfundim të punës në grup, të dilte me dy produkte kryesore:

1. Një listë rekomandimesh sektoriale dhe ndërsektoriale (që lidhet me kuadrin ekzistues të politikave)
2. Hartimin e një plani veprimi, i cili të përmbante propozime për hapa konkrete;

Me qëllim që pjesëmarrësit të kishin një koncept të qartë për mbrojtjen e fëmijëve, Znj. Wolfensohn ju referua Nenit 19 të Konventës për Mbrojtjen e Fëmijëve në të cilën thuhet: “Shtetet palë marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e

- **dhunës** fizike apo mendore,
 - lëndimi apo **keqtrajtimi**,
 - **neglizhimi** apo trajtimi neglizhent,
 - nëpërkëmbja apo shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual
- për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindit/prindërve të tij, të përfaqësuesit/përfaqësuesve të tij ligjor/ë ose çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

Kush është përgjegjës për fëmijët?

- prindët dhe
- shteti

Neni 19


- Shteti ka detyrim ta mbrojë fëmijën nga lëndimi;
 - Në raste ekstreme, largim nga lëndimi, por kjo do të ishte zgjidhja e fundit.
- Sektorët kyç: Shërbimi Social, Shëndeti, Arsimi, Rendi/Policia, Drejtësia
 - Autoritetet vendore
 - Shoqëria civile/Orgnizatrat jo-qeveritare
 - Të gjithë ne!

Çfarë do të kuptojmë me masë mbrojtëse?

Sipas Nenit 19 masat mbrojtëse përfshijnë: kohën kur është e përshtatshme mbrojtja, procedurat e efektshme për hartimin e programeve sociale për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi, dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshtatshme më lart, duke përfshirë nëse nevojitet një gjë e tillë, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore, etj.

- Mbështetja e fëmijës në kontekstin e familjes /kujdestarit;
- Parandalimi është kyç për mbrojtjen;
- Sistemi dhe përgjigjia urgjente.

Cilët janë elementët kyç të një Sistemi për Mbrojtjen e Fëmijëve?



Pjesëmarrësve në konferencë iu kërkua t'u përgjigjeshin disa pyetjeve kyç dhe konkretisht:

- Çfarë roli luan sektori ynë në mbrojtjen e fëmijëve? Si mund t'i identifikojmë më mirë detyrat tona dhe si mund t'i përmbushim ato më mirë?
- Cilat janë mekanizmat aktuale për mbrojtjen e fëmijëve? Cilat janë pikat e tyre të forta dhe të dobëta? (legjislacioni, politikat, institucionet, strukturat, pikat fokale, specialistët e kualifikuar, shërbimet)
- Çfarë protokolle referimi, nëse ka, ekzistojnë brenda dhe ndërmjet sektorëve? Si mund të institucionalizohen ato?
- Çfarë nevojitet që të forcojmë masat për mbrojtjen e fëmijëve? Si mund t'i përshtasim masat që marrim me politikat ekzistuese dhe kuadrin institucional?


8

Përvoja kanadeze

Z. Jeremy Berland, Profesor në Universitetin e Viktorias për Kujdesin për Fëmijët dhe të Rinjtë

Z. Jeremy Berland foli për funksionet e mbrojtjes së fëmijëve. Ai theksoi se gjatë përvojës së tij më shumë se 25 vjeçare në këtë fushë nuk ka një juridiksion në planetin tonë që ta zgjidhë këtë çështje përfundimisht. Ai u shpreh se, nisma shqiptare për ngritjen e një sistemi modern për mbrojtjen e fëmijëve do të përfitojë shumë nga hapat pozitive të bëra nga juridiksione të tjera, por do të përfitojë shumë edhe nga mençuria e vetë shqiptarëve lidhur me aspiratat që kanë ata për dhënien e këtyre shërbimeve.

Më pas ai vijoi se “Ngandonjëherë flasim për mirëqenien e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre, si të jenë dy gjëra të njëjtoja. *Mirëqenia e fëmijëve* zakonisht i referohet një sërë shërbimesh për fëmijët, familjet – kujdesi në çerdhe/kopshte, nisma për shëndetin e fëmijës si imunizimi, programet për fëmijërinë e hershme, drejtësia për rininë, shërbime për shëndetin mendor, etj. *Mbrojtja e fëmijëve* është pjesë e këtyre masave por me një fokus më të ngushtë – mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve nga abuzimi dhe neglizhenca.



Është e rëndësishme që, shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve të lokalizohen në një kontekst të gjerë. Grafiku i dhënë në figurën 1 tregon elementët kyç të sistemit për mbrojtjen e fëmijëve, të ndarë sipas strukturave të nevojshme që e mbështesin atë. Ndërsa Dr Moreti, në prezantimin e saj do të përshkruajë tërësinë e lidhjeve të domosdoshme për mbrojtjen e fëmijëve. Këto elemente janë pjesë e ofrimit të drejtpërdrejtë të shërbimeve, por edhe të ndarë prej tyre, e për pasojë, duhet të trajtohen përpara se të bëjmë një përshkrim të hollësishëm të sistemit.

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve duhet të udhëhiqen nga një legjislacion unik dhe specifik. Kompetencat që kërkohen për t’u mbrojtur fëmijët, ngandonjëherë kërkojnë një ndërhyrje të madhe të shtetit. Kompetenca të tilla duhet të forcohen me mbrojtjen e duhur për të drejtat e të gjitha palëve. Përveç kësaj, legjislacioni duhet të shprehet qartë dhe saktë për kushtet se kur mund të ndërhyjë shteti në jetën e fëmijëve dhe familjeve.

Hartimi i legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve duhet të bëhet në mënyrë të tillë, që të nxisë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe organizatave jo-qeveritare. Fëmijët mbrohen më mirë kur ekziston një konsensus i gjerë për parimet mbi të cilat janë ndërtuar legjislacioni dhe janë ofruar shërbimet. Aty ku nuk ka pasur një traditë për ndërhyrjen e shtetit për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe neglizhenca, është e domosdoshme për të arritur një marrëveshje midis qytetarëve lidhur me nevojën për një shërbim të tillë. Legjislacioni është një nga mjetet për të nxitur këtë lloj debati.

Legjislacioni për mbrojtjen e fëmijëve, zakonisht, ka disa parime bazë, mbi të cilat bazohet legjislacioni:

- Përkufizimi se si përcaktohet ajo çka është në të mirë të fëmijës;
- Një kompleks rreziqesh të hollësishme dhe specifike që formojnë bazën për ndërhyrjen – si abuzimi fizik dhe seksual, neglizhenca, nevojja për ndërhyrje mjekësore, braktisja, abuzimi emocional, përfshirja në prostitucion;

- Përcaktimi i qartë i procesit ligjor për të siguruar mbikqyrjen juridike dhe nga komuniteti të veprimeve të ndërmarra për mbrojtjen e fëmijëve;
- Shprehje e qartë e të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë të drejtat e tyre, kur ata janë nën kujdes tjetër;
- Një përshkrim i shërbimeve për familjet dhe mënyrat se si mund t'i ato.

Në çdo juridiksion mund të ndryshojnë arranzhimet legislative, por, këto elementë duhet të jenë të pranishëm, me qëllim që të sigurojnë që shërbimet për mbrojtjen e fëmijës të funksionojnë në mënyrë objektive dhe në përputhje me ligjin.

Nëse komuniteti nuk mbështet shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, do të jetë shumë e vështirë që të realizohen ndryshimet në këtë fushë. Komunitetet mund të marrin role të ndryshme lidhur me mbrojtjen e fëmijës dhe padyshim, shërbimi duhet të ofrohet sa më pranë strukturave të komunitetit lokal. Ekzistenca e shërbimeve mbështetëse dhe jo-statutore është e rëndësishme për t'i mobilizuar të gjithë rreth çështjeve që kanë të bëjnë me abuzimin me fëmijët, dhunën ndaj grave dhe angazhimin e fqinjëve. Shpesh konsensusi i komunitetit arrihet si rezultat i punës që bëjnë grupet lokale. Ndërsa presioni nga grupet komunitare shpesh mund të jetë sfidues, personat që janë në poste qeveritare, zërat e ndryshme që ngrihen si dhe informacioni nga komunitetet mund të ndihmojnë që të arrihen ndryshime të rëndësishme shoqërore.

Një sistem për mbrojtjen e fëmijëve nuk mund të funksionojë pa rrjetin e specialistëve të trajnuar dhe kompetentë. Kjo do të thotë që, ata duhet të trajnohen dhe të arsimohen në programe speciale, të cilat i njohin aftësitë që nevojiten për këtë rol, hera-herës konfliktual. Në të njëjtën kohë, ata profesionistë dhe anëtarë të komunitetit që punojnë me familjet duhet të kuptojnë dinamikën e abuzimit me fëmijët dhe duhet të njohin situatat në të cilat rrezikohen fëmijët. Për këtë arsye, programet për përgatitjen e mësuesve, këshilltarëve, stafit mjekësor dhe atij policor duhet të përmbajnë njohuri mbi mbrojtjen e fëmijëve.

Institucionet publike kanë role të shumëfishta në shoqëri. Përsa i përket mbrojtjes së fëmijëve roli kyç i tyre është që shkollat të krijojnë një mjedis të sigurtë për fëmijët, mësuesit të kenë sjelljen e duhur dhe të identifikojnë fëmijët që mund të jenë të rrezikuar.

Është e rëndësishme që të kuptohet që nuk ka shërbim, dyqan, biznes apo familje që të ekzistojë pa financime. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve shpesh nënvleftësohen, dhe financimi shpesh shihet si përgjegjësi e komunitetit. Shpesh, punonjësit që merren me mirërritjen e fëmijëve nuk arrijnë të japin argumenta bindëse për Ministrinë e Financave që të sigurojnë fonde. Duhet përmirësuar puna në këtë drejtim. Të dhënat e plota të mbështetura në praktika të forta janë më bindëse se sa raportet që bëhen për këtë qëllim.

Sistemi për mbrojtjen e fëmijëve duhet të shkojë drejt një ndërhyrjeje më të madhe në familje. Në shumë raste ka një sërë programesh komunitare që, zakonisht, drejtohen nga vullnetarë. Ka shumë fakte që dëshmojnë se programet më efektive janë ato që operojnë sipas modelit “ndihmo veten”, duke ngritur rrjete në komunitete me njerëz që janë në kushte të njëjta. Këto programe shpesh janë pika fillestare për identifikimin e nevojave në komunitete dhe për të kaluar në programe për ndërgjegjësimin dhe arsimimin e komunitetit. Gjithsesi, gjithmonë është e nevojshme që këto programe të rishikohen me kalimin e kohës pasi, ngandonjëherë, ato vazhdojnë edhe kur nuk ka më nevojë për to. Modifikimi dhe rishikimi i programeve, duke u bazuar në të dhëna të sakta, është një pjesë e rëndësishme për t'i mbajtur shërbimet efektive dhe që ato t'i përgjigjen kërkesave të kohës.

Përsa i përket aspekteve jo-vullnetare apo më shumë ndërhyrëse në sistemin për mbrojtjen e fëmijëve, zakonisht, fillohet me raportimin. Raportimi i detyrueshëm i referohet detyrimit që kanë

qytetarët, duke përfshirë edhe profesionistët në fushën e shëndetësisë, mësuesit dhe oficerët e policisë, për të raportuar tek autoritetet përkatëse kur kanë dijeni që një fëmi ka nevojë për mbrojtje. Pavarësisht se një çështje e tillë trajtohet të politikën shtetërore të shtetit Kanadez dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, problemi i raportimit të detyrueshëm ende nuk është konsoliduar.

Me që kjo çështje mund të tërheqë vëmendjen e publikut, është e rëndësishme që opsionet të peshohen me kujdes dhe të prezantohen në kuadrin e “të drejtave”, me qëllim që të përcaktohet një ekuilibër në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve.

Mekanizmat e raportimit duhet të jenë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta, qofshin këto të detyrueshme ose jo. Nuk duhet të ketë pengesa kur bëhet një kërkesë për shërbim. Më e mira do të ishte nëse raportet ruhen në një bazë të veçantë të dhënash, me qëllim që fëmijët që janë dëmtuar të identifikohen me lehtësi në rast se prindët e tyre lëvizin nga një zonë në tjetrën. Kjo kërkon mbajtjen e saktë të të dhënave dhe kontrollin e tyre. Sistemet nuk duhet të jenë të shtrenjta me qëllim që ato të jenë efikase, por duhet të jenë të përdorshme dhe të kuptueshme për ata që i përdorin. Raportet për mbrojtjen e fëmijëve priten mirë nga njerëzit që njohin mirë kushtet lokale dhe familjet në një zonë të caktuar. Janë shumë të rëndësishme edhe protokollat për marrëdhëniet e punës dhe ndarjen e informacionit midis ofruesve të ndryshëm të shërbimeve si dhe stafit të caktuar posaçërisht për mbrojtjen e fëmijëve.

Një nga ankesat më të mëdha lidhur me raportet në Kanada është se njerëzit, të cilët marrin në telefon, njoftohen pak lidhur me ç’ka ndodh me informacionin e dhënë prej tyre. Duhet mbajtur gjithmonë parasysh se një raport për një fëmi që ka nevojë për mbrojtje nuk do të thotë se fëmija do të largohet nga familja, por vetëm se dikush duhet të shkojë dhe të shohë gjendjen, e më pas t’i ofrohen një sërë shërbimesh, në varësi të rrethanave.

Z Berland solli si shembull një djalë 6 vjeçar, i cili një ditë erdhi në shkollë me sy të mavijosur. Kur mësuesja e pyeti se ç’kishte ndodhur, ai i tregoi se e kishte rrahur i ati. Mësuesi e kishte parë të atin në lagje dhe e dinte se ai shpesh ishte i dehur dhe se familja ishte shumë e varfër. Mësuesi njoftoi autoritetet përkatëse që merreshin me mbrojtjen e fëmijëve duke u thënë si ishte i shqetësuar për fëmijën dhe familjen. Mësuesja ishte e shqetësuar edhe për faktin se, nëse i ati i djalit e merr vesh që ajo e ka raportuar atë, i ati mund të inatosej me të, e ndoshta mund ta dhunonte. Djali kishte frikë që të shkonte në shtëpi. Edhe gjyshërit e tij jetonin në po atë lagje dhe njiheshin nga banorët. Punonjësi që merrej me mbrojtjen e fëmijëve kontrolloi dosjen dhe konstatoi se edhe vitin e kaluar kishte pasur një ankesë të njejtë nga motra e djalit, e cila ishte rrahur, dhe se fëmijët kishin shkuar të jetonin me gjyshërit e tyre, ndërkohë që nëna dhe babai të zgjidhnin problemet që kishin.

Një element qendror i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve është funksionimi i vlerësimit. Për t’ju përgjigjur një raporti, për të hapur apo mbyllur dosjen, për të referuar shërbimet apo për të studjuar nëse është e përshtatshme familja që ka kujdestarinë. Në rast se ka raportime për fëmijë që kanë nevojë për mbrojtje, agjencia duhet të vlerësojë informacionin e dhënë në raport, para se të vendosë që të ndërhyjë. Kjo mund të kërkojë pak kohë, por duhet bërë me qëllim që të shmangen rezultatet tragjike që karakterizojnë raportet për mbrojtje të trajtuara pa kujdes. Duke ditur që ndërhyrja e shtetit mund të jetë shumë kërcënuese për familjet, ndokush mund t’i tejkalojë kompetencat edhe me paramendim.

Duke ju kthyer shembullit me djalin, punonjësi social që merr denoncimin nga prindi duhet të kërkojë informacion shtesë për djalin dhe familjen e tij, gjë që mund ta marrë nga mësuesi. Ky informacion mund të lidhet me pyetje të tilla si: A e ka parë mësuesja djalin të mavijosur më parë? A duhet dërguar ai menjëherë në spital? A kujdesen për të? A vjen ai në shkollë i uritur apo i palarë? A e ka diskutuar mësuesja kujdesin për të me prindët e tij?

Është e rëndësishme që, në rastin e një fëmije të abuzuar, punonjësja sociale që angazhohet në raste të tilla të lexojë çdo informacion të mëparshëm për familjen dhe pastaj të planifikojë bashkë me supervisorin e tij se si t'i qasen familjes. Në një situatë të tillë, mundet që atë natë për djalin të kujdesen gjyshërit, por problemi është se si duhet shtruar ky problem me prindët e tij. Punonjësja sociale merr në telefon policinë dhe diskuton me të situatën dhe bashkarisht hartojnë një plan për të vepruar më tej. Por kur flet me policinë ajo mëson se ata janë në shtëpi, pasi babai ka rrahur edhe nënën e djalit dhe se ajo duhet dëgjuar në spital. Motra e djalit është në shtëpinë e gjyshërve që jetojnë aty pranë, të cilët erdhën për të parë se ç'kishte ndodhur pasi kishin dëgjuar klithma. Si nëna edhe vajza janë shumë të frikësuara.

Punonjësja sociale merr në telefon sërish mësuesen dhe i shpjegon se djali mund të rrijë me gjyshërit dhe i kërkon asaj që mësuesja të rrijë me djalin në shkollë derisa ajo të shkojë ta marrë. Fillimisht, ajo ndalon në shtëpi, policia është larguar dhe e ka arrestuar babanë. Gjyshërit janë ende atje, duke paketuar disa sende. Punonjësja sociale prezantohet dhe mëson se të dy gjyshërit janë të gatshëm që të kujdesen për fëmijët për disa ditë por jo për një kohë të gjatë sepse edhe ata kanë probleme me shëndetin dhe nuk kanë para.

Me mirëkuptimin e gjyshërve për t'u kujdesur për fëmijët përkohësisht, punonjësja sociale mund ta takojë djalin, t'i tregojë për sa ka ndodhur dhe ta dërgojë për një kontroll shëndetësor dhe pastaj ta sjellë përsëri në shtëpinë e gjyshërve të tij. Në këtë situatë të ndërlikuar, punonjësja sociale duhet të marrë një vendim të shpejtë lidhur me gjyshërit. A do të jetë ky një vend i sigurtë për fëmijët? Për çfarë mbështetje kanë nevojë gjyshërit? Sa kohë do të jetë babai në burg? A janë gjyshërit të aftë t'i mbrojnë fëmijët nga babai, në rast se ai dehet dhe shkakton shqetësime?

Përgjigja e disa prej këtyre pyetjeve varet nga vlerësimet që bëhen. Shumë vende përdorin mjete të strukturuar për marrjen e vendimeve të vështira. Disa të tjera mbështeten në gjykimin profesional të stafit të tyre, i mbështetur ky nga një trajnim rigoro. Në të gjitha rastet, vendime të tilla mund të merren vetëm kur ka shumë informacion, kur ai është peshuar mirë, është krahasuar me historinë e familjes dhe është shqyrtuar me objektivitet.

Në shëmbullin që jepet, në vlerësim mund të përfshihen intervistat me policinë, e cila ka ndjekur familjen dhe ka arrestuar babain, personelin mjekësor në spital, nënën kur ajo të jetë në gjendje që të flasë, ofruesit e shërbimeve në komunitet që mund të kenë punuar me familjen, me fëmijët dhe me babain. Me përjashtim të anëtarëve të familjes, grumbullimi i informacionit nga agjencitë që operojnë në komunitet është i lehtë, nëse ekzistojnë protokollet dhe nëse është komunikuar me komunitetin më parë. Përpjekja për të ndërtuar marrdhënie gjatë kohës së krizës zakonisht nuk arrihet. Me krijimin e një panorame të qartë, mund të hartohet plani se si të ndihmohet kjo familje dhe fëmijët të jenë të mbrojtur.

Zakonisht ofrimi i shërbimit bëhet pas vlerësimit. Ofrimi i shërbimit duhet të bëhet në përputhje me planin dhe duhet të pasqyrojë çështjet, problemet, anët e forta dhe sfidat me të cilat përballet familja. Plani duhet të jetë praktik.

Punonjësi social duhet të sigurojë që mund të plotësohen nevojat bazë të familjes – shqim, veshje dhe strehim. E rëndësishme në punën me familjen është që anëtarët e familjes – në këtë rast prindët – të marrin pjesë në hartimin e planit për të trajtuar çështjen DHE për të rënë dakord me hapat e nevojshme për zgjidhjen e problemit.

Në plan duhet të përfshihen afate të qarta kohore, objektivat dhe veprimtaritë dhe të firmosen nga familja. Çdo plan duhet të hartohet duke patur parasysh mundësinë për rivlerësim, me qëllim që të matet përparimi i bërë dhe plani të ndryshohet sipas nevojave. Nëse një OJF ofron një shërbim, ajo duhet të jetë pjesë e këtij planifikimi.

Ngandonjëherë nuk mjafton një plan vullnetar për të mbrojtur fëmijët. Në këto raste, autoriteti që mbron fëmijët duhet të ketë parasysh ndërhyrjet e mundshme ku shkalla e ndërhyrjes të ndryshojë në varësi të situatës. Ngandonjëherë kjo merr formën e një serie pyetjesh që duhen bërë që të maten rreziqet e mundshme dhe pasojat negative të çdo përpjekjeje.

Duke ju referuar shembullit që u soll shtrohet pyetja: Cilat mund të jenë disa nga opsionet? Nëna është në spital por mund të kthehet në shtëpi për dy javë. Babai ka marrë një avokat dhe policia shpeshon që ai do të dalë nga burgu për një javë ndërsa pret të dalë në gjyq. Gjyshërit kanë telashe me mbajtjen e fëmijëve pasi ata grinden dhe nuk ju binden. Nëna i ka treguar punonjës sociale se ajo nuk do që i shoqi të futet në burg pasi ajo ende e do dhe se ai është shumë i sjellshëm me të kur nuk pi. Babai është penduar thellë dhe premtun se nuk do të pijë më kur të dalë nga burgu dhe se do të kujdeset për familjen më shumë.

Aktualisht, duke qenë se fëmijët janë të sigurtë në shtëpinë e gjyshërve, babai në burg dhe nëna në spital, punonjësja sociale duhet të ketë besim se gjërat mund të rregullohen. Megjithatë, babai do të dalë nga burgu për një javë, dhe spitali e ka bërë të qartë se nëna do të dalë nga spitali sapo të ndjehet mirë pasi nuk ka më vende në spital.

Duke u konsultuar me grupin dhe supervizorin, punonjësja sociale i propozon familjes se nëse babai del nga burgu ai do të jetojë me familjen deri kur të dalë nëna nga spitali. Pastaj ai do të vijë bashkë me vëllanë e tij dhe nëna dhe fëmijët do të kthehen në shtëpi. Babai, nëpërmjet një agjencie lokale, do t'i nënshtrohet disa seancave për mospirjen e alkolit dhe do t'i shohë fëmijët vetëm kur të jetë i kthjellët dhe kur të jetë edhe i vëllai i tij.

Punonjësja sociale, prindët, fëmijët dhe gjyshërit bien dakord me këtë plan dhe që punonjësja sociale t'i vizitojë ato herë pas here, për të monitoruar planin dhe për të mbështetur familjen. Punonjësja sociale bisedon veçmas me fëmijët dhe siguron që ata dinë se ç' duhet të bëjnë dhe se ku duhet të kërkojnë ndihmë nëse i ati i dhunon sërish.

Për fat të keq, tri javë më vonë, babai dehet përsëri dhe godet djalin ndërsa ai po përpiquej që ta ndalte tek po godiste nënën e tij. Djali theu hundën dhe pati disa majivosje. Nëna fajëson djalin dhe e justifikon goditjen duke thënë se ai duhej t'ja kishte bërë gati drekën babait kur ai erdhi në shtëpi. Ajo refuzon që të dëshmojë lidhur me goditjen dhe nuk flet as me policinë dhe as me punonjësën sociale për këtë incident.

Edhe në këtë rast, autoriteti për mbrojtjen e fëmijës duhet të zgjedhë se si duhet vepruar. Në këtë rast, është e qartë se nëna nuk është e aftë të mbrojë fëmijët e saj nga babai, dhe se ai nuk mund ta kontrollojë veten. Këtu, mundësitë e punonjësës sociale fillojnë të ngushtohen. Gjyshërit kanë frikë nga nipi dhe thonë që ata nuk mund të kujdesen më për fëmijët. Vendosja tek të afërmit nuk është e mundshme, për shkak të çarjeve që kanë ndodhur në familje si pasojë e kësaj situate. Dashur pa dashur, punonjësja sociale vendos t'i dërgojë fëmijët në një shtëpi kujdestarie, ndërkohë që prindërve u ofrohen disa shërbime.

Me marrjen e vendimit për t'ua hequr prindërve kujdestarinë ndaj fëmijës, autoriteti për mbrojtjen e fëmijës e paraqet rastin në gjyq. Në disa juridiksione ky proces kryhet para se fëmija të largohet, por në situata urgjente, kur fëmija është i rrezikuar, shumë vende parapëlqejnë largimin e fëmijës dhe më pas raportohet në gjyq. Roli i gjyqit në mbrojtjen e fëmijëve është i dyfishtë – të mbrojë të drejtën për mbrojtjen e fëmijës nga dëmtimi DHE të mbrojë prindët nga ndërhyrjet kapricioze të shtetit. Drejtpeshimi i këtyre të dyjave, në raste të caktuara, mund të jetë i vështirë.

Një nga mënyrat në të cilat hartuesit e ligjeve e qartësojnë rolin e gjykatës në mbrojtjen e fëmijëve, është të shprehurit qartë se gjyqtarët duhet të vënë para së gjithash “atë ç’ka është e mirë për fëmijën”. Ngandonjëherë kjo do të thotë drejtpeshim i mirë i faktorëve të ndryshëm para se të merret një vendim. Duke kodifikuar dhe qartësuar ç’ka është në të mirë të fëmijëve, hartuesit e ligjeve mund të kenë parasysh drejtësinë në gjyq dhe të sigurojnë që si fëmijët edhe prindët e tyre të merren në konsideratë dhe të vlerësohen njëlloj nga gjykata.

Kur përcaktohet ajo ç’ka është më e mirë për fëmijën, gjykata mund të peshojë mendimet e fëmijës, lidhjet e tij me çdo person tjetër, historinë e familjës, rëndësinë e vazhdimësisë në jetën e fëmijës, si dhe rrethanat e mundshme që mund të ndryshojnë në familjen e fëmijës. Kjo listë mund të jetë e gjatë, por gjithsesi, si fillim, gjykata duhet të ketë disa nga këto kritere, me qëllim që familjet të kenë një ide të qartë lidhur me atë ç’ka pret shoqëria nga prindët.

Lidhur me gjykatat: ne më shumë na pëlqen që gjërat të zgjidhen jashtë gjykatës. Shumë prindër nuk duan t’i dëmtojnë fëmijët e tyre. Sa më shumë t’i angazhojmë prindët në metodat që mbrojnë fëmijët e tyre, aq më mirë do të jetë edhe për vetë fëmijët.

Nuk ka ndonjë mënyrë magjike për zgjidhjen e problemit të mbrojtjes së fëmijës në familje. Gama e problemeve që ndikon tek fëmijët është shumë e madhe dhe teknikat për zgjidhjen e tyre shpesh mund të mos jenë të gjetura. Çelësi për çdo ofrim shërbimi është hartimi i një plani shërbimi. Sapo shteti ka bërë hapa që të ndërhyjë me forcë në një familje, ai mund t’i trajtojë problemet e identifikuara. Largimi vetëm i fëmijës është vetëm hapi më i vogël për të ndihmuar një familje për të kapërcyer vështirësitë e veta.

Në rastin e shembullit të dhënë më sipër, shërbimet duhet të trajtojnë si rastin e dehjes edhe të dhunës së përdorur nga babai. Pranimi në mënyrë pasive i sjelljes së babait nga ana e nënës ka çuar në dëmtimin e fëmijëve. Nevojitet këshillimi dhe mbështetja për nënën për të gjetur mënyra të ndryshme se si të merret nëna me të shoqin. Fëmijët janë të traumatizuar nga dhuna e gjatë dhe sjellja e tyre ndikon në rritjen jo të mirë të tyre.

Një shërbim i vetëm nuk mund t’i trajtojë të gjitha problemet dhe nuk mund ta ofrojë atë menjëherë. Në një rast të tillë, duhet bërë përcaktimi i rasteve parësore dhe rreziqeve për të siguruar se rastet e duhura marrin mbështetjen e duhur në kohën e duhur. Kur blen shërbimet nga OJQ-të, autoriteti që mbron fëmijën duhet të jetë i qartë për kriteret e referimit dhe nevojën për t’u treguar rezultatet klientëve.

Në disa raste, shërbimet mund të mos arrijnë tek autoriteti për mbrojtjen e fëmijës, por mund t’i kalojnë departamenteve të tjera apo strukturave të tjera të qeverisjes. Në këtë rast, është e rëndësishme që të arrihet një konsensus në komunitet lidhur me protokollet për të siguruar që familjet që kanë nevojë për ndihmë, ta marrin atë në kohën e duhur.

Dhënia e shërbimit është e mirë kur të gjithë që janë të interesuar që të kuptojnë rregullat. Kjo do të thotë që të dish se cili është problemi. Çfarë kërkojmë të rregullojmë? Sa kohë duhet? Si do ta marrim vesh se e kemi përfunduar shërbimin? Çfarë shërbimesh ofrohen gjatë kësaj periudhe? Kërkohe vlerësimi i situatës para dhe pas trajtimit.

Ngandonjëherë shërbimet që nevojiten për trajtim apo rehabilitim nuk ofrohen nëpërmjet kanaleve të zakonshme. Kur vlerësohet që një fëmijë ka nevojë për trajtim të veçantë, plani (dhe ngandonjëherë gjyqi) kërkon që të jepet ky trajtim. Zakonisht, nuk është as praktike dhe as e përballueshme financiarisht që shërbimet e specializuara të jepen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha komunitetet. Mirë është që shërbimet e specializuara të jepen në mënyrë integrale me shërbimet e tjera, sipas metodës shumë-disiplinare. Çdo disiplinë të sjellë për fëmijët apo familjen ato teknika dhe ndërhyrje që ndihmojnë në

riparimin e dëmit. Nuk ka më keq për një specialist, që merret me mbrojtjen e fëmijës, se sa të japë një shërbim të specializuar shumë të kushtueshëm dhe të marrë prej tij vetëm një vlerësim që përmban një informacion të njohur. Për këtë është i nevojshëm një raportim gjatë procesit në një nivel të caktuar, me qëllim që të sigurohet që shërbimet ofrohen dhe që është bërë progres.

Elementi i fundit i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve janë shërbimet e kujdesit apo të birësimit për ata fëmijë që merren nën kujdesin e shtetit. Shteti kurrësi nuk mund t'i zëvendësojë prindët. Ne duhet të veprojmë sikurse do të vepronte një prind ligjor dhe të përpiqemi të zëvendësojmë disa vite të humbura nga jeta e fëmijës. Por, konstatojmë që në shumicën e vendeve, shteti është prind i dobët.

Për t'i prerë rrugën disa të këqijave që mbart zëvendësimi i prindërve, ne përcaktojmë standarde rigorozë për familjet që birësojnë apo kujdesin për fëmijë: informacion për familjen, supervizim, kontroll të rekordeve kriminale dhe trajnim të vazhdueshëm. Këto procedura janë kyç për përgjegjësinë që kërkon publiku nga shërbimet për mbrojtjen e fëmijës. Cilësia e shërbimit duhet të jetë e dukshme për të besuar një shërbim të caktuar. Nëse prindët dhe komuniteti i druhen shërbimit që marrin fëmijët e tyre në institucionet e kujdesit shtetëror, ata nuk do të jenë të gatshëm që të japin ndihmesën e tyre.

Një ndër faktorët kryesorë për të përcaktuar nëse fëmijët do të kthehen në shtëpi pasi kanë marrë kujdesje për një kohë të caktuar, është masa e kontaktit që ata kanë pasur me prindët e tyre ndërkohë që kanë qenë në përkujdesje. Nëse arrihet që prindët dhe fëmijët e tyre të takohen shpesh dhe të ruajnë atë lidhje të rëndësishme, ka më shumë gjasa që kjo lidhje të riparohet.

Unë nuk mendoj që sistemet për mbrojtjen e fëmijës formohen nga qeveritë. Këto sisteme kanë nevojë që të përqafojnë nocionin e të drejtave të fëmijëve, një sistem arsimor të orientuar për nga trajnimi dhe angazhimi i profesionistëve që do të punojnë në këtë fushë, si dhe buxhetet për të mbështetur planifikimin afatgjatë.

9


Angazhimi i Komunitetit në Mbrojtjen e Fëmijëve

Znj. Valeria Moretti, Universiteti i Marilend-it, Itali

Dr. Moretti foli për përfshirjen e komunitetit në përpjekjet që bëhen për mbrojtjen e fëmijëve. Ajo theksoi rëndësinë e raportimit në mbrojtjen e fëmijëve duke ju referuar shembullit që dha Znj. Galite Wolfsohn në prezantimin e saj. Ajo vuri theksin se duhen ngritur shërbimet në sektorë të ndryshëm të qeverisë me qëllim që të mbështetet sistemi për mirërritjen e fëmijëve dhe të krijohen ura lidhëse midis shërbimeve dhe sistemeve të ndryshme.

Znj. Moretti në prezantimin e saj theksoi se në këtë konferencë synohet që të gjenden mënyrat se si të punojnë bashkë të gjitha organizatat që merren me mbrojtjen e fëmijës me qëllim që të arrihet një shërbim sa më i mirë për mbrojtjen e fëmijëve.

Sektorët e ndryshëm që përfshihen në mbrojtjen e fëmijëve



Objektiva të njëjta:

- Ndërtimi i një komuniteti ku çdo fëmijë ndjehet i sigurtë, i dashur dhe i lirë nga dhuna dhe abuzimi;
- Përcaktimi i interesit në të mirë të fëmijëve;
- Siguria dhe qëndrueshmëria në jetën e një fëmije;
- Shërbime të dobishme për fëmijën dhe familjen, në vend të përshtatjes së familjes me shërbimet ekzistuese;
- Ndërhyrje efektive dhe në kohë;

Shërbimet Sociale: Ngandonjëherë nuk arrijmë të kontrollojmë se si bëhen gjërat. Për këtë nevojitet që të bëhet:

- Identifikimi i nevojave të fëmijës;
- Vlerësimi i rasteve dhe krijimi i një baze të dhënash;
- Referimi për nevojat mjekësore/psikologjike të veçanta, kur është e nevojshme;
- Forcimi i programeve të menaxhimit të rasteve nëpërmjet kontrolleve;
- Mbështetja e shërbimeve të tjera (ligji, shkolla, drejtësia) në vlerësimin e një rreziku apo situatë të dyshimtë;
- Intervistimi mjeko-ligjor;
- Ndjekja e përparimit apo përsëritjes;
- Mbyllja e rasteve me vlerësimin e duhur të shkallës së suksesit/dështimit;
- Nxjerrja e statistikave për vlerësimin e tendencave rajonale dhe kombëtare.

Arsimi:

- Sigurimi i një mjedisi të shëndetshëm psikologjik dhe emocional;
- Lehtësimi i njohurive të të drejtave të fëmijëve;
- Promovimi i programeve të Parandalimit (fëmijë dhe të rritur);
- Referimi i një nevojë të veçantë apo një situatë të dyshimtë/të rrezikshme të fëmijës te agjencia e duhur;

- Nxjerrja e statistikave për vlerësimin e tendencave rajonale dhe kombëtare.

Ofruesit e shërbimit shëndetësor:

- Vlerësimi dhe dhënia e mbështetjes fizike, psikologjike dhe emocionale, sipas rradhës së duhur dhe nevojave të fëmijës/familjes;
- Vlerësimi i dhunës/abuzimit dhe referimi tek specialisti/agjencia e duhur;
- Intervistë mjeko-ligjore/vlerësim mjekësor në gjykatë;
- Mjekësia Parandaluese: Kërkimi dhe vlerësimi i tendencave në komunitet;
- Hartimi, vlerësimi dhe propozimi i programeve të parandalimit;
- Nxjerrja e statistikave për vlerësimin e tendencave rajonale dhe kombëtare.

Zbatimi i ligjit: Policia

- Vlerësimi i dhunës/abuzimit dhe referimi tek agjencia e duhur;
- Ndërhyrje efektive dhe e hershme;
- Veprimtari hetimore;
- Zbatimi i dënimeve;
- Mbështetja dhe forcimi i një mjedisi të sigurtë për viktimat dhe komunitetin;
- Nxjerrja e statistikave për vlerësimin e tendencave rajonale dhe kombëtare.

Drejtësia:

- Ndërhyrje efektive dhe e hershme;
- Parandalimi i kriminalitetit duke përdorur të gjithë veprimet disiplinore që kemi;
- Përfshirja e komunitetit me të rinjtë në rrezik dhe delikuentë;
- Mbikqyrja e ecurisë së rasteve sipas fazave;
- Mbështetja dhe forcimi i një mjedisi të sigurtë për viktimat dhe komunitetin;
- Nxjerrja e statistikave për vlerësimin e tendencave rajonale dhe kombëtare.

Nevoja për të punuar bashkë, për të koordinuar forcat dhe përpjekjet. Disa këshilla:

- Mësoni rreth detyrave, metodave të punës, objektivave, personaliteteve të agjencive të tjera;
- Shkruani së bashku dhe qarkulloni një udhëzues pune që të përdoret si referencë;
- Identifikoni personat në agjencitë e tjera;
- Organizoni takime dhe seanca trajnimi si ekip;
- Punoni si një ekip në rastet më të vështira, duke vlerësuar dhe ndërtuar një bazë të përbashkët;
- Vlerësoni progresin ose dështimin e sistemit;
- Njihni komunitetin me agjencitë e ndryshme.

Studim rasti

Helena, 10 vjeç, i tregon mësueses së saj, Znj. Braun, që kushëriri i saj 19 vjeçar e ka prekur në pjesët e saj intime. Mësuesja, pasi dëgjon me kujdes tregimin e Helenës, e vlerëson atë për kurajon e saj dhe i premtun që do ta ndihmojë.

Znj. Braun, flet menjëherë me drejtorin për rrëfimin e Helenës. Përpara se të thërrasë shërbimet sociale, Z Xheksën dëshiron të flasë me vajzën. Helena, duke qarë, i tregon edhe atij se çfarë i kishte ndodhur. Z Xheksën thërret shërbimet sociale dhe familjen, dhe cakton një takim pasdite.

Përpara punonjësit social dhe prindërve të Helenës, Znj. Braun përsërit atë që Helena i kishte thënë në mëngjes. Prindërit, të tronditur nga ajo që dëgjuan, kërkojnë të shohin menjëherë vajzën e tyre. Helenën e sjellin në zyrën e drejtorit dhe, duke u dridhur, ajo përqafton nënën e saj. Me një ton shumë qetësues, punonjësja sociale pyet Helenën si është dhe nëse ndjehet mjaft e fortë t'i tregojë asaj detajet lidhur me ç'ka kishte ndodhur.

Punonjësi social menjëherë hap një dosje mbi abuzimin e Helenës, njofton policinë dhe e shoqëron atë në spital për të bërë një ekzaminim. Në spital, një polic i sjellshëm pret prindërit e Helenës dhe ata denoncojnë nipin e tyre për abuzim seksual të fëmijës. Meqënëse polici duhet të flasë edhe me Helenën, ata vendosin që të bëjnë një takim të gjithë së bashku ditën e nesërme, pasdite, në komisariat, ku Helena do të bënte kallzimin.


Drejtesia vepron shpejt për shkak të moshës së vogël të Helenës dhe, ditën e gjyqit gjykatësi vendos të dëgjojë dëshminë e Helenës në zyrën e tij, duke mos e detyruar atë të dalë në sallë. Helena, edhe një herë, përsërit e lodhur atë që kishte ndodhur.

Falë të gjithë informacionit të mbledhur nga mësuesja, drejtori, punonjësja sociale, polici, dhe gjykatësi, kushëriri i Helenës është në burg dhe ajo ndjehet përsëri e sigurtë.

Ku është gabimi në këtë rast?

- Cili duket të jetë shqetësimi kryesor i secilit?
- Sa herë duhet t'ua përsëriste Helena specialistëve të ndryshëm atë që kishte ndodhur?
- Çfarë ndihme psikologjike iu garantua asaj gjatë procesit?
- A ishte i nevojshëm kontrolli mjekësor fizik?
- A ishte përgatitur ajo siç duhet për gjyqin?
- Cilat janë dështimet e secilës agjenci në trajtimin e këtij rasti?
- Si do mund të punonin ata së bashku për të mirën e Helenës?

Le të përqafojmë fëmijët tanë –



Seanca e dytë e ditës së parë u drejtua nga Z. Jeremy Garland. Fillimisht ai i bëri të ditur pjesëmarërsve në Konferencë botimin e Adresarit Kombëtar të Burimeve në të cilin janë dhënë adresat, numrat e telefonit dhe adresat e e-mail-it të të gjitha institucioneve shtetërore dhe organizatave jo qeveritare që kanë si përgjegjësi apo që janë të angazhuara në problemet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve.

Më pas konferenca vazhdoi me prezantimin e Znj. Marjeta Zaçe, Zv. Ministre e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Ajo u shpreh se kjo çështje është e lidhur ngushtë me zhvillimet politike dhe sociale në Shqipëri.



Reforma e Mirëqënies Sociale në Shqipëri

Znj. Marjeta Zaçe, ZV Ministre e MPÇSSHB

Në Shqipëri vlerësohet se 18.5 % e popullsisë jeton nën nivelin a varfërisë absolute që do të thotë që fëmijët përballen me varfëri, kequshqyerje, etj. Ekziston një pabarazi social ekonomike. Zonat verilindore, si dhe komunitetet rome dhe ato egjiptiane hasin në vështirësi të mëdha. Mungojnë shërbimet parandaluese dhe integruese. Ka një shpërndarje të pabarabartë të të ardhurave. Është e rëndësishme që të përcaktojmë fëmijët në rrezik: fëmijët e rrugës, fëmijët në konflikt me ligjin, etj. Janë bërë studime të ndryshme lidhur me gjetjen e rrugëve për zgjidhjen e problemit. Znj. Zaçe ju drejtua pjesëmarrësve se të gjithë ata janë pjesë e këtyre reformave, e hartimit të strategjisë për këtë problem kaq të rëndësishëm.

Profili i Vëndit

▪ Popullsia (milionë)	3.142
▪ Fëmijë nën 15 vjeç	820,000
▪ PBB për frymë (USD)	2.664
▪ Niveli i papunësisë (%)	14,1
▪ Niveli i varfërisë (%)	18,5
▪ Fëmijë në rrezik:	

- Fëmijë që jetojnë në varfëri të plotë;
- Fëmijë pa kujdes prindëror;
- Fëmijë me aftësi të kufizuara;
- Fëmijë që emigrojnë në vende të tjera pa prindërit e tyre;
- Fëmijë të rrugës. Përveç kësaj, ka fëmijë viktime të dhunës dhe fëmijë në konflikt me ligjin.

Rezultatet Kryesore

Masat:

- Grupet e synuara të fëmijëve;
- Iniciativat dhe aktet kyç të reformës;
- Reforma të planifikimit dhe vendim-marrjes;
- Riorganizimi i shërbimeve zyrtare – “blerja e shërbimeve” dhe “*gate-keeping*” në nivel lokal;
- Decentralizimi;
- Deinstitutionalizimi;
- Shërbimet komunitare;
- Problemet e stafit;
- *Gate-keeping* në nivel kombëtar;
- Ndhimë materiale për fëmijë dhe familje.

Grupet e Fëmijëve

Politikat e mirëqënies sociale që zhvillon Ministria e Punës fokusohen tek fëmijët në nevojë apo të rrezikuar, ku përfshirhen:

- Jetimë apo fëmijë me një prind;
- Fëmijë me aftësi të kufizuara;
- Fëmijë rruge (lypësa, punëtorë rruge, fëmijë të braktisur);
- Fëmijë të dhunuar;
- Fëmijë të ngjuar (gjakmarrje);
- Fëmijë emigrantë të pashoqëruar;
- Fëmijë të trafikuar;
- Fëmijë dhe të rinj të tjerë me probleme: të varur nga droga, të papunë, të përfshirë në vepra penale;
- Fëmijë Romë dhe Egjiptianë;
- Fëmijë që kanë braktisur shkollën.

Iniciativa kryesore të Reformave

- Hartimi i Strategjive dhe planeve të veprimit mbi mbrojtjen e fëmijëve, me mbështetjen e Bankës Botërore;
- Rishikim i vazhdueshëm i Planit të Veprimit bazuar në analizën e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

Janë organizuar takime me aktorë të ndryshëm dhe janë përcaktuar pikat e dobëta se ku duhet ndërhyrë. Nisma të ndryshme janë mbështetur nga donatorët. Donator kryesor ka qenë Banka Botërore, duke i dhënë ndihmë ekonomike dhe teknike organizatave të ndryshme. Nga 37 shërbime rreh 20 prej tyre janë adresuar tek fëmijët. Këto shërbime duhet të fuqizohen dhe të gjejnë mbështetjen e pushtetit lokal.

Reformat e planifikimit dhe vendim-marrjes

Këto reforma duhen bërë ngushtë me komunitetin sepse ata e njohin situatën dhe i dinë problemet më mirë. Këto masa njësohen me parandalimin. Mosnjohja si duhet e problemeve e bën ndërhyrjen të vështirë. Për këtë arsye:

- Fokusi kryesor duhet të jetë kryesisht mbi zhvillimin dhe forcimin e planifikimit dhe vendim-marrjes në nivel rajonal;
- Qeverisja në nivel rajonal dhe kanalet e komunikimit me autoritetet lokale duhet të përmirësohen më tej;
- Strategjia e Shërbimeve Sociale (2005) u jep një rol të rëndësishëm autoriteteve lokale për të rishikuar dhe vlerësuar politikatat përkatëse.

Riorganizimi i shërbimeve zyrtare

Në varësi të situatave të reja që krijohen duhen përcaktuar shërbime të reja dhe ato të pasurohen. Projektet pilot që tashmë kanë nisur duhet të vazhdojnë pasi ato janë të rëndësishme. Ndërkohë ato janë edhe nyja kryesore që përgatit raport progresin për zbatimin e strategjisë për mbrojtjen e fëmijëve. Për këtë arsye:

- Përpjekjet reformuese për blerjen e shërbimeve janë fokusuar në “blerjen e shërbimeve” të reja;
- Janë hartuar Planet e Kujdesit Komunitar;
- Kanë filluar Projektet pilot – Janë ngritur Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (mbështetur nga UNICEF) dhe Komitetet e Monitorimit të Punës së Fëmijëve (mbështetur nga ILO-IPEC).

Decentralizimi

Është e rëndësishme që pushteti lokal të jetë më aktiv, të monitorojë dhe t’i mbështesë qendrat për mbrojtjen e fëmijëve. Mund të ketë kufizime financiare, por rritja e shërbimeve do të kërkojë edhe një mbështetje financiare nga pushteti lokal që do të thotë që, pushteti lokal duhet të manaxhojë më mirë taksat. Është një investim që i shërben së ardhmes. Nisur nga rëndësia që ka ky investim, janë ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- Decentralizimi i shërbimeve sociale, sipas Ligjit të ri të Shërbimeve Sociale.
- Përgjegjësi të shtuara për bashkitë/komunat dhe ngritja e Seksioneve Rajonale të Përkujdesjes Sociale.
- Kufizimet financiare.

Hapi i parë: Transferimi i qendrave të përkujdesjes rezidenciale tek pushteti vendor.

Shërbimet me bazë Komunitetin

Deinstitucionalizimi

Aktualisht problemi është se pushteti lokal nuk i ka dhënë dhënë vëmendjen e duhur këtij problemi.

- Qëllimet e deinstitucionalizimit:
 - Të përmirësojë cilësinë e përkujdesjes në institucionet ekzistuese, dhe

- Të promovojë dhe të zhvillojë alternativa me bazë komunitetin. Për këtë, do të bëhen përpjekje për të krijuar fondin e duhur për mbështetur institucionet ekzistuese.
- Deinstitutionalizimi do të vazhdojë në bazë të buxhetit dhe fondeve të donatorëve.

Hapi i dytë:

- Zhvillimi i shërbimeve me bazë komunitetin, duke e transferuar përgjegjësinë e shërbimeve tek pushteti vendor;
- Përfshirja e organizatave jo-qeveritarë në ofrimin e shërbimeve;
- Mungesa e shërbimeve që synojnë fëmijët dhe prindërit së bashku;
- Shërbimet e kujdestarisë duhet të zhvillohen më tej;
- Krijimi i një Fondi Social për të promovuar zhvillimin e shërbimeve me bazë komunitetin.

Cilësia e Shërbimeve

Për të rritur cilësinë e shërbimeve është punuar në drejtimet e mëposhtëme:

- Standardet e reja të shërbimeve sociale;
- Zhvillimi dhe zbatimi i një numri standartesh;
- Liçensimi i ofruesve të shërbimeve;
- Inspektimi;
- Ngritja e kapaciteteve;
- Sistem i ri për informacionin.

Ministria ka bërë një punë të mirë përgatitore, jo thjesht për përgatitjen e standarteve, por që këto standarte të përcaktohen nga aktorët kryesorë që ofrojnë këto shërbime për të realizuar një mirëritje. Janë bërë përmirësime në liçensimin e ofruesve të shërbimeve. Më parë mjaftoheshin thjesht me paraqitjen e dokumentacionit. Tani në letrën që lëshohet nga pushteti lokal kërkohet edhe se si do të realizohen standartet. Në këtë aspekt po bëhet një punë e programuar duke shmangur spontanitetin. Gjithashtu, i rëndësishëm është edhe sistemi i shërbimit të informacionit. Për garantimin e cilësisë së shërbimeve, një element i rëndësishëm është ndërtimi i kapaciteteve. Ai ndikon në mënyrë të drejtëdrejtë në mbrojtjen e fëmijëve.

Çështje që lidhen me personelin

Sot kërkohet një personel i përgatitur mirë, me qëllim që të garantohet cilësia e shërbimit. Për këtë kërkohet:

- Trajnimi dhe edukimi: Trajnimi të zgjerohet dhe të jetë më i kualifikuar;
- Trajnimi i profesionistëve nga sektorë të ndryshëm.

“Gatekeeping” në Nivel Kombëtar

- Mekanizma të ndryshme gate-keeping (zhvillimi i standarteve, liçensimit dhe inspektimit);

Në Konferencën e Sofies u theksua se, ky mekanizëm kontrollues nuk duhet të jetë në formën e një dënuesi apo mekanizmi për marrjen e masave apo dhënien e sanksioneve. Duhet të monitorohet çdo ofrues shërbimesh, pasi kjo ka të bëjë me cilësinë e shërbimit. Zbatimit të kësaj nisme i duhet kushtuar kujdes i veçantë.

Ndihma materiale për fëmijët dhe familjet

Në qendër të vëmendjes sonë ka qenë cilësia e jetës familjare, me qëllim që fëmijët të kenë kushte të mira në familje. Për këtë ndihma së pari duhet të fillojë me ndihmën që i jepet familjes. 17 % janë familje të varfëra. Prandaj strategjia e ndihmës ekonomike e mbështetur në të dhëna të sakta merr një rëndësi të veçantë.

Është bërë një përcaktim më i saktë i familjeve që marrin ndihmë ekonomike. Shumë familje janë larguar nga skema me që nuk e meritonin atë ndihmë. Programi i ndihmës ekonomike është mbizotërues në dhënien e shërbimeve sociale. Ç' duhet bërë në këtë drejtim?

- Amendime të programit të ndihmës ekonomike, duke synuar përshtatjen e programit me situatën ekonomike dhe sociale të vendit;
- Përzgjedhje më e mirë e personave që janë objekt i ndihmës ekonomike;
- Programi i ndihmës ekonomike është akoma më i madh se dhënia e shërbimeve sociale.

Përgjigja: Vendosija e fëmijës në qendër të axhendës së politikave

- Promovimi i një qasjeje kombëtare 'pro-fëmijës':
- Mbështetje me të ardhura;
- Akses në shërbime (shëndeti, shërbime sociale dhe familjare, përkujdesje për fëmijët, strehimi, arsimiti parashkollor);
- Integrimi rinor;
 - Socializimi i fëmijëve.
- Theksimi i reduktimit të pabarazive (rajonale) në mirëqënien e fëmijëve;
- Grumbullimi i të dhënave, analiza e orientuar drejt politikave, monitorimi i politikave publike.

Përpjekjet Plotësuese për Programet Sociale

- Rishikimi i Strategjisë së Mbrojtjes Sociale dhe të Fëmijëve;
- Qëllimi është që, deri në vitin 2013, të ulet niveli i varfërisë nga 18% në 10%;
- Nisma për shërbimet me bazë komunitetin;
- Harmonizimi i ndihmës ekonomike sociale me programet e tjera të ndihmës ekonomike;
- Përfshirja e të gjithë kategorive në nevojë.

Këto ishin masat që janë marrë për ato probleme që janë konsideruar të rëndësishme nga studimet e fundit. Shpresoj se të gjithë së bashku, duke harmonizuar angazhimin tonë dhe sinergjinë e duhur, të bëjmë disa hapa para krahësuar me periudhën e mëparshme. Në punën e saj, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ka synuar që të bëjë ndryshimet e mundshme me qëllim që ta orientojë punën e saj drejt cilësisë dhe grupeve të synuara.

Në përfundim të fjalës së saj Zv. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shprehu besimin se analiza e këtij problemi në këtë konferencë do të nxisë debatin midis pjesëmarrësve dhe se ai do t'i shërbejë sistemit të mbrojtjes së fëmijëve të cilët përbëjnë 25 % të popullsisë. Znj. Zaçe inkurajoi pjesëmarrësit në Konferencë se misioni i të gjithë pjesëmarrësve në konferencë është që të angazhohen në të ardhmen e vendit, fëmijët. Në këtë kontekst ajo theksoi se duhet të koordinohet puna në përdorimin e burimeve për të realizuar reformën e sapo nisur, për ta fuqizuar atë dhe që ky problem të vihet në rrugën e zgjidhjes brenda një kohe të shkurtër.



Mbrojtja sociale e fëmijëve dhe informacioni statistikor

Znj. Lantona Sado, Instituti i Statistikës

Në kuadrin e punës që po bëhet për mbështetjen e fëmijëve, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një studim lidhur me situatën aktuale të fëmijëve në Shqipëri. Studimi ka identifikuar pikat e mëposhtme:

- Fëmijët, janë kategoria më e ekspozuar ndaj rreziqeve, prandaj kanë nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të veçantë nga familja, shoqëria dhe institucionet shtetërore;
- Fëmijët të cilëve nuk ju sigurohet kujdesi dhe mbrojtja e duhur prindërore, dhe fëmijët e neglizhuar, abuzuar apo dëmtuar në forma të ndryshme janë fokusi i një sistemi social të ngritur në mbrojtje të tyre;
- Këto grupe kanë nevojë për përkujdesje të veçantë për shkak të të qenit të prekshëm ose vulnerabël, çka i bën ata lehtësisht të rrezikuar nga fenomeni i përjashtimit social;
- Një reformë e plotë dhe e thellë në sistemin e mbrojtjes shoqërore, që synon identifikimin e rrugëve për të reduktuar varfërinë dhe për të ngritur një sistem cilësor të shërbimeve sociale për grupet dhe individët në nevojë, veçanërisht të fëmijëve, është në vëmendjen e qeverisë aktuale.

Sistemi statistikor aktual për Mbrojtjen Sociale të Fëmijëve aktualisht konsiston në veprimtaritë e mëposhtëme:

- Rregjistron dhe raporton informacion për fëmijët, por ai nuk është “i ndjeshëm” sa duhet ndaj të gjitha kategorive;
- Ka pamjaftueshmëri në informacionin sasior dhe cilësor që lidhen me grupet dhe me kategori të veçanta të fëmijëve. Shumë burime informacioni janë të kufizuara sipas shtrirjes gjeografike, gjinisë dhe kushteve sociale;
- Mungesa e mjeteve statistikore të unifikuara (përfshi definicione, nomenklatura, metodologji zgjedhjeje);
- Informacioni nuk është periodik, dhe shpesh aplikimi i metodologjive të ndryshme e bën të pamundur dokumentimin e situatës së një grupi të caktuar si dhe të formave të përjashtimit social të fëmijëve;
- Të dhënat nga sektori publik janë të mbledhshme, por nuk është i detyrueshëm që sektori privat të raportojë të dhëna;
- Cilësia e informacionit është e diskutueshme. (fëmijët me aftësi të kufizuara)

○ **Burimet ekzistuese të informacionit**

(1) Të dhënat administrative nga Ministritë e linjës dhe INSTAT;

(2) Të dhëna nga rregjistrime të popullsisë dhe vrojtme të ndryshme me zgjedhje si anketa e MICS, anketa e LSMS, RHS;

(3) Raportet e përgatitura nga struktura qeveritare, organizma ndërkombëtare e organizata jo-qeveritare.

○ **Institucionet përgjegjëse për Statistikat administrative**

- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- Shërbimi Social Shtetëror;
- INSTAT;
- Ministria e Shëndetësisë;
- Ministria e Arsimit;
- Ministria e Drejtësisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë;
- Ministria e Brendshme.

○ Fëmijët në Institucionet e Përkujdesit Social

Sipas të dhënave administrative të MPÇSSHB rezulton se:

- Institucionet rezidenciale publike trajtojnë 400 fëmijë;
- Janë rreth 16,000 fëmijë jetimë, pa ose me një prind, që jetojnë në familje/komunitet;
- Trajtohen rreth 200 fëmijë me Aftësi të Kufizuar në Qendra Publike Rehabilitimi;
- Trajtohen 61 fëmijë me Aftësi të Kufizuar në Qendra ditore publike për rehabilitim;
- Trajtohen rreth 200 fëmijë në Qendrat rezidenciale jopublike;
- Trajtohen 250 fëmijë në Qendrat ditore jopublike, etj.
- MPÇSSHB raporton përrreth 12,000 fëmijë të paaftë.

Shqipëria ka bërë përpertime në drejtim të fëmijëve, por shumë prej tyre mbeten të papërfshirë dhe të padukshëm. Çfarë ofrojnë statistikat zyrtare për grupet e tjera në risk?

○ Fëmijë pa kujdes prindëror – jetimë sociale dhe biologjike

- Kujdesje nga pjesëtarë të familjes ose të afërm të jetimit;
- Në 16 qendrat rezidenciale publike 3 qendra ditore (rreth 600 fëmijë) dhe në 18 qendrat jopublike (243 fëmijë) – Viti 2005;
- Nga familjet sociale që kanë birësuar fëmijë (mesatarisht çdo vit 60 - 70 fëmijë)
- Shërbimi i kujdestarisë ose foster care - deri tani për 350 fëmijë nga shoqata Every Child).
- Birësimet: për periudhën 1994 – 2004 janë birësuar 1060 fëmijë shqiptarë brenda dhe jashtë vendit;
- Janë bërë 52 birësime brenda vendit duke përfshirë edhe ato me lidhje gjaku dhe 38 jashtë vendit. V.2005.

○ Programet dhe përfituesit

- Me Ndihmë Ekonomike (NE) mbështeten 123 mijë familje të varfëra në shkallë vendi (70 % në fshat), (17 % e familjeve shqiptare). Viti 2005;
-
- Mbështeten 58 mijë PAK mendore, fizike, të verbër, para dhe tetraplegjike dhe rreth 32 mijë invalidë pune, (2.6 % e popullsisë);
-
- Ofrohen shërbime publike në 26 institucione rezidenciale për 1,200 fëmijë, Persona me Aftësi të Kufizuar dhe të moshuar.

○ Fëmijët në konflikt me ligjin

- Nuk ekziston një institucion i veçantë për fëmijët dhe të rinjtë në konflikt me ligjin (14 -17 vjeç dhe 18 – 21 vjeç)
- Në një seksion të burgut të Vaqarrit –Tiranë, institucioni është i mbyllur dhe ai ka një shkallë sigurie të ulët.

Shqetësim: Përfshirja e të rinjve në krime në dekadën e fundit.

○ Fëmijët e Trafikuar

Raporti për realizimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të qenieve njerëzore (MB)

- Shifrat e raportuara nga Sektori i Luftës kundër Trafikeve të Paligjshme (Viti 2006) mbi numrin e personave të trafikuar është 25 persona; kjo shifër përfshin rastet e viktimave të trafikut në njerëz të referuara nga policia.
- Kjo situatë do të ndryshojë me ngritjen e bazës së të dhënave, e cila do të përcaktojë qartë definicionet standarte mbi të cilat do të bëhet edhe raportimi statistikor.

○ Fëmijët e Varfër

- 245,000 fëmijë jetonin në varfëri absolute (LSMS 2005). Rritja ekonomike ka çuar në pakësimin e fëmijëve që jetojnë në varfëri, deri në 34 përqind, që nga viti 2002.
- Këta fëmijë jetojnë në komunitetet më të harruara, zonat më të thella dhe disa të tjerë në periferitë e qyteteve të mëdha.
- Të tjerë të varfër: fëmijët Romë, fëmijët pa kujdesin e prindërve, fëmijët me paaftësi, fëmijët e trafikuar. Ka dhe fëmijë që punojnë në rrugë.
- Varfëria tek fëmijët në Shqipëri është shumë e madhe për t'u shpërfillur, sepse ka mundësi të shkaktojë dëme afat-gjata.
- Studime të ndryshme nga organizata qeveritare dhe jo-qeveritare tregojnë se në fakt kjo po bëhet.

○ Fëmijët dhe ndryshimi i varfërisë absolute

Fëmijë jo domosdoshmërisht të varfër por Grupe të Rrezikuara

- Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve – 17,5 (V. 2001) në 13 (v. 2006);
- Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç – 20.2 (V. 2001) në 14.7 (v 2006);
- ShVF >5MR në veri dhe në zonat rurale të Shqipërisë është më e lartë – aty ku edhe varfëria është më e madhe;
- LSMS 2002 – Një në shtatë fëmijë vuan nga vonesa të renda, ndërsa një në tre është mesatarisht i vonuar. Kequshqyerja është më e shpeshtë ndër fëmijët e varfër nën 5 vjeç, sesa ndër ata që nuk janë të varfër;
- MICS 2005 - Kequshqyerja kronike (e moderuar) ka një nivel 1.3 herë më të lartë tek fëmijët, nënat e të cilëve kanë nivel të ulët arsimor dhe fëmijët e varfër janë 2 herë më shumë të rrezikuar.

○ Privimi nga arsimimi

- Më pak se 50% e fëmijëve janë të rregjistruar në institucionet e fëmijërisë së hershme, publike ose private;
- Braktisja e shkollës është fenomen i nënraportuar dhe kryesisht fenomen rural dhe sub-urban. (1.2 për vitin 2005);
- Shkaqet kryesore të braktisjes lidhen me varfërinë, punën për të ndihmuar familjen dhe aksesin e kufizuar në shkolla për shkak të largësisë.

- Izolimi për shkak të gjakmarrjes është bërë një shqetësim në rritje: 1,450 fëmijë të izoluar në veri të Shqipërisë janë të detyruar të braktisin shkollën.

○ **Mbrojtja Sociale e Fëmijëve**

Shqipëria ka bërë përparime në drejtim të fëmijëve, por shumë prej tyre mbeten të papërfshirë në projekte për mbrojtjen e fëmijëve dhe të padukshëm. Çfarë ofrojnë statistikave zyrtare për grupet e tjera në risk?


- Të dhënat për fëmijët e rrugës, fëmijët e dhunuar, fëmijët e pashoqëruar në emigracion apo të trafikuar, fëmijët që punojnë, fëmijët e ngujuar, etj, shpesh janë të mbivendosura dhe janë kontradiktore.
- Del si nevojë e ngutshme ngritja e një sistemi të dhënash për identifikimin dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve.
- Një përpjekje për të plotësuar boshllëkun ekzistues mbi të dhënat administrative janë rezultatet që vijnë nga rezultatet e nxjerra nga MICS, RHS, etj.

○ **Anketa MICS 2005**

- Shkalla e regjistrimit të fëmijëve : 98 % e fëmijëve nën 5 vjeç janë të regjistruar;
- Puna e fëmijëve: 12% e fëmijëve 5 –14 vjeç në familje janë të përfshirë në punë jashtë shtëpie. Ky fenomen është i pranishëm në zonat rurale 4 herë më shumë se në ato urbane;
- Disiplinimi i fëmijëve: 49 % e fëmijëve 2-14 vjeç i janë nënshtruar një forme të ndëshkimit fizik ose psikologjik në familje;
- Martesa në moshë të hershme: rreth 1 % e vajzave martohen para moshës 15 vjeç. Ndërsa 8 % nën moshën 18 vjeç;
- Zhvillimi i fëmijëve: Rreth 32 % e fëmijëve nën 5 vjeç kanë libra për fëmijë në shtëpi;
- Paaftësia e fëmijëve: 11% e fëmijëve 2-9 vjeç janë raportuar nga nënat e tyre si fëmijë me paaftësi në të parë, dëgjuar, folur dhe mësuar (kjo sipas perceptimit të nënës për paaftësinë).

○ **Mungesë e ndjeshme informacioni lidhur me**

- Neglizhimin: Varfëria dhe papunësia i kanë detyruar prindërit (kryesisht baballarët) të emigrojnë. Kjo ka një ndikim negativ edhe në marrëdhëniet fëmijë-prindër dhe grua-burrë;
- Fëmijët e rrugës: Raportet e MPÇSSHB (2003) tregojnë për rreth 1,979 fëmijë të moshës 0-17 vjeç të cilët punojnë (lypin, lajnë xhamat e makinave, shesin sende të vogla, mbledhin kanaçe metalike nëpër koshat e plehrave etj.);
- Fëmijët e pakicave etnike: romë dhe evgjitë. Ndër fëmijët e varfër, ata që e vuajnë më shumë diskriminim social, nivel të lartë analfabetizmi, shëndet të dobët dhe kushte të këqija banimi, janë fëmijët romë dhe evgjitë;
- Efektet e mjedisit mbi fëmijët: Fëmijët janë të ekspozuar ndaj faktorëve të tillë mjedisorë, si ndotja e ujit, ajrit, mbeturinat, toka dhe ushqimet e ndotura, vendbanime jo të shëndetshme, transport jo të sigurtë, etj.;
- Cilësinë e shërbimeve që ju ofrohet fëmijëve;
- Veprimet e efektshme për fëmijët që bazohen në të dhëna aktuale dhe të detajuara;
- Zhvillimi i **materialeve informative** të bazuara për të drejtat e fëmijëve - sistemi matës.



○ Sistemi i manaxhimit për monitorimin e të drejtave të fëmijëve

Ndërtimi i një sistemi menaxhimi për monitorimin e të drejtave të fëmijëve, aktiviteti i të cilit të jetë monitorimi i mbrojtjes/respektimit të të drejtave të fëmijëve e veçanërisht të fëmijëve të varfër e të përjashtuar.

- (a) **strukturë ko-ordinuese** - DShB;
- (b) **strukturë udhëheqëse** - Qendra për Kërkime Sociale pranë INSTAT-it;
- (c) **rrjet pikash fokale** në institucionet kryesore, qeverinë vendore dhe organizata jo-qeveritare.

Çfarë pritet?

- Ngritja dhe mirëfunksionimi i sistemit për monitorimin dhe manaxhimin e të dhënave statistikore (QKS-INSTAT);
- Bashkëpunimi ndër-institucional në bashkërendimin e metodologjive dhe qarkullimin e informacionit.



Kuadri ligjor shqiptar dhe analiza e zbatimit të dispozitave ligjore lidhur me identifikimin, regjistrimin, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës kundër fëmijëve

Znj. Suela Kusi, Universiteti i Tiranës

Një grup pune, i përbërë nga *Z. Edmond Dragoti, Znj. Ditika Shehu, Znj. Elda Kalaja, Znj. Donika Naqe dhe Znj. Anita Pilika*, ka kryer një studim lidhur me identifikimin, regjistrimin, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës kundër fëmijëve. Ky është pjesë e një studimi më të gjerë në Evropën Juglindore. Studimi përfshin sektorin publik dhe privat, zonat urbane dhe ato rurale.

Dokumenti kryesor ku jemi mbështetur është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998 dhe konkretisht:

- *Neni 25* – Ndalimi i torturës ose formave çnjerëzore të trajtimit;
- *Neni 54 paragrafi 1* ku është cilësuar E drejta e mbrojtjes së veçantë nga Shteti;
- *Neni 54 paragrafi 3* – E drejta e fëmijëve për t'u mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi/shfrytëzimi për punë.

Pikë kryesore është **Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve – 1992**, e cila është ratifikuar nga shteti shqiptar dhe jep një përkufizim të qartë mbi dhunën kundër fëmijëve Neni. 19 ku cilësohet se “*shtetet marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë e dhunës fizike, mendore fyerje apo keqtrajtimi, braktisje apo mospërfillje nëpërkëmbjeje ose shfrytëzimi, përfshirë edhe abuzimin seksual, sa kohë ai është në ruajtjen e prindërve të tij apo njerit prej tyre, apo përfaqësuesve të tyre ligjorë.*” Ky është edhe përkufizimi i plotë i asaj që cilësohet “dhunë ndaj fëmijëve”

3. Një dokument tjetër legjislacioni bazë është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në të cilën cilësohet ndalimi i torturës apo formave të tjera të trajtimit çnjerëzor.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve jep edhe një përkufizim për dhunën ndaj fëmijëve në nenin 19.2 të saj ku parashikohet se këto masa për mbrojtjen dhe përfshirjen e fëmijëve janë të përshtatshme, dhe ndërhyrjen nëpërmjet hartimit të programeve shoqërore për përkrahjen e përkohshme të fëmijës si dhe atyre që kujdesen për fëmijët si dhe formave të tjera të parandalimit, të cilat në studim përmbledhen si më poshtë:

- identifikimi,
- raportimi,
- referimi,
- hetimi,
- trajtimi dhe
- ndjekja

e rasteve të keqtrajtimit të fëmijës të përshkruar më sipër përfshirë si edhe procedurat e ndërhyrjes gjyqësore. Pra kemi një kuadër ndërkombëtar, i cili parashikon detyrimin për të gjithë ofruesit e shërbimeve sociale që, në rastin e verifikimit të ushtrimit të dhunës, ky informacion të merret nga institucionet përkatëse jo vetëm për verifikimin, raportimin deri në ndjekjen e rastit deri në fund.

Si paraqitet situata në Shqipëri?

Në Shqipëri:

- ekziston një përkufizim i plotë për dhunën;
- kemi Ligjin “ Mbi Masat Kundër Dhunës në Familje” i cili jep këtë përkufizim mbi dhunën : “të gjithë veprimet apo mos veprimet kundrejt një personi, të cilat nëpërkëmbin integritetin e tij fizik, moral, psikologjik, seksual, dhe social.”;
- nuk ka kufizime të së drejtës për ankimim ndaj një kundërvajtjeje penale sipas moshave të ndryshme”;
- e drejta e ankimit sigurohet në protokolle dhe rregulloret e brendshme të institucioneve të kujdesit shëndetësor dhe autoriteteve policore. Megjithatë nuk ka një procedurë të veçantë ankimi në rastet kur ankimuesi është vetë fëmija;
- Legjislacioni Shqiptar vendos një sistem të detyrueshëm raportimi vetëm për veprat penale të nënpunësve civilë dhe të qytetarëve. Në rastin e klasifikimit të veprave të tjera ne kemi mungesa në legjislacioni;
- është përmirësuar përkufizimi mbi format e ndryshme të dhunës në legjislacioni shqiptar, por mbetet shumë në pjesën e raportimit për rastet e identifikuar nga të gjithë ofruesit në fushën sociale: në fushën e shëndetit, arsimit, të kujdesit social por edhe në organet e drejtësisë;
- një nga sfidat e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve është trajnimi i nëpunësve civilë dhe i të gjithë personave që punojnë me fëmijët. Ata duhet të jenë të trajnuar ose që në bankat e shkollës të kenë informacion se si të dallojnë dhe të identifikojnë rastet e ushtrimit të dhunës ndaj fëmijëve

- e më pas si të koordinohen këto përpjekje me referimin nga një lloj shërbimi tek tjetri;
- janë vendosur disa struktura ndër-sektoriale apo brenda institucioneve për raportimin dhe referimin;
- kuadri ligjor mbi procedurat e raportimin dhe regjistrimit është i ndryshëm për bashkëpunëtorë të ndryshëm, kjo për shkak të përmirësimeve ligjore në fushat përkatëse;
- mekanizmi i raportimit është përcaktuar mirë në sistemin shëndetësor dhe në rajonet e policisë, por nuk ka procedura të qarta sesi funksionon ky sistem në sektorin e arsimit dhe shërbimet sociale;
- mungojnë procedura të qarta administrative lidhur me procedurat e referimit të rasteve të dhunës ndaj fëmijëve;
- në të gjitha proceset e raportimit dhe referimit të fëmijëve të abuzuar, procedurat nuk janë në përputhje të plotë me Nenin 12 të KDF ku kemi të bëjmë edhe me lirinë e shprehjes së fëmijës;
- nuk i jepet rëndësi fare këndvështrimit të fëmijëve; madje në disa raste kemi edhe mungesë të respektimit të privatësisë së fëmijës (Neni 16 KDF), e cila përcakton se asnjë fëmijë nuk i nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private.

Grupi i punës ka analizuar në të gjithë sektorët kuadrin ligjor dhe dispozitat normative në sektorë të veçantë, të cilat mund të lidhen me sistemin e arsimit, ku parimet e respektimit të të drejtave të fëmijëve në shkolla parashikohen në ligjin **7982**, datë 21 qershor 1998 mbi sistemin e arsimit parauniversitar.

Sektori i Arsimit:

- Në nenin 36, pika 2, në arsimin publik përcaktohet “ndalohej dhuna fizike dhe psikologjike në shkolla... ai mbrohet nga dhuna fizike e psikologjike, diskriminimi e veçimi. Në shkollë janë kategorikisht të ndaluara ndëshkimet fizike apo trajtimet poshtëruese e denigruese të nxënësit.”
- Identifikimi: Roli dhe pozicioni i mësuesit kujdestar sipas nenit 45 të dispozitave normative, i cili konsiderohet si një nen kryesor për identifikimin e fëmijëve të dhunuar.
- Elementi i ri: Specialistët e Shërbimeve Psikosociale (SSHP), ku me urdhërin 321 dt. 11.10.2004 përcaktohen roli dhe objektivat e punonjësve socialë në shkolla. Njëri prej tyre është edhe vlerësimi dhe këshillimi social i nxënësve. Ndërsa roli i tyre është i rëndësishëm, vihet re që numri i tyre është i kufizuar kryesisht në qytetet e vogla apo në zonat rurale ku pothuajse shërbimi mungon fare.
- Urdhëri “Mbi masat për përmirësimin e punës edukative në shkolla dhe parandalimit të dhunës” ka për qëllim ndalimin e dhunës ndaj fëmijëve;
- Raportimi dhe regjistrimi: Nuk ka një mekanizëm raportimi lidhur me rastet e dhunës në shkolla dhe kjo vihet re në legjislacionin për nxënësit;
- Ankesat individuale nga fëmijët: nxënësit gëzojnë të drejtën e ankimit në rastet kur ata janë dhunuar nga mësuesit apo nxënësit e tjerë brenda institucioneve shkollore; kjo është e parashikuar në nenin 36, pika 3 e dispozitave normative;
- Roli i SSHP në shkolla është identifikimi i aktorëve të jashtëm me anë të të cilëve ne mund të identifikojmë dhe parandalojmë rastet e dhunës ndaj fëmijëve;
- Roli primar është identifikimi i problemeve të fëmijëve, dhe sjellja e tyre në vëmendjen e drejtorit të shkollës duke respektuar konfidencialitetin;
- Nuk ka sqarim mbi procedurat e dokumentimit. Mungesa e procedurave të dokumentimit vihet re edhe në rastet e raportuar nga mësuesit apo SSHP;
- Në rastet e dhunës ndaj fëmijëve – autoritetet e shkollës kanë detyrimin të raportojnë tek organet e drejtësisë të gjitha rastet që klasifikohen si vepra kriminale. Pra mungon detyrimi i raportimit për rastet e tjera që nuk klasifikohen në këto kategori;

- Referimi: ky term nënkupton përgjegjësinë për referimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e specializuara;
- Mungojnë protokollet lidhur me dokumentimin, raportimin dhe referimin e brendshëm.

○ **Sektori i Shëndetit**

Është përcaktuar nga **Kodi i Etikës së Mjekut** dhe nga protokollet:

- Mjeku i Përgjithshëm ka detyrimin të identifikojë rastet e fëmijëve të dhunuar. Mjekët pajisen me aftësi për identifikimin e viktimave të dhunës, përfshirë fëmijët;
- Në rastin e kërkimit të ndihmës mjekësore nuk ka kufizime moshore; Megjithatë, në rastet e trajtimit të një fëmije, është i nevojshëm miratimi i prindërve, apo përfaqësuesve të tij ligjor;
- Rastet janë raste të dokumentuara;
- Detyrim ligjor për referimin dhe raportimin tek autoritetet përkatëse, por ruhet informacioni dhe konfidencialiteti;
- Raportimi brenda 48 orëve tek organet e drejtësisë përgjegjëse për rastet e dhunës ndaj fëmijëve, por edhe për rastet e dyshimta;
- Sistemi i referimit funksionon vetëm në një drejtim;
- Ligji mbi dhunën në familje synon të përmirësojë mekanizmin e identifikimit, raportimit dhe referimit të rasteve të dhunës në familje;
- Ekzistojnë dy përkufizime të ndryshme për dhunën në ligjin për “Dhunën në Familje” dhe në Kodin Penal”.

○ **Rajonet e Policisë**

- Duhet përmendur se mekanizmi për identifikimin, raportimin dhe referimin e rasteve është i përkufizuar mirë dhe nuk ka kufizime përsa i përket moshës së fëmijës;
- Identifikimi: Oficerët e policisë në Rajonet e Policisë janë të parët të cilët identifikojnë fëmijët e dhunuar;
- Trajnimi i oficerëve të policisë për identifikimin e viktimave të dhunës fizike duhet bërë gjatë kurseve akademike;
- Kur një ankesë bëhet prezent apo raportohet, është e detyrueshme me ligj që ankesa të regjistrohet/dokumentohet në një regjistër të veçantë;
- Oficerët e Policisë raportojnë dhe prezantojnë të gjithë informacionin e nevojshëm pranë Prokurorisë;
- Referimi: Nuk ekzistojnë akte normative të cilat përcaktojnë referimin e rasteve të fëmijëve të dhunuar tek institucionet e specializuara, përveçse ofrimin të ndihmës mjekësore;
- Por shërbimet sociale dhe psikologjike ofrohen nga OJF të specializuara, në rastet e marrëveshjeve bilaterale të bashkëpunimit.

○ **Mjediset e Paraburgimit**

Në rast se fëmijët dhunohen në mjediset e paraburgimit, duhet ditur se:

- Ata gëzojnë të drejtën e ankimimit;
- Dhuna fizike dhe psikologjike janë rreptësisht të ndaluara;
- Ekzistojnë procedura të qarta ankimimi të përcaktuara në rregullore;
- Autoritetet kompetente janë të detyruara që t’u përgjigjen;
- Edukatorët dhe psikologët duhet të jenë të kualifikuar për identifikimin e rasteve të dhunës;

- Rasti raportohet brenda sistemit, por nuk ekziston një procedurë e qartë për raportim të mëtejshëm;
- Autoritetet e paraburgimit i kalojnë procedurat e ankimit tek Zyra e Avokatit të Popullit;
- Ka një sistem të brendshëm referimi.

○ **Ofruesit e Shërbimeve Sociale**

- Pikë fillestare janë standardet e ofruesve të shërbimeve;
- Nuk ka kufizime në moshë për shërbimet e ofruara;
- Standartet njohin faktin se “Përfituesit janë të mbrojtur ndaj të gjitha formave fizike, psikologjike, seksuale dhe emocionale të dhunës”;
- Një nga standardet e vendosura “Në standardet e shërbimeve për fëmijët” është “Pasja e procedurave që bëjnë të mundur sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve, dhe sigurojnë mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi. Anëtarët e stafit janë të familjarizuar me procedurat dhe i kuptojnë ato”;
- Shërbimet sociale në Shqipëri monitorohen nga MPÇSSHB, e cila është autoriteti përgjegjës për dhënien e licensave për ofrimin e shërbimeve sociale;
- Që të arrihen standardet, OJF-të që ofrojnë shërbime duhet të jenë të pajisra me licensë dhe personeli që i kryen ato duhet të jetë i trajnuar dhe i kualifikuar;
- Ankesat dhe të gjitha veprimet e nevojshme për zgjidhjen e problemeve duhet të regjistrohen/dokumentohen. Drejtori/Administratori i shërbimit social duhet të kthejë përgjigje brenda 30 ditëve, kohë limit e përcaktuar në ligj.
- Raportimi është detyrim ligjor për të gjithë Ofruesit Shtetëror të Shërbimeve për të raportuar rastet tek autoritetet e drejtësisë. Por ky detyrim nuk është i njëjtë për OJF-të që ofrojnë shërbime sociale;
- Nuk ekzistojnë kërkesa specifike për OJF-të për procesin e raportimit të rasteve pranë autoriteteve përkatëse.

○ **REKOMANDIMET e Grupit të Punës për Kuadrin Ligjor**

- Amendimi i përkufizimit të “dhunës kundër fëmijëve” në kodin penal, duke përfshirë format e tjera të dhunës, në përputhje me konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga qeveria shqiptare;
- Rishikimi dhe përmirësimi i protokolleve të brendshme dhe rregulloreve për procedurat e regjistrimit/dokumentimit të një ankese;
- Procedura të veçanta dhe të përkufizuara mirë të raportimit të rasteve të dhunës kundër fëmijëve; duhet të parashikohen nga protokollat apo rregulloret e brendshme në secilin sektor;
- Procedura të qarta administrative për bashkëpunimin ndër-sektorial; ato duhet të parashikohen për secilin sektor;
- Duhet të vendoset një bashkëpunim ndër-sektorial për referimin e rasteve të dhunës kundër fëmijëve;
- Gjatë procesit të intervistimit Ministria e Brendshme duhet të parashikojë dhënien e asistencës/shërbimeve psikologjike për një fëmijë të dhunuar;
- Autoritetet përgjegjëse duhet të përfshijnë seanca trajnimit për personelin që punon drejtpërdrejtë me fëmijët dhe punon për identifikimin e fëmijëve të abuzuar.
- Vendosja e një linje telefonike të ndihmës për fëmijët; kjo të manaxhohet nga një grup multidisiplinar.

Grupi i punës shprehu dëshirën që, në një veprimtari tjetër, të prezantojë versionin final të këtij studimi.

Sesioni i mbasdites (Dita e parë)

Kjo seancë u drejtua nga Mr. Robert Carr. Në të u paraqitën përvojat më të mira të projekteve që lidhen me punën e bërë për mbrojtjen e fëmijëve.

Prezantimi I



Mekanizmat institucionalë që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri

Znj. Arda Lazareni, Sekretariati Teknik, MPÇSSHB

- Në vitin 2005, u miratua Strategjia Kombëtare për Fëmijët dhe Plani i Veprimit, të cilat kanë si qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- Mbrojtja e fëmijës njihet si një çështje dhe e drejtë e padiskutueshme;
- Marrja e masave në lidhje me:
- Mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi;
- Promovimin e shërbimeve që mbështesin rritjen e fëmijës në mjedisin familjar apo në familjet kujdestare;
- Përmirësimin e legjislacionit të birësimit;
- Promovimin e shanseve të barabarta për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Parandalimin dhe përmirësimin e mbrojtjes për fëmijët e trafikuar.

Miratimi i strategjisë solli disa ndryshime të rëndësishme institucionale dhe konkretisht:

- Ngritjen e Komitetit Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve;
- Ngritjen e Sekretariatit Teknik për Fëmijët.

Sekretariati ndjek dhe koordinon zbatimin e objektivave të strategjisë dhe të të drejtave të fëmijëve.

Ai raporton në mënyrë periodike në Komitetin Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve, i cili është një

organ këshillimor pranë Këshillit të Ministrave, i cili propozon ndryshimet në politikat për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Është ngritur **Nënseksioni për të Drejtat e Fëmijëve, pranë Avokatit të Popullit (NDF)** i cili shqyrton ankesat në rastet kur nuk respektohen të drejtat e fëmijëve nga administrata shtetërore. Janë ngritur edhe dy zyra rajonale në Korçë dhe Shkodër.

Për mbrojtjen e fëmijëve të trafikuar apo në rrezik për t'u trafikuar janë ngritur:

a) Autoriteti Përgjegjës i cili ka si qëllim që:

- Të bashkërendojë dhe monitorojë procesin e referimit për ndihmë, mbrojtje, dhe ri-integrim të viktimave dhe viktimave të mundshme për t'u trafikuar.
- Të regjistrojë dhe raportojë në mënyrë periodike të dhënat për identifikimin dhe referimin e rasteve të trafikimit te organizata dhe institucione të tjera.

b) Komitetet Rajonale Antitrafik të cilët:

- Përbëhen nga aktorë kryesorë lokalë, si psh. përfaqësues të drejtorive rajonale të policisë, arsimit, shëndetësisë, shërbimeve sociale, pushteti vendor, etj.
- Kanë si qëllim vlerësimin e grupeve vulnerabël, identifikimin e rasteve të viktimave të mundshme të trafikimit, parandalimin e këtij fenomeni, etj.

Mbrojtja e Fëmijëve përfshin elemente si:

- Identifikimin efektiv të situatave të abuzimit, shfrytëzimit apo neglizhencës;
- Regjistrimin sistematik të rasteve në një sistem të dhënash;
- Ekzistencën dhe funksionimin e një mekanizmi të brendshëm koordinues që siguron një reagim të shpejtë ndaj problemit;
- Referimin apo raportimin e këtyre rasteve tek autoritete të tjera apo ofrues shërbimesh.

Problemet:

- Punonjësit në institucionet shëndetësore, arsimore, në nivel lokal, nuk kanë trajnimin e nevojshëm dhe as përgjegjësinë administrative për identifikimin dhe referimin e fëmijëve në rrezik;
- Mekanizmi i raportimit të rasteve të abuzimit, është i përcaktuar mirë në strukturat policore dhe ato shëndetësore, por nuk ka një mekanizëm të qartë raportimi në sektorin e shërbimeve sociale dhe atë të edukimit;
- Nuk ka procedura të përcaktuara qartë sesi duhet të funksionojë koordinimi dhe referimi ndër-sektorial;
- Personat që punojnë me fëmijët nuk e kanë të qartë se tek cila strukturë duhet t'i referojnë fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje dhe se cila është struktura përgjegjëse për mbrojtjen e

fëmijëve, si dhe në cilat rrethana fëmija duhet t'u referohet institucioneve të tjera.

Me mbështetjen e UNICEF-it, kanë filluar disa projekte pilot me qëllim që:

- Të forcohet sistemi i mbrojtjes së fëmijës dhe familjes;
- Të forcohen pozitat e strukturave të sapo ngritura (në kuadër të projekteve pilot) për mbrojtjen e fëmijëve dhe familjes në nivel vendor (qark dhe bashki);

Aktualisht janë ngritur:

- 4 Njësi për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në nivel qarku (Kukës, Vlorë, Elbasan, Korçë);
-
- 7 Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashkitë e Tiranës, Kukësit, Korçës, Elbasanit, Fierit, Pogradecit dhe Gjirokastrës.
- Strukturat për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashki mbështeten nga disa OJF si: Terre des Hommes, Save the Children Albania, World Vision, etj, të cilat veprojnë sipas një memorandumit bashkëpunimi me bashkinë.

Strukturat për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, (në qark)

- Vëzhgojnë dhe vlerësojnë mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në nivel rajonal;
- Identifikojnë dhe koordinojnë referimin e rasteve të shkeljeve apo abuzimit me, dhe keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve;
- Bashkëpunojnë dhe këmbëjnë informacion me zyrën e Statistikave, Drejtorinë Rajonale të Shëndetit parësor, Drejtorinë Arsimore Rajonale, Zyrën e Regjistrimit të Gjendjes Civile, Seksionin e NE-së dhe pagesës së paaftësisë në Bashki dhe Komuna, si dhe me çdo institucion tjetër të qeverisjes vendore apo shoqërisë civile;
- Marrin pjesë në projekte e studime që synojnë matjen dhe vlerësimin e treguesve të të drejtave të fëmijëve;
- Marrin pjesë në hartimin e “Raportit të Vjetor të zbatimit të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë” që përgatitet nga Sekretariati Teknik për Fëmijët.

Komiteti ndërministror përbëhet nga:

- Avokati i Popullit;
- Nën seksioni për të Drejtat e Avokatit të Popullit;
- Sekretariati Teknik për Fëmijët MPCSSHB;
- Zyrrat rajonale të NDF;
- Njësia për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në QARK;
- Njësia për mbrojtjen e Fëmijëve pranë BASHKISË;

Aktualisht Sekretariati po punon për ngritjen, forcimin dhe monitorimin e protokolleve.

Struktura për Mbrojtjen e Fëmijëve (në Bashki) ka për qëllim që:

- të vlerësojë dhe monitorojë situatën e fëmijëve dhe familjeve në rrezik;
- të koordinojë mbrojtjen dhe referimin e rasteve në nivel lokal;
- të identifikojë dhe të bëjë menaxhimin e rasteve në mënyrë multidisiplinare.

Qëllimi i këtyre Strukturave është që:

- të rrisin kapacitetin e strukturave vendore për të identifikuar, vlerësuar, referuar dhe mbështetur fëmijët në nevojë.
- të organizojnë një ekip multidisiplinar për vlerësimin e rastit.
- të shërbejnë edhe si *drop-in center*, ku fëmijët dhe familjet mund të marrin informacion apo të referohen tek shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojave.

Rekomandime

- Duhet të institucionalizohen përgjegjësitë për identifikimin, raportimin, koordinimin, referimin ndërmjet institucioneve;
- Duhet të hartohen udhëzime dhe protokolle për stafet pedagogjike të shkollave, stafet mjekësore, policinë lidhur me identifikimin, regjistrimin, raportimin dhe referimin e rasteve për mbrojtjen e fëmijës;
- Duhet të trajnohen mësuesit për të identifikuar, monitoruar dhe menaxhuar rastet. Shkolla mund të jetë një burim shumë i madh informacioni për fëmijët në rrezik.
- Duhet të sensibilizohet publiku dhe institucionet lokale për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Kjo merr rëndësi për qytetet e vogla në të cilat mentaliteti ende vazhdon të justifikojë dhunën ndaj fëmijëve.

14

Përvoja e zyrës për mbrojtjen e fëmijëve, bashkia Kukës

Z Bilbil Keraj

Kjo zyrë është ngritur nga VMA-Kukës në bashkëpunim me bashkinë Kukës, financuar nga UNICEF

QËLLIMI I ZMF: Të ulë rrezikshmërinë të fëmijët ndaj shfrytëzimit, abuzimit, dhunës dhe neglizhencës.

Objektivat:

- Të identifikojë, vlerësojë, referojë dhe të ofrojë shërbime të specializuara për fëmijët dhe familjet në rrezik;
- Të rrisë kapacitetet e strukturave lokale për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në rrezik;
- Të institucionalizojë mekanizmat referues, të koordinojë dhe të ndërhyjë në aty ku duhet;
- Të ndërgjegjësojë komunitetin mbi faktorët e rrezikut ndaj shfrytëzimit, abuzimit, dhunës dhe neglizhencës;
- Të përmirësojë reagimin komunitar ndaj shfrytëzimit, abuzimit, dhunës dhe neglizhencës ndaj fëmijëve;
- Të identifikojë dhe manaxhojë rastet specifike të fëmijëve në rrezik në mënyrë multidisiplinar.

MISIONI I ZYRËS: Të ofrojë Shërbime të specializuara për fëmijët e rrezikuar

KJO ZYRË U SHËRBEN

- Fëmijëve që rrezikohen të shfrytëzohen, abuzohen, dhunohen apo të neglizhohen;

- Familjeve me probleme sociale.

SHËRBIMET

Masat Parandaluese

- Sesione ndërgjegjësuese në shkolla;
- Vizita në familje;
- Publikime.

Mbrojtja

- Këshillime psiko-sociale nëpërmjet:
 - Këshillimit të drejtëpërdrejtë në Zyrë;
 - Këshillimit në familje.

Referimi

- Studim të rasteve;
- Hartimi i planit të ndërhyrjes;
- Referimi tek partneret (institucione, shoqata);
- Advokimi i rastit;
- Lobim.


AKTIVITETET KRYESORE

- Identifikimi i fëmijëve të rrezikuar;
- Ngritja e Bazës së të Dhënave për fëmijët në rrezik;
- Referimi i rasteve të identifikuar;
- Ofrimi i shërbimesh periodike;
- Këshillime psikosociale për fëmijët e rrezikuar dhe familjet e tyre;
- Ndikimi/ngritja e zërit pranë Institucioneve përkatëse për problemet e fëmijëve;
- Debate-aktivitete ndërgjegjësuese në shkolla;
- Vizita periodike në familjet me probleme sociale;
- Botime;
- Trajnimi i Administratorëve Socialë në Bashki;
- Trajnimi i partnerëve të ZMF;
- Trajnimi i mësuesve të shkollave;
- Seanca pune me partnerë mbi unifikimin e metodave të identifikimit, raportimit dhe referimit të rasteve të fëmijëve në rrezik.

AKTORËT KRYESORË

- Administratorët Socialë të Bashkisë;
- Komiteti Orientues;
- Grupi i Menaxhimit të Rasteve;
- Grupi Multi Disiplinar;
- Shkollat 9 vjeçare Kukës;
- Drejtoria Arsimore Rajonale;

- Shërbimi për Shëndetin Parësor;
- Shërbimi Social Shtetëror, Dega Kukës;
- Zyra anti-trafik pranë Drejtorisë së Policisë Kukës;
- OJF-të e ndryshme Lokale.



Rezultatet

Anët Pozitive

- Ngritja e Zyrës së ZMF-së dhe funksionimi me sukses i saj;
- Përmirësimi i shërbimit ndaj fëmijëve në rrezik;
- Përmirësimi i Bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që punojnë me fëmijët;
- Pranimi i problemeve të fëmijëve nga Institucionet Lokale;
- Marrja përsipër e rolit që i takon Bashkisë së Kukësit lidhur me problemet e fëmijëve.

Sfidat

- Varfëria e tejskajshme në Qarkun e Kukësit (43% e popullsisë trajtohen me ndihmë ekonomike);
- Mungesa e shërbimeve të specializuara për fëmijët nga operatorë të ndryshëm;
- Mentaliteti i Komunitetit për çështjet që lidhen me fëmijët;
- Mungesa e një kornize ligjore lidhur me punën e ZMF-ve dhe rolin e tyre;
- Mungesa e decentralizimit të kompetencave për këto shërbime;
- Pamundësia e Bashkisë për të përballuar problemet e shumta të Kukësit si rezultat i papunësisë.

Ndikimi i Zmf-së në Komunitet

- Janë të regjistruar në Bazën e të Dhënave 640 fëmijë;
- Janë identifikuar 35 fëmijë tre muajt e fundit;
- Muajin e fundit, me referim nga ZMF-ja, u është akorduar ndihmë e plotë ekonomike nga Bashkia 7 familjeve;
- Janë referuar nga specialistët 3 fëmijë me probleme shëndetësore.
- Janë refuar 12 fëmijë për ndjekje të shkollës verore;
- Janë bërë 28 vizita në zyrë nga qytetarët;
- Janë të kompletuara 30 dosje (ku përfshihen të dhënat, plani i ndërhyrjes, referimi dhe ndjekje e rastit);
- Janë kryer 55 vizita për këshillim psikosocial;
- Janë zhvilluar 2 aktivitete publike me pjesëmarrjen e 45 fëmijëve dhe 40 prindërve;
- Është bërë publicitet për fëmijët në rrezik (tryezë e rrumbullakët në TV lokale, emisione në Radion Lokale, shpërndarje e informacionit);
- Janë zhvilluar 6 debate/aktivitete në shkollat 9-vjeçare të qytetit;
- Është bërë Marrëveshja për dorëzimin e ZMFsë të Bashkisë.
- Është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimi midis institucioneve për koordinimin e punës për mbrojtjen e fëmijëve;
- Janë zhvilluar 2 trajnime për ngritjen e kapaciteteve në mbrojtje të fëmijëve.

Qëndrueshmëria e projektit

- Bashkia po merr përsipër drejtimin e plotë të ZMF;
- Bashkia ka akorduar fondet e nevojshme për funksionimin e zyrës;
- Staf i ZMF-së dhe administratorët socialë kanë aftësitë e nevojshme profesionale;
- Është arritur bashkëpunimi ndërinstytucional mes organeve të ndryshme lokale për trajtimin e problemeve të fëmijëve.

Kush Përfiton?

- 200 Fëmijë në Rrezik të Lartë (përfshihen: fëmijët e rrugës, fëmijë të braktisur dhe 147 fëmijë me një prind);
- 412 fëmijë me Rrezik të Mesëm ku përfshihen: fëmijë të familjeve me probleme sociale; me prindër të papunë ose që nuk kanë ndonjë anëtarë familjeje që të kujdeset për to;
- 146 fëmijë me Rrezik të Ulët të Bashkisë së Kukësit;
- 4,609 nxënës të qytetit të Kukësit (Fëmijët e 5 shkollave);
- 25,000 pjesëtarë të komunitetit në Bashkinë e Kukësit;
- 6 punonjës socialë të sektorit të shërbimeve sociale (ndihmë ekonomike) të Bashkisë;
- 80 Mësues kujdestarë të 5 shkollave 9-vjeçare të Kukësit;
- 5 Inspektorë Policie në Zonë;
- 2 Përfaqësues të Gjykatës;
- 6 mjekë familjeje të Kukësit; 3 mjekë të shtëpisë së lindjes në Kukës;
- 3 Psikologë të shkollave të Kukësit;
- 1 punonjës social i Zyrës së Punës ;
- 13 fëmijë të prindërve të divorcuar .

Në përfundim të prezantimit të përfaqësuesit të Bashkisë së Kukësit Z Carr vlerësoi angazhimin e kryebashkiakut të Kukësit duke thënë se ai është shumë i informuar për gjithçka që lidhet me këtë çështje.



Përvoja e njësisë së mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, bashkia e korçës

Znj. Nikoleta Capollari

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Fëmijëve dhe Planin e Veprimit qeveritë lokale (bashkitë/komunat) kanë përgjegjësinë që t'u ofrojnë shërbim fëmijëve dhe familjeve në rrezik. Për këtë qëllim, me ndihmën e *Terr des Hommes*, Projektin TACT & UNICEF dhe Bashkisë së Qytetit, pranë disa bashkive, më 20 Shtator 2006, Këshilli Bashkiak i Korçës miratoi krijimin e një strukture të re: *Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve*. Qëllimi i krijimit të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve është që të mbështesë dhe të mbrojë fëmijët në nevojë. Ky projekt është pilot dhe do të vazhdojë për 3 vjet.

Qëllimi i projektit: Të forcojë kapacitetet e qeverisë lokalë në identifikimin dhe referimin e fëmijëve në nevojë.

Gjatë tre viteve të para projekti ka funksionuar me anë të një bashkëfinancimi midis Bashkisë, TACT dhe UNICEF-it.

Trajnimet që janë zhvilluar në kuadrin e projektit përfshijnë:

- Shkëmbime eksperiencash;
- Shoqërim dhe supervizim nga punonjësit socialë të projektit TACT.

Roli i Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve është që:

- të identifikojë fëmijët e lënë pas dore, të abuzuar, të shfrytëzuar dhe të trafikuar si dhe të fëmijët në rrezik;
- të veprojë për të mirën e fëmijës për mbrojtjen, menaxhimin e rastit, referimin, dhe koordinimin e veprimeve;
- të promovojë dhe të ndërgjegjësojë qytetarët dhe strukturat e ndryshme lidhur me të drejtat e fëmijëve.

Si funksionon Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve?

- Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve është figurë qendrore në mbrojtjen e fëmijës;
- Partnerët në luftën për mbrojtjen e fëmijëve janë: arsimit, policia, shëndetësia, qendrat e shërbimeve ditore dhe rezidenciale, qendra këshilluese, etj.
- Bashkëpunëtorët më të ngushtë janë: administratorët shoqërorë të bashkisë, psikologët e shkollave, punonjësit socialë të organizatave të ndryshme, etj.
- Menaxhimi i rasteve → ka grupe për menaxhimin e rasteve që përbëhen prej një rrjeti aktorësh;
- Shërbimet e ofruara janë pa pagesë;
- Punonjësi i Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve kryen vizita të rregullta në familjet e fëmijëve në nevojë;
- Përfituesit e shërbimeve referohen tek shërbime të tjera sipas nevojës.

Arritjet

- Identifikimi i fëmijëve në rrezik;
- Aktivitete ndërgjegjësuese me profesioniste të fushave të ndryshme;
- Aktivitete për të ndërgjegjësuar komunitetin mbi mënyrat e mbrojtjes së fëmijëve;
- Ngritja e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve ekziston në Korçë, Kukës, Elbasan, Fier, Pogradec, Gjirokastrë dhe Tiranë.
- Angazhimi serioz i *Terre des Hommes* dhe i Qeverisë Zvicerane.

Ka dalë nevoja që të ngrihen Njësitet që merren me Mbrojtjen e Fëmijëve në të gjitha Bashkitë e vendit.

Rekomandime

- Të institucionalizohet puna e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve me të gjithë institucionet e tjera partnere. Të inkurajohen bashkitë që ta mbështesin këtë njësi.
- Të punohet me mësuesit për monitorimin, menaxhimin e rasteve. Shkolla është një burim informacioni për fëmijët në nevojë.
- Të ngrihet një bazë të dhënash që të përmbajë informacione mbi fëmijët në rrezik dhe hapat që duhen ndërmarrë për t'i ardhur atyre në ndihmë.
- Të bashkëpunohet me komunitetin në drejtim të ndërgjegjësimit për çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve.

16

Seanca pyetje-përgjigje rreth diskutimeve dhe prezantimeve

Pyetje: Janë bërë investime të mëdha dhe ne duhet të mbajmë përgjegjësi për vazhdimësinë e tyre. Si do të vazhdojë projekti në të ardhmen me mbylljen e projekti të Bankës Botërore?

Përgjigje: Në konferencë u tha që synohet që të rriten shërbimet komunitare. Janë ngritur qendrat komunitare fillestare nga 47 qendra 27 prej tyre punojnë për fëmijët. Decentralizimi është i vështirë, na mungon tradita e pushtetit lokal për të ofruar shërbime sociale. Janë paraqitur projekte, por të rinjtë nuk janë po aq të azhurnuar sa drejtuesit që i kanë paraqitur këto projekte. Duhet që Ministria, Banka Botërore dhe Pushteti Lokal të mblidhen dhe të vendosin se si do të procedojnë në të ardhmen. Të shohim këtë problem fillimisht dhe pastaj të shikojmë për probleme të reja.

Pyetje: A do të fillojë të zbatohet kjo strategji për mbrojtjen e fëmijëve? E kam lexuar strategjinë dhe keni bërë një punë të mirë, por sa do të zbatohet nuk e di. Sot kam pasur dy telefonata. Një gjyshe me 5 jetimë që u ka vdekur nëna edhe baba, jetojnë në Bytyç të Tropojës. Meqë nëna dhe baba nuk kanë paguar sigurimet shoqërore të pesë fëmijët, nuk marrin pension. Janë bërë shumë seminare që nga 2001 dhe unë them: Projektet i bëni mirë, por a do t'i zbatoni ato? Këta fëmijë në nevojë nuk gëzojnë asgjë.

Përgjigje: Ndjem mirë kur nga shoqëria civile ngrihen çështje që kanë të bëjnë me të tashmen dhe të ardhmen. Janë bërë përpjekje nga BB dhe do të ishte shumë keq nëse do të ndërpriteshin. Ne kemi menduar që të organizohet një takim i tre palëve: Pushteti Qendror (Ministria), Pushteti Lokal (Bashkia/itë) dhe Banka Botërore, me qëllim që ata të ndërgjegjësohen dhe të vihen para përgjegjësisë dhe kjo punë të vazhdojë.

Drejtuesi i një organizatë jo vetëm është drejtues i saj por ngre zërin edhe për fëmijët që nuk kanë gjetur ende mënyrën se si të mbështeten. Qeveria paraardhëse ka pasur një bum të madh strategjish dhe ne tani na ngelet zbatimi i këtyre strategjive duke bërë korigjimet e duhura në to. Zoti Kadri Alia është shprehur shumë pozitivisht për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Duhet të fillohet me strukturat lokale dhe ato qendrore. Zbatimi i kësaj strategjie preokupacioni ynë kryesor dhe shumë nga vendimet e kësaj qeverie janë për shtresat në nevojë. Ne këto nuk do t'i bëjmë vetë, por sëbashku.

Pyetje: Ka një shqetësim që e ndeshim në praktikën tonë të përditshme. Në kategorizimin e fëmijëve janë edhe fëmijët në konflikt me ligjin. Edhe për këta duhet menduar.

Lidhur me shërbimet e ofruara, ekziston një komision licensimi për organizatat që ofrojnë shërbime. Ka ardhur momenti që të licensojmë punonjësit socialë (jo me njohje personale, sikurse bëhet aktualisht). Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta duhet të bëjë diçka për këtë problem.

Përgjigje: Ka ardhur koha që të licensohen OJF-të dhe kjo do të jetë në axhendën tonë.

Pyetje: Nuk pashë ndonjë pikë në prezantimin e Znj. Zaçe për fëmijët e ngjuar nga gjakmarrja. As në prezantimin e Instatit nuk u dha ndonjë shifër. Në Shkodër janë evidentuar 200 fëmijë të ngjuar dhe 150 fëmijë nuk shkojnë në shkollë. MASH ka bërë një program me 158 mësues që të hyjnë në shtëpi për të bërë mësim me këta fëmijë.

A ka ndonjë koordinim midis shoqatave të ndryshme që ofrojnë mbështetje sociale për këtë kategori fëmijësh?

Përgjigje: INSTAT nuk ka mandatin që t'i detyrojë OJQ-të që të japin informacion statistikor. Një informacion i mirë në Ministrinë e linjës është një informacion i mirë që raportohet nga Instat. Ky problem po trajtohet nga Ministria e MPCSSHB. Janë mbledhur dhe është hartuar një strategji. Fëmijët që janë prekur nga gjakmarrja janë një kontigjent i konsiderueshëm. Ministria e Punës e ka në qendër të vëmendjes këtë problem. Është një projekt i Bankës Botërore për këtë çështje. Madje janë dërguar fëmijë në Poliçan për të vazhduar shkollën në kushte normale. Duhet parë që kjo nismë të zhvillohet më tej.

Pyetje: Shoqata *Every Child* përgëzon Bashkinë e Kukësit për punën e bërë. Çfarë % të buxhetit të Bashkisë së Kukësit zë financimi i Zyrës për Mbrojtjen e Fëmijëve?

Përgjigje: Kjo zyrë funksionon me financim të UNICEF-it dhe punonjësi tjetër me fondet e Bashkisë. Ne marrim përsipër funksionimin e plotë të kësaj zyre por nuk mund të jap përqindje. Kjo varet nga buxheti që na jep qeveria.

Pyetje: Si është bërë e njohur ZMF-ja në qytetin e Korçës dhe sa frekuentohet ajo? Ne kemi nevojë t'i institucionalizojmë këto struktura.

Përgjigje: Në Korçë është bërë e njohur krijimi i zyrës nëpërmjet mediave elektronike dhe të shkruar. Numri i fëmijëve që vijnë e kërkojnë ndihmë është shumë i madh. E kemi bërë informimin e publikut mbi ekzistencën e një qendre të tillë në bazë zonash. Gazeta e bashkisë shkon një herë në dy muaj dhe informon publikun për këtë mundësi për fëmijët. Media padyshim është partnere në këtë nismë. Administratori njeh varfërinë e qytetit dhe të fëmijëve në nevojë, të dhunuar, etj.

Koment: Drejtori i Unionit të Romeve të Shqipërisë komentoj se Romët zenë një vend të veçantë; strategjia fillon nga fëmijët dhe deri në moshat e treta. Kemi një kopësht për fëmijët romë të mbështetur nga dy partnerë. I sugjeroj zonjës nga Korça që të mbështesë fëmijët romë dhe egjiptianë. Në Korçë janë të gjitha kategoritë e fëmijëve: të trafikuar, fëmijë pa prindër, emigrant, etj. Në Korçë ka fëmijë që nuk

kanë mbrojtje. Duhet gjetur një rrugë bashkëpunimi institucional dhe ne ju sigurojmë mbështetjen tonë në këtë drejtim. Në nivel kombëtar ka një strategji dhe po bëhen përpjekje, ka një vullnet dhe po hidhen bazat në një strategji për mbrojtjen e fëmijëve, por këto praktika duhen çuar deri në fund. Bëhen strategji, por sa zbatohen ato është shumë larg. Janë bërë shumë tryeza, janë ngritur sektorë, por nëqoftëse nuk ka vullnet politik kot mblidhemi.

Përgjigje: Në qytetin e Korçës funksionojnë 10 shoqata. Edhe ju vetë mund të ngrini një komision dhe të vini në Bashki për të ngritur problemet që keni.

Replikë: Union-i i Romëve operon me Bashkinë. Të gjithë aktorët janë të lirë. Ne duam që ju të gjeni një gjuhë të përbashkët e të mirëkuptohemi. Shoqata që nuk kanë aktivitet real duhet të largohen. Jeni ju ata që i mbani. Ju duhet të gjeni gjuhën që të punoni me romët. Unioni ka një politike integruese dhe zhvilluese.

Shqetësim: Z. Carr u shpreh se shpesh bëhen konferenca por nuk ndërmerret asnjë veprim. Është e mira që këtë herë të ndërmerren veprime konkrete.

Në fund të seancës Z. Carr ngriti disa shqetësime: Në seancën e sotme folëm për Bashkitë, por nuk folëm për njësitë më të vogla siç janë *komunat*. Kjo është një çështje që duhet patur parasysh në diskutimet e ditës së dytë.



Projekti i Bankës Botërore

Z. Gëzim Toshi, përfaqësues i Bankës Botërore, informoi pjesëmarrësit për projektin e Bankës Botërore për mbrojtjen e fëmijëve si dhe një studim të bërë për këtë çështje.

Në vitin 1999 ka filluar një projekt i BB-së lidhur me shpërndarjen e shërbimeve sociale në komunitet. Thelbi i këtij projekti është zbatimi i një praktike të re të shërbimit social, me qëllim që të futen forma të shërbimit social që të jenë sa më ndryshueshme dhe sa më pranë komunitetit. Praktika botërore e shërbimit social na mëson se nuk ka praktikë më të mirë të shërbimit social se sa decentralizimi i tij.

Ky projekt konsiderohet i suksesshëm, pavarësisht nga mangësitë e tij. Janë rreth 47 projekte të shërbimit social në Tiranë, Durrës, Shkodër, etj. dhe është konsideruar i përshtatshëm dhe mendohet të shtrihet edhe në tetë rajone të tjera. Është i mirë si shërbim social edhe për mënyrën se si është realizuar. Në organet e pushtetit vendor, këto struktura po kufizohen, pasi do të kalojnë në përgjegjësi të pushtetit vendor.

Problem është financimi, por ky do të zgjidhet në fund të këtij viti. Mendohet që burimet të sigurohen nëpërmjet:

- shpërndarjes së grantit për qeveritë vendore;
- detyrimit të pushtetit vendor (që aktualisht nuk po bën gjë)

Pavarësisht nga disa probleme, projekti i Bankës Botërore nuk duhet vënë në dyshim.

Disa nga rreziqet e projektit:

- Skepticizmi që kanë aktorët; gjithsesi ne nuk mund të kthehemi mbrapsh tashmë që kemi bërë gjysmën e liqenit me not. Çështja shtrohet: Të kthehemi në format e vjetëruara apo drejt formave të reja: shërbimi komunitar? Këtij projekti të BB duhet t'i kthejmë vemendjen e duhur.
- Financimi;
- Shpërpjestimi që ka ky projekt lidhur me grupet vulnerabël. Ky shpërpjestim nuk përputhet me politikat e vendit tonë. Duhet mbështetja që japin organizatat jo-qeveritare për fëmijët.

Projekti i BB është i rëndësishëm sepse:

- në sajë të këtij projekti ne kemi një ligj që mbështet decentralizimin;
- nga ky projekt ne mundëm të hartonim standartet e para për shërbimin social;
- BB dhe ky projekt na ndihmoi për ta futur këtë në një shtrat institucional, gjë që ka ndikuar në ndërtimin e strukturave rajonale të shërbimit social. Krijimi i 4 qarqeve në shërbimet për fëmijët dhe krijimi i kapaciteteve që merren me këtë punë, është një sukses i madh.

18

Konkluzionet rreth diskutimeve për ditën e parë të konferencës

- Dita e parë e konferencës për mbrojtjen e fëmijës, të rinjve dhe familjes duhet konsideruar si një ditë e suksesshme pune, e cila vërtetoi që ky eveniment organizohet në kohën e duhur, sepse reforma e shërbimit social është në një moment kritik, në kuptimin pozitiv.
- Ne duhet të veprojmë bashkë, të krijojmë sinigji, të krijojmë një strukturë kompakte ku të veprojnë të gjitha hallkat për mbrojtjen e fëmijës.
- Në seancën e sotme pati vlerësim politik pasi morën pjesë 2 titullarë nga Ministria dhe nga organizatat ndërkombëtare të ndryshme që kanë njohuri në këtë fushë.
- Në këtë konferencë morën pjesë politikë-bërësit si dhe ata që kanë detyra ekzekutive. Pra ky sistem ndërtohet nga ne që jemi në sallë dhe deri tek ata që kanë lënë sallën.
- Në këtë ditë ishim bashkë të gjithë, të gjithë aktorët, ne që kemi vendin tonë në këtë sistem e të mendojmë se cili do të jetë nesër roli ynë.
- Seanca e sotme tregoi një nivel të lartë të prezantuesve nga Kanadaja dhe Italia të cilët sollën informacione për të cilat ne kishim nevojë.
- Tashmë kuptojmë se sistemi i mbrojtjes së fëmijëve nuk kufizohet vetëm me një Ministri apo shoqatë, por duhet një ndryshim konceptual. Sistemi është një sistem ortogonal, në qendër të këtij rrethi është fëmija, i cili duhet të mbrohet nga ne të gjithë duke pasur secili përgjegjësinë e tij.
- Sot u vërtetua nevoja për angazhimin e strukturës piramidale (të shtetit). Ne jemi ende me një këmbë në sistemin e vjetër dhe një këmbë në sistemin e ri dmth. Angazhimin e komunitetit. Kjo konferencë duhet t'i japë një shtysë kësaj lëvizjeje.
- Sot u fol për statistikat sociale. Ky është një difekt shumë i madh. Statistikat janë të vështira për t'i nxjerrë. Ne nuk kemi struktura për statistikat sociale dhe jo se na mungon dëshira. Si

mund të punohet nëse nuk i kemi këto në të gjitha nivelet. Si mund t'i identifikojmë grupet vulnerabël. Nuk kemi statistika në nivel komune që të bëjmë një vlerësim dinamik të nevojave të fëmijëve.

- Që të funksionojë ky sistem duhet bashkëpunim midis të gjitha hallkave. Sekretariati teknik ka detyra të rëndësishme në këtë çështje.
- Rolet e pushteteve vendore janë të zbehta. Në njësitë Kukës, Elbasan dhe Gjirokastrë ende ka një problem: nuk po arrihet që pushteti vendor të ndryshojë dhe të bëjë më shumë për këtë. Duhet të shtohet presioni ndaj pushtetit vendor për fëmijët në nevojë.
- I rëndësishëm është kalimi i këtyre institucioneve në varësi të pushteteve lokale, administrim manaxhim dhe financim të pushtetit.
- Shqetësimi për vitin 2008 lidhur me projektin e Bankës Botërore është se as ne nuk kemi mënyra financimi për të financuar projektet pas vitit 2008; as pushteti vendor nuk ka mënyra financimi. Kjo duhet të silltet në vëmendje të qeverisë.
- Ndërtimi i këtij sistemi ka nevojë për protokolle lidhur me ndarjen e përgjegjësi. Ligji, policia si institucion edukimi, etj. duhet të hartojnë protokolle përgjegjësish dhe marrëdhëniesh për ta vënë në mbrojtje fëmijën.
- Decentralizimi i Pushtetit vendor dhe lokal: rolet e reja që do të kenë qarku, bashkia dhe komuna. Këto duhet të diskutohen në grupe.

Në përfundim të ditës së parë të konferencës Znj. Galit Wolfensohn theksoi edhe një herë se qëllimi i konferencës ishte që të bashkojë të gjithë njerëzit me qëllim që ata të flasin për një temë që i shqetëson të gjithë. Më pas ajo i informoi pjesëmarrësit për metodologjinë e punës në ditën e dytë të konferencës: ndarjen në sektorë, ku secilit grup do t'i jepej një material mbi të cilin do të ndërtonte punën e tij në grup. Çdo grup kishte a) një lehtësues, b) një person teknik; dhe c) një raportues. Pjesëmarrësve ju kërkua që të jepnin rekomandime të mbështetura në realitetin aktual shqiptar.



Punë në grup sipas sektorëve

Dita e dytë

25 shtator 2007

Seanca e ditës së dytë u hap nga Znj. Galit Wolfensohn, e cila shpjegoi metodologjinë e punës, përbërjen e grupeve të punës dhe rolet e secilit anëtar të grupit. Pjesëmarrësit u ndanë në grupe sektoriale. Secili grup kishte një ndihmës, një ekspert teknik dhe një raportues. Ndihmësi/lehtësuesi kishte si detyrë orientimin e anëtarëve të grupit që të punonte në përputhje me pyetjet. Roli i ekspertit teknik ishte njohja ose sjellja në vëmendje të të gjitha politikave që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve. Raportuesi do të bënte prezantimin e punës të bërë në grupet sektoriale dhe përmbledhjen e diskutimit në një dokument. Më pas raportet individuale, diskutimet, bashkë me rekomandimet e grupeve të punës u përmbledhën në një dokument të vetëm, i cili do t'u bëhet i ditur politikanëve dhe Ministrive përkatësve dhe të përdoren si argumente për të përcaktuar se ç' duhet bërë në këtë fushë.

Pjesëmarrësve në konferencë ju rekomandua që të kishin parasysh modelet pozitive të prezantuara në ditën e parë. Për angazhimin e secilit nga personat që kishin role të ndryshme ishin hartuar edhe termat e referencës për secilin.

Pjesëmarrësit, të ndarë në grupe sektoriale, diskutuan hapat e bëra deri tani, mundësitë për bashkëpunim midis sektorëve dhe sugjerime për hapat e mëtejshme. Secilit grup sektorial ju bënë të ditura çështjet për diskutim si dhe ju dha një rast studimor që lidhej me pikën 2. Gjithashtu, pjesëmarrësit u inkurajuan që të kontribuonin me çështje të tjera, me qëllim që të pasurohej diskutimi dhe ai t'i afrohej sa më shumë realitetit dhe zgjidhjeve të mundshme.

20

Kushtet e Referencës Për Grupet e Punës Sektoriale

Ekipi i përbërë nga lehtësuesi, eksperti teknik dhe raportuesi ishte përgjegjëse për:

- Nxitjen e diskutimeve/debate energjike, të qarta dhe gjithë-përfshirëse rreth pyetjeve të diskutimit;
- Nxjerrjen dhe konsolidimin e rekomandime specifike për sektorin;
- Përgatitjen e një raporti të përmbledhur të grupit të punës ku të përfshiheshin diskutimet kryesore dhe dokumentimin e rekomandimeve sipas Udhëzimeve për Raportim;
- Punën me raportuesin e Konferencës për të finalizuar raportin e secilit grup, i cili do përfshihet në Raportin përfundimtar të Konferencës.

Për çdo rol u hartuan termat e referencës.

Ndërmjetësi kishte përgjegjësi për:

- Dhënien e shpjegimeve anëtarëve të GP (grupi punës) lidhur me qëllimin dhe rezultatet që priteshin prej tij;
- Ndërmjetësimin gjatë diskutimeve midis anëtarëve të GP, duke përdorur pyetjet e diskutimit si udhëzues;
- Garacinë që të gjitha pyetjet të trajtoheshin gjatë diskutimit. Këtu përfshihet dhe drejtimi i diskutimit në rastet kur ka shmangie nga tema;

- Garancinë që çdo anëtar i grupit të punës të kishte mundësinë të jepte mendimin e vet;
- Përmbledhjen e pikave të ngritura gjatë diskutimeve, dhe të ndihmonte në nxjerrjen e temave dhe pikave për debat;
- Ndërmjetësimin gjatë formulimit të rekomandimeve specifike për sektorin nga anëtarët e GP;
- Paraqitjen e rezultateve të grupit të punës në forumin plenar (“World Café”) dhe ndërmjetësimin gjatë diskutimeve/kërkesave përkatëse me pyetje/feedback;
- Bashkëpunimin me ekspertin teknik dhe raportuesin për të finalizuar raportin përfundimtar sektorial të GP.

Eksperti Teknik duhej:

- të kishte njohuri të thella teknike për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve sipas sektorit specifik dhe të ishte i gatshëm që të siguronte ekspertizë teknike specifike për sektorin gjatë diskutimit të grupit të punës duke bërë ndërhyrjet e përshtatshme me temën dhe në kohë;
- të ndihmonte në identifikimin dhe nxjerrjen e çështjeve kritike të ngritura nga anëtarët e GP që kishin të bënin me mbrojtjen e fëmijës dhe familjes;
- të kontribuonte me elemente thelbësore në diskutimin e grupit të punës për të siguruar që çështjet të trajtoheshin në gjerësi;
- të mbështeste ndërmjetësin dhe të siguronte që GP i trajtonte të gjitha diskutimet kryesore në mënyrë thelbësore;
- të përpilonte dhe sillte në GP politika/stategji/plane veprimi të përshtatshme për sektorin si struktura me anë të të ciave të formuloheshin rekomandimet;
- të ndihmonte GP të artikulonte rekomandimet bazë;
- të punonte me ndërmjetësin dhe raportuesin për të finalizuar versionin përfundimtar të raportit sektorial të GP;

Raportuesi kishte përgjegjësi që:

- të siguronte pjesëmarrjen në të gjithë seksionin e grupit të punës;
- të mbante shënim të gjithë diskutimet gjatë seksionit të GP. Të shtypte shënimet në laptop dhe t'i ruante ato për të shmangur humbjen e të dhënave;
- të mbante shënime mbi feedback dhe diskutimet gjatë seksionit plenar (World Café) të këtij sektori;
- të hartonte një raport të përmbledhur të grupit të punës mbi diskutimet, rekomandimet, sipas udhëzimeve për raportimin;
- të punonte me ndërmjetësin dhe ekspertin teknik për të finalizuar versionin përfundimtar të raportit sektorial të GP;
- të ndante raportin përfundimtar të GP me Raportuesin e Konferencës dhe të jepte feedback mbi raportin përfundimtar të konferencës.



Pyetje për diskutim në grupin e punës

1. Në një sistem ideal kombëtar për mbrojtjen e fëmijës, të rinjve dhe familjes, cilat **duhet** të jenë detyrat kryesore të sektorit? (Lutemi referojuni parimeve dhe elementeve bazë të një sistemi mbrojtjeje.)
2. Çfarë mekanizmesh mbrojtjeje të fëmijës, rinisë dhe familjes **ekzistojnë aktualisht** në këtë sektor¹? Si ndryshon kjo nga ajo që **duhet** të jetë? (shih më lart). Kur të përgjigjeni, mbani parasysh:
 - Legjislacionin/Politikat/Strategjitë/Protokollin;
 - Institucionet/Strukturat/Pikat e referimit;
 - Specialistët/Profesionistë të kualifikuar;
 - Shërbimet.
3. Mbase identifikohet fëmija që ka nevojë për mbrojtje, cilat janë hapat që do ndërmerren? **Si referohen** ato brenda sektorit? A ka protokolle të qarta që të shpjegojnë hapat që ndërmerren nëse një fëmijë identifikohet dhe kush është përgjegjës për t'i ndërmarrë këto hapa? Nëse protokollin ekziston, a është ndërgjegjësuar personeli dhe a di ai të veprojë në këto raste? Nëse jo, cilat janë pengesat për krijimin e tij? *(Një ushtrim i mundshëm: Analizoni një rast studimi dhe nga kjo*

¹ Nëse është e përshtatshme analizoni organigramën në letrat e references dhe rifreskoni nëse është e nevojshme

- a. Identifikimi i fëmijës që ka nevojë për mbrojtje
- b. Regjistrimi i rastit
- c. Referimi i brendshëm apo te një agjenci/sector tjetër
- d. Vlerësimi i rastit individual
- e. Vendosja e rastit të emergjencës, nëse është e nevojshme
- a. Shërbimet e specializuara
- b. Administrimi i rastit
- c. Mbyllja e rastit

nisuni për të përgatitur një tabelë treguese që shpjegon rrugën e fëmijës nga identifikimi i tij deri në referimin brenda sektorit).

4. Si bashkëpunon ky sektor me sektorët e tjerë në rastet e administrimit dhe referimit? A ekzistojnë **mekanizma referimi bilaterale apo multilaterale**; nëse po cilat janë ato? Si funksionojnë ato në praktikë (pikat e forta dhe anët e dobëta të tyre)? Çfarë kërkohet që të krijohet një bashkëpunim ndër-sektorial efektiv? Kur të përgjigjeni lutemi specifikoni sektorët me të cilët do të bashkëpunoni dhe çfarë duhet vendosur në nivele lokale, rajonale dhe kombëtare.
5. Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta në këtë sektor në lidhje me masat për mbrojtjen e fëmijëve, si për parandalimin ashtu dhe për mbrojtjen dhe rimëkëmbjen e tyre? (Ju lutemi referojuni elementëve dhe parimeve bazë të një sistemi mbrojtjeje.)
6. Çfarë kërkohet për të forcuar reagimin mbrojtës në këtë sektor? Kur të formuloni rekomandimet, ju lutemi:
 - Kufizoni rekomandimet në termat e parimeve dhe elementeve bazë për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve²;
 - Dalloni përmirësimet që mund t'i bëhen sektorit në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar;
 - Ndani rekomandimet në ato ndryshime që duhen në nivelin (a) e legjislacionit dhe procedurave, (b) kuadrit institucional (p.sh. strukturat shtetërore), (c) ngritjes profesionale (zhvillimi i burimeve njerëzore dhe infrastrukturës), (d) shpërndarjes së shërbimeve (cilat janë shërbimet e specializuara që duhen ofruar dhe ku?);
 - Përshkruani cilat nga mekanizmat ndër-sektorialë janë të nevojshëm.



Raste për studim

Arsimi:

Sara është 8 vjeç në klasën e tretë të shkollës fillore. Në tre muajt e fundit, Vilma, mësuesja e klasës së tretë ka vënë re se Sara ka qëndruar e veçuar. Disa herë ka ardhur në klasë me shenja në fytyrë. Kur Vilma e ka pyetur çfarë ka ndodhur, ajo i ka thënë që është rrëzuar kur po vinte në shkollë. Vilma takon prindërit e Sarës në një mbledhje në shkollë dhe i pyet nëse gjithçka është në rregull në shtëpi. Ata i thonë që gjithçka shkon mirë.

Çfarë masash duhen marrë? Nga kush dhe pse?

Shëndetësia:

Dr. Haxhibi, pediatër bën kontrollin e zakonshëm mjekësor të Ariolës, 5 vjeç. Ai vë re se ajo ka shenja pranë organeve gjenitale, dhe mbas inspektimit vë re që ajo është dhunuar seksualisht. Dr. Haxhibi flet me nënën e Ariolës duke kërkuar të kuptojë më shumë. Ai i thotë çfarë ka zbuluar dhe kupton që di nëna. Ai i thotë që ajo duhet ta mbrojë Ariolën dhe ajo i përgjigjet që gjithçka është nën kontroll dhe ai nuk duhet të ndërhyjë.

Grupi ndër-sektoral: *Çfarë masash duhen marrë? Nga kush dhe pse?*

Një fëmijë një vjeç është shtrirë në trotuar, në qendër të një qyteti, ndërsa njerëzit ecin dhe i japim monedha. Fëmija as nuk qan dhe as nuk lëviz, dhe duket sikur është i droguar. Rrobat i ka

të grisura dhe ka të shenja të freskëta në trup dhe fytyrë. Nëna e fëmijës është aty pranë, duke parë fëmijën dhe duke mbledhur monedhat që lënë kalimtarët.

Çfarë masash duhen marrë? Nga kush dhe pse?

Shërbimet sociale:

Një person anonim raporton në Shërbimet Sociale Shtetërore që fëmijët, që janë strehuar në një qëndër rezidenciale private, janë duke u abuzuar. Raportuesi nuk dëshiron të bëjë një raportim zyrtar në polici pasi ka frikë nga pasojat.

Çfarë masash duhen marrë? Nga kush dhe pse?

Policia:

Policia merr një telefonatë nga fqinjët që dëgjojnë zhurma dhune në familjen pranë. Kur policia arrin në vendin e ngjarjes, sheh qartë që aty ka patur një grindje. Gruaja është rrahur dhe ka nevojë për ndihmë mjekësore. Dy fëmijët janë fshehur në një qoshe. Bashkëshorti është shumë i nevrikosur kur sheh policinë dhe i thotë që s'kanë asnjë të drejtë të hyjnë në shtëpinë e tij.

Çfarë masash duhen marrë? Nga kush? dhe Pse?

Gjyqësori³

Çfarë masash duhen marrë? Nga kush? dhe Pse?

3 Për këtë sektor nuk u shqyrtua një rast specifik



Sektor i Arsimit



Anëtarët e grupit

1. Mirela Salla, “Tjetër Vizion”, Elbasan
2. Zamira Muca, Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën
3. Skender Veliu, Albanian Roma Union
4. Majlinda Alikaj,⁴
5. Pellumb Furtuna, Rromani Baxt Albania
6. Arben Vellenga,
7. Natassa Arapidou, ARSIS
8. Adriatike Lami, DA Tiranë
9. Auorora Bushati, Unicef, Tiranë
10. Etleva Veliu, Aksion Plus
11. Edlira Luzi,
12. Anisa Subashi, DART
13. Erleta Mato, Instituti i Studimeve Pedagogjike
14. Miranda Mulgeci, Shoqata Internacionale për Solidaritet/SHIS
15. Violeta Xhanani, Shkolla “Sabaudin Gabrani”, Tiranë
16. Shaze Shehu, Drejtoria Arsimore, Gjirokastrë
17. Holta Koci, IOM
18. Majlinda Muka, Drejtoria Arsimore
19. Arjana Baci,
20. Blerina Tepelena, Shërbimet Sociale Shtetërore
21. Aida Nova, SOS

Shkolla ka një rol kyç në mbrojtjen e fëmijëve. Është bërë punë nga OJF-të dhe organizata të ndryshme. Në disa raste ka edhe qendra për mbrojtjen e fëmijëve por mungon koordinimi i tyre. Vihet re që ka më shumë dhunë fizike në familje dhe dhunë psikologjike në shkolla. Në dispozitat normative të Ministrisë ka zbrazëti për problemet shëndetësore në shkolla. Mësuesi e ka të vështirë të identifikojë një fëmijë të traumatizuar. Duhet të trajtohen mësuesit. Numri i psikologëve në shkolla nuk është i mjaftueshëm. Në shumë raste nuk njihet kuadri ligjor. Në të konstatohen mangësi të cilat duhen riparuar. Njësitë bashkiake duhet të njihen më mirë me këto probleme dhe duhet të marrin pjesë aktive në zgjidhjen e tyre.

Sipas dispozitave të reja, drejtori i shkollës dhe mësuesit zgjidhen sipas aftësive të tyre, shprehje kjo e demokratizimit të shkollës. Kjo është një nismë në fillimet e veta që duhet çuar më tej. Në shkolla ka organizma si Bordi i Prindërve, Qeveria e Nxënësve, por si dhe sa funksionojnë ato, është një çështje që duhet parë me kujdes.

Vihet re që mësuesit e rinj kanë fare pak njohuri për të drejtat e fëmijëve. Janë bërë disa përpjekje në Fakultetet e mësuesisë në Universitetet rajonale si ai i Elbasanit, Gjirokastrës, etj. që të përfshijnë në kurrikulat e tyre të drejtat e fëmijëve. Kjo është një çështje që duhet ndalur seriozisht.

Problem është infrastruktura në shkollë. Shtrohet pyetja: “Sa ka bërë kjo shoqëri për këta fëmijë në drejtim të mjedisit për fëmijë? Me keqardhje konstatojmë që pak është bërë.

Duhet parë kuadri ligjor: Në rastet kur fëmija dhunohet, pasi ai evidentohet, resti kalon në Drejtorinë Arsimore, por problemi është se ç’duhet të bëjmë më tej. Cila është hallka tjetër lehtësuese që ta shpëtojë fëmijën?

⁴ Mungon informacioni (është e aplikueshme për të gjithë pjesëmarrësit që iu mungon emri i institucionit që përfaqësojnë)

Shoqërimi i i fëmijëve është tjetër problem në të gjithë vendin. Në shumë raste shkollat janë larg. Fëmijët romë janë një grup tejet i rrezikuar dhe duhet t'u kushtohet më shumë vëmendje.

I rëndësishëm është kualifikimi i drejtuesve dhe mësuesve. Ka shumë gjera që mund të bëhen në mënyrë të përbashkët. Një shembull mund të ishte koordinimi i punës së mjekut me atë të psikologut.

Me rëndësi është krijimi i bazës së të dhënave. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka një plan për pajisjen e të gjithave shkollave me kompjuterë. Duhet dhënë dhe shpërndarë informacion lidhur me gjithçka që ofrojnë OJF-të.

Një problem i madh është se shkollat nuk kanë buxhet të tyre që ta përdorin për raste që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve. Kërkohe më shumë transparencë lidhur me buxhetin në nivel qendror.

Shkolla ka përgjegjësi që të sigurojë që mjedisi i shkollës të mbetet i sigurtë për të gjithë fëmijët, pa dallime etnike dhe origjine dhe të koordinojë të gjitha veprimet, bashkë me strukturat brënda dhe jashtë shkollës, për të mirën e fëmijëve. Kjo nënkupton shërbime dhe trajnime që ofrohen nga subjekte të ndryshme.

Me rëndësi është çështja e së drejtës për edukim veçanërisht për minoritetet. Kjo mbetet një faktor i rëndësishëm për mirëqënien e shoqërisë që ne dëshirojmë të ndërtojmë për mbrojtjen e fëmijëve. Nuk mund të flitet për mjedis të sigurtë dhe miqësor kur fëmijët nuk kanë të drejtë për shkollim:

Legjislacioni, i cili shprehet se fëmijët mund të regjistrohen pa çertifikatë lindjeje, nuk mund të zbatohet pasi ekzistojnë një varg dokumentash që duhet të dorëzohen në mënyrë që fëmija të regjistrohet në shkollë. Kur nuk je i pajisur me çertifikatë duhet të dorëzosh librezën e vaksinave, e cila lëshohet vetëm nëse tregon çertifikatën e lindjes ose kur punonjësja e poliklinikës nuk e kërkon atë. Kështu, edukimi i fëmijëve, mund të varet në dëshirën e mirë të punonjësës së poliklinikës.

Çertifikata e lindjes mbetet një problem i madh për të gjithë fëmijët romë që kanë lindur jashtë vendit dhe nuk kanë arritur të pajisen me çertifikatë në vëndin e lindjes ose kur shteti shqiptar nuk njih, për arsye të ndryshme, dokumenta të huaja të gjendjes civile.

Fëmijët e regjistruar në gjëndjen civile të qytetit X nuk mund të regjistrohen në shkollën e qytetit Z. Në shumë raste, prindërit nuk duan të transferohen në një zyrë tjetër të gjëndjes civile. Kjo nënkupton që fëmijëve të tyre do t'ju mohohet e drejta për arsimim.

Çdo minibashki ka vendosur taksa për banorët e saj dhe vetëm kur të jetë kryer pagesa ato mund të japin dhe pajisin banorët me çertifikata lindjeje. Gjithashtu, ekziston edhe një limit kohor, fundi i shtatorit, dhe nga tetori banorët duhet të paguajnë edhe një gjobë për moskryerjen e detyrës së tyre në kohë. Shumë familje përballojnë probleme me buxhetin e tyre ditor dhe taksa të tilla, nuk mund të paguhen kur familja është duke luftuar për ushqimin e përditshëm.

Tre faktet e mësipërme duhet të merren seriozisht në konsideratë nga autoritetet përkatëse, përpara se efektet e tyre të çojnë në përjashtimin e më shumë fëmijëve nga arsimit. Është për të ardhur keq që regjistrimi në shkollë akoma varet, ndonjëherë, në dëshirën e mirë dhe qëllimin e secilit drejtor shkolle që mund të përdorë të gjitha llojet e shfajësimeve, me qëllim që të evitohë fëmijët minoritarë në shkollën e tij/saj. Në këtë rast, i vetmi rekomandim mund të ishte që **drejtorët e shkollave të ndjekin nga afër inspektorët e arsimit.**

Për sa i përket braktisjes së shkollës duhet të ekzistojë një mekanizëm i cili të vejë në dijeni shkollën dhe familjarët, në mënyrë që të mënjanohet çdo pasojë që mund të dëmtojë fëmijën si fizikisht edhe mendërisht.

Rekomandime

- Të rritet shkalla e bashkëpunimit midis mësuesve, prindërve, DAR-eve, Bashkive, komunave, si dhe kualifikimi i tyre;
- Të intensifikohet kualifikimi i stafit pedagogjik në fushën e mbrojtjes së fëmijëve;
- Të pasurohet kurrikula e arsimit të detyruar me çështjet që lidhen me trajtimin të fëmijëve në shoqërinë shqiptare;
- Të plotësohet kurrikula në fakultetet e mësuesisë në universitete me njohuri mbi psikologjinë e zhvillimit dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- Të përmirësohet infrastruktura shkollore dhe komunitare në dobi të mirëqenies së fëmijëve;
- Të përmirësohet kuadrin ligjor për mbrojtjen e fëmijëve dhe të punohet për njohjen e tij nga të gjithë aktorët e shoqërisë;
- Të sigurohet shoqërimi i fëmijës shtëpi – shkollë – shtëpi nëpërmjet transportit të organizuar për këtë qëllim;
- Të shihet si prioritet edukimi dhe trajtimi i fëmijëve romë si grup në risk;
- Të kualifikohen drejtuesit, mësuesit dhe stafi psikosocial i shkollave si menaxhues të të drejtave të njeriut;
- Të forcohet roli i prindërve nëpërmjet ngritjes së bordeve rajonale dhe lokale;
- Të rritet shkalla e informacionit dhe e koordinimit ndërmjet njësive që merren me mbrojtjen e fëmijëve;
- Të merren masa për një zhvillim më të mirë të punës ndërsektoriale;
- Të përgatitet një bazë të dhënash lidhur me shërbimet që ofrojnë OJF-të e ndryshme nëpërmjet mjeteve elektronike;
- Të rritet buxheti dhe transparenca e tij, të sigurohet pjesëmarrja e të gjithë aktorëve në planifikimin e tij;
- Të ndërtohet një plan shumësektorial për mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijëve në kushtet bashkëkohore.



Sektori i Shëndetit



Anëtarët e Grupit

1. Lumturi Mërkuri – ISHP
2. Vasil Miho – OBSH
3. Gjergj Lulaj- Drejtoria Rajonale e Shërbimeve sociale, Lezhë
4. Mariana Bukli – UNICEF
5. Nedime Ceka- MSH
6. Marçel Laçaj- Drejtoria rajonale e shërbimeve sociale Lezhë
7. Rovenë Prifti – INSTAT
8. Valeria Moreti – Itali
9. Mimoza Malushaj- Forumi i fëmijëve të abuzuar seksualisht
10. Shykri Shehi – Drejtor i Shërbimeve Sociale, Dibër
11. Albana Demirxhi – MSH
12. Miranda Spahiu – MSH
13. Eli Gjika- MSH
14. Migena Kika – QKZHMF
15. Emanuela Bello – UNFPA

Përgjegjësitë e sektorit:

- Krijimi i një rrjeti shërbimesh për përfshirjen e fëmijëve të integruar në sistemin aktual shëndetësor;
- Ngritja e Sistemit të mbledhjes së të dhënave;
- Zhvillimi i Programeve arsimore dhe promocioni me bazë komunitare;
- Kualifikimi i vazhdueshëm i personelit (kualifikim në shkollë dhe në punë)

Mekanizmat aktuale të mbrojtjes:

- Legjislacioni ekzistues: ligji për parandalimin e dhunës në familje, ligji i shëndetit riprodhues, ligji i ushqyerjes me gjë, udhëzues për kujdesin dhe mirërritjen e fëmijëve;
- Protokollat për mjekun e familjes janë duke u përgatitur nga MSH, Fakulteti i Mjekësisë, Shoqata e Punonjësve Sociale dhe UNICEF;
- Protokollat për infermieret, të cilat duhen hartuar.

Referimi brenda sektorit

- Mungon infrastruktura për referim;
- Mjeku/infermieri identifikon rastin, trajton, këshillon dhe referon fëmijën në shërbimet sociale, por sistemi i referimit nuk është efektiv;
- Mungesa e protokolleve.

Bashkëpunimi me sektorët e tjerë:

- Shërbimet sociale
- Mjekësia ligjore- drejtësia
- OJF
- Arsimi

Çfarë duhet bërë?

- Të krijohen ekipet multisektoriale;
- Të hartohen Protokollat dhe marrëveshjet e bashkëpunimit;
- Të shkëmbehet informacion dhe të krijohen lidhje me autoritetet lokale;
- Të zhvillohen raportimet periodike.

Pikat e forta dhe të dobëta

a) Pikat e forta

- Ekzistenca e legjislacionit dhe politikave;
- Ekzistenca e një rrjeti të gjerë të shërbimit shëndetësor parësor dhe në tre nivelet.

b) Pikat e dobëta

- Zbatimi në praktikë i ligjeve dhe rregulloreve;
- Mangësi në trajnimin e personelit;
- Lidhja e pamjaftueshme dhe koordinimi ndërmjet sektorëve (sektori i shërbimeve sociale, drejtësia);
- Lëvizjet e shpeshta të personelit të trajnuar;
- Mungesa e ekipeve multidisiplinore.

Rekomandimet

- Të identifikohen dhe harmonizohen prioritetet midis sektorit shtetëror, sektorit privat, OJF-ve dhe partnerëve të tjerë;
- Të integrohen në të gjithat manualat dhe procedurat e punës së qendrave shëndetësore dhe spitaleve çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve;
- Të planifikohen linjat të veçanta buxhetore për mbështetjen e ndërhyrjeve të përshkruara më sipër;
- Të hartohen protokolle për çdo nivel shërbimi për identifikimin, rregjistrimin, koordinimin, dhe referimin e rasteve të dyshuara për dhunë dhe abuzim;
- Të trajnohet stafi mjekësor për rëndësinë e parandalimit të dhunës dhe abuzimit, trajtimit dhe referimit të fëmijëve viktime të dhunës dhe komunikimit;
- Të trajnohet stafi mjekësor mbi mënyrat e referimit dhe komunikimit me shërbimet e tjera të mbrojtjes së fëmijës në komunitet, të cilat operojnë në zonën e tyre;
- Sistemi i informacionit shëndetësor kombëtar duhet të përfshijë edhe rregjistrimin, dokumentimin dhe përpunimin e të dhënave për rastet e dhunës.
- Të ngrihet zëri tek vendimmarrësit dhe drejtuesit e sistemit shëndetësor, me qëllim që të arrihet mbështetja dhe angazhimi i tyre për trajtimin e problemit të dhunës në familje;
- Të përfshihen tema se si parandalohet dhe trajtohet dhuna në programet e kualifikimit profesional në shkollë dhe gjatë punës;
- Të ndërgjegjësohet dhe të rritet niveli arsimor dhe njohuritë mbi promovimin shëndetësor si të personelit shëndetësor edhe të komunitetin;
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta duhet të koordinojë punën midis sektorëve. Të sigurojë bashkëpunimin midis sektorëve të ndryshëm.



Sektori i drejtësisë



Anëtarët e grupit

1. Etilda Saliu, Komiteti Shqiptar i Helsinkit
2. Eralda Cani, Qendra "Fëmijët Sot"
3. Arta Vorpsi, Gjykata Kushtetuese
4. Marilda Menkshi, Avokati i Popullit
5. Anilda Gurakuqi, Avokati i Popullit, Shkodër
6. Vangjel Kosta, T-LAS
7. Danjiela Shkalla, BKTF
8. Eriketa Korini, Ministria e Drejtësisë
9. Anisa Haxhia, T-LAS
10. Blerina Metaj, CRCA
11. Anila Nepravishta, Avokati i Popullit
12. Elda Kalaja, Avokati i Popullit
13. Tomas Stravinskis, OSBE
14. Rezarta Abdiu, QShPLI

Gjatë konferencës 2 ditorë pjesëmarrësit patën mundësinë të informohen në ditën e parë nga prezantimet e ndryshme mbi sistemet e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri dhe të shkëmbejnë ide mbi implementimin e legjislacionit shqiptar në sferat e ndryshme sociale, juridike dhe ekonomike në shoqërinë shqiptare.

Dita e dytë e Konferencës Kombëtare ishte një ditë shumë e dobishme, pasi vetë përfaqësuesit e organizmave të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare u bënë aktorë kryesorë të analizimit dhe prezantimit të sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe zbatimit të tyre në praktikë. Pjesëmarrësit u ndanë në gjashtë grupe pune sipas përkatësisë profesionale. Ata kontribuan me njohuritë dhe eksperiencat e tyre në fushat përkatëse.

Grupi i drejtësisë përbëhej nga përfaqësues të institucioneve shtetërore si Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, gjyqtarë, organizatat joqeveritare si TLAS, BKTF, QSHLPI, ekspertë të pavarur, etj.

Ky grup analizoi me vëmendje pyetjet e paraqitura nga UNICEF mbi sistemet e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri dhe nxorri rekomandime të rëndësishme mbi këto sisteme nga pikëpamja e aspektit ligjor dhe e zbatimit të tyre.

Së pari u shtrua çështja se si do të funksiononte sistemi i mbrojtjes së fëmijës në legjislacion ku parimi kryesor është interesi më i lartë i fëmijës. Grupi evidentoi legjislacionin duke e analizuar këtë parim si në aspektin ligjor edhe në atë praktik. Koncepti i sistemit të mbrojtjes së fëmijës bazohet në nenin 19 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Ky nen paraqet bazën e një sistemi ideal mbrojtjeje në tërësi nëpërmjet parimeve kryesore. Neni 19 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës është neni mbi të cilin bazohet sistemi i mbrojtjes së fëmijës. Grupi i punës bëri disa sugjerime lidhur me disa ndryshime apo përmirësime në legjislacion.

Ligjvënësit kanë patur parasysh parimin e "interesit më të lartë të fëmijës", duke përfshirë parimet e shprehura në dokumentet ndërkombëtare siç është Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Mjaft rregullime ligjore shqiptare si Kodi i Familjes, Kodi i Proçedurës Civile dhe Penale e të tjera, kanë marrë parasysh parimin e "interesit më të lartë të fëmijës". Legjislacioni ka parashikuar hapësirat e nevojshme, dhe bën të mundur realizimin e këtij parimi. Problem është asistimi i fëmijës në praktikë nga profesionistë, në rastet kur ai ballafaqohet me këto procedura ligjore.

Nga ana tjetër miratimi i ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili ka hyrë në fuqi më 1 qershor të vitit 2007, përbën një risi në rregullimin e situatave familjare, e posaçërisht në situata që kanë lidhje me fëmijën. Ky ligj, jo vetëm, që parashikon masat e menjëhershme ndaj dhunës, por dhe i rregullon këto masa nga pikëpamja procedurale. Gjykata është organi i cili ekzekuton parashikimet e këtij ligji nëpërmjet vendimeve të saj. Vendimet e gjyqtarëve i përmbushin kriteret për të qenë të ekzekutueshëm, pasi një vendim gjykate përbën titull ekzekutiv dhe është menjëherë i ekzekutueshëm.

Organet e tjera, të cilat janë pjesë e sistemit të mbrojtjes së fëmijës si prokuroria apo policia, janë hallkat e para të identifikimit të një situatë mbrojtjeje të fëmijës. Në këto raste, organi i policisë apo i prokurorisë duhet të kërkojë prezencën e psikologut. Në legjislacionin, përveç parashikimit të prezencës së detyruar të psikologut, përmendet termi “punonjës edukimi”, dhe jo termi “psikolog”, si ekspert që mbështet fëmijën.

Dallimi i punonjësit social nga psikologu nuk bëhet i dukshëm në legjislacionin tonë. Pamundësia për të gjetur psikologë dhe për të ofruar shërbime, ka çuar në zëvendësimin e tij me punonjës social.

Deri tani ofrimi i shërbimit nga psikologu është mundësuar nga strukturat e pavarura jo-shtetërore. Janë përgatitur aktet nënligjore përkatëse për të përfshirë strukturën e psikologut, në rastin e marrjes në pyetje të një fëmije të dhunuar. Në Kodin e Proçedurës Penale prania e psikologut parashikohet në fazën e hetimit ndaj të miturit, por ky kod nuk parashikon se çfarë pasoje ligjore do të sillte mungesa e tij. Megjithatë, nëse pyetjet ose provat nuk merren sipas procedurave të këtij Kodi, ato nuk përbëjnë provë dhe nuk vlerësohen nga gjykata. E njëjta mangësi vërehet edhe në Kodin e Familjes.

Ligjet e veçanta, që i ofrojnë mbrojtje fëmijës, janë të pakta. Nga ana tjetër janë hartuar mjaft strategji kombëtare dhe po punohet që në to të trajtohet problemi i krijimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijës. Strategjia kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve ka përfunduar. Aktualisht po punohet për Strategjinë Kombëtare për kujdestarinë. Mangësia e strategjive qendron në faktin se ato shoqërohen pa faturë ekonomike përkatëse, duke vështirësuar zbatimin e tyre.

Në gjykatat e rretheve, që nga muaji shtator, me dekret të Presidentit të Republikës është krijuar seksioni për të miturit, sipas të cilit kërkohet që të caktohen, gjyqtarë të posaçëm të cilët do të gjykojnë rastet që kanë si objekt të gjykimit të miturit.

Sipas të dhënave të Avokatit të Popullit nuk ekzistojnë psikologë pranë Komisariateve të Policisë. Buxheti që i akordohet Drejtorisë së Policisë nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar shërbimet e psikologut.

Ligji “Për trajtimin e të dënuarve në institucionet e vuajtjes së dënimit” përfshin krijimin e seksioneve të veçanta pranë institucioneve të posaçme për të miturit të vuajtjes së dënimit, në nenin 17, por del e nevojshme hartimi i akteve nënligjore, që të mundësojnë rregullime më të detajuara. Ky ligj ka nevojë të përmirësohet, përse i përket trajtimit të grave apo grave me fëmijë.

Sistemi i paraburgimit është në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka përgatitur rregullore për këtë sistem në bashkëpunim me SIDA dhe UNICEF, në bazë të një projekti 3 vjeçar. Ky projekt përfundon në tetor dhe është zbatuar në qytetin e Vlorës, Tiranës dhe Lezhës.

Meqë legjislacioni ka nevojë për përmirësime, Ministria e Brendshme ka sugjeruar që të shtohen dy nene të veçanta në Kodin Penal në lidhje me trafikimin e fëmijëve.

Kodi Penal sanksionon praninë e psikologut, por duhet të specifikohen edhe rastet e pranisë së punonjësit social. Përsa i përket afateve kohore për trajtimin e rasteve të të miturve në interes të fëmijës, koha nuk duhet të përgjysmohet, sikurse ndodh me të rriturit.

Lidhur me Kodin e Fëmijës, është menduar që të analizohet nëse është i nevojshëm hartimi i tij. Nga ana tjetër ekzistojnë mjaft rregullime ligjore të shpërndara nëpër kode apo ligje të veçanta në lidhje me të miturit. Mund të hartohet Kodi i Fëmijëve ose një përmbledhje ligjesh apo aktesh. Kjo mund të bëhet edhe nga organizatat jofitimprurëse.

Gjyqtarët kanë ngritur problemin për mungesën e psikologëve të licencuar të parashikuar sipas ligjit, pasi nuk ka organ që të bëjë kategorizimin e tyre në psikologë apo punonjës socialë.

Në gjykatë, gjatë gjykimit nuk parashikohet se kush duhet ta paguajë psikologun që është në rolin e ekspertit. Kjo përgjegjësi u takon palëve në proces, dmth. prindërve. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka përcaktuar kriteret në përzgjedhjen e OJF-ve që punojnë me fëmijët. Kjo Ministri ofron licencimin e këtyre OJF-ve që merren me mbrojtjen e fëmijëve.

Rekomandim: Të përgatiten akte nënligjore për realizimin e licencimit të psikologut apo punonjësit social. Pagesa e tyre mund të realizohet edhe nga vetë shteti. Meqë mungojnë aktet për licencimin e psikologëve, duke marrë si shembull licencimin e OJF-v, mund të bazohet edhe licencimi i psikologëve. Kjo situatë mund të rregullohet duke u miratuar akte nënligjore që kanë dhe do të parashikojnë pagesën e psikologut apo të punonjësit social.

Sugjerim: Kodi Penal parashikon dispozita për masa alternative të dënimit të fëmijëve. Ky kod duhet përmirësuar dhe efikasiteti i tij do të qëndronte në zbatimin në praktikë të këtyre masave, duke mos i konsideruar dënimin dhe burgun si mundësi të vetme. Problemi qëndron në faktin se mungon organi mbikqyrës ndaj zbatimit të masës alternative. Një aspekt i rëndësishëm është dhe sistemimi dhe trajtimi i fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të veprave penale.

Rekomandim: Duhet të hartohet ligji “Për periudhën e provës”.

Janë nënshkruar me Prokurorinë tre Marrëveshje Mirëkuptimi, për seksionet që lidhen me të miturit, veprat penale të kryera prej tyre, sipas të cilave caktohen prokurorë të veçantë për të trajtuar të miturit. Është hartuar edhe një marrëveshje tjetër midis Ministrisë së Brendshme dhe policisë, e cila ka të bëjë me zbatimin e akteve nënligjore të sistemit të mbrojtjes falas.

Sugjerim: Del si domosdoshmëri dhe konsiderohet më efikase, që miratimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit të jenë më të gjera, më shumëpërfshirëse, shumëpalëshe dhe ndërmjet shumë institucioneve bazë (arsimi, shëndetësia, policia, etj.)

Nëse një fëmijë është objekt i abuzimit, trajtimi i rastit të tij do të kalojë nëpër disa hapa. Ky proces parashikohet në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Hapi i parë është komisarati i policisë, i cili është institucioni i parë që merr kontakt me të miturin e abuzuar. Trajtimi ndryshon sipas rastit dhe është specifik. Policia merr kontakt me psikologun duke bërë një identifikim dhe vlerësim të rastit të abuzimit.

Abuzimi përfshin dy forma: dhunën, nëse ndaj fëmijës ushtrohet dhunë apo nëse fëmija është subjekt i kryerjes së veprës penale dhe duhet të procedohet sipas ligjit. Forma tjetër është neglizhenca: fëmija lihet pa kujdes, pa u ushqyer, pa shkollë, etj.

Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” paraqet një risi në legjislacionin tonë, megjithatë hyrja e tij në fuqi vetëm në muajin qershor bën që ai të mos njihet sa duhet nga gjykata. Nga ana tjetër, avokatët, të cilët vënë në lëvizje gjykatën, duhet që ta zbatojnë këtë ligj, duke bërë që gjykata të angazhohet dhe në vendimet e saja të parashikojë masat e përfshira në këtë ligj për mbrojtjen e fëmijës.

Rekomandim: Duhet të hartohen akte nënligjore për të krijuar lidhjen institucionale për rastet e dhunës ndaj fëmijëve, dhe për rritjen e efikasitetit të zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit të institucioneve mes tyre.

Del si domosdoshmëri përshpejtimi i hartimit të akteve nënligjore për të zbatuar këtë ligj.

Sugjerim: Të vendoset një grup pune ose një linjë telefonike 24 orëshe, që të mbledhë pranë bashkisë apo organeve të pushtetit lokal ankesat e anëtarëve të komunitetit. Linja telefonike ekzistuese të shërbejë për referimin e rasteve më të gjera të dhunës në familje.

Organet e pushtetit lokal kanë struktura apo njësi që vlerësojnë rastet e kujdestarisë që veprojnë në fillim dhe më pas vendos gjykata. Strukturat e njësive në nivel lokal duhet të forcohen dhe të shtohen kompetencat e tyre. Kapacitetet ekzistojnë, por duhen zgjeruar kompetencat. Për këtë duhet të zhvillohen trajnime dhe module duke krijuar, zhvilluar dhe përmirësuar sistemin përkatës.

Rekomandim: Njësitë në Bashki duhet të hartojnë listën e familjeve kujdestare.

Rekomandim: Të forcohen strukturat në nivel lokal, të listohen detyrat dhe të zgjerohen kompetencat e tyre. Të vihen në lëvizje kapacitetet. Ato duhet të trajnohen dhe të hartohen modulet.

Policia ka nevojë për trajnime, për formularët se si merren në pyetje të miturit. Duhet punonjës të specializuar në polici për fëmijët. Në Drejtorinë e Policisë në Tiranë është ngritur sektori i të miturve, ku janë të punësuar 2 punonjës.

Rekomandim: Në kurrikulat e Akademisë së Policisë duhet të trajtohen çështje që lidhen me Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe trajnimi i tyre të jetë i vazhdueshëm. Të bëhet evidentimi i policëve që trajtojnë të miturit.

Organi i prokurorisë mund të parashikojë vendosjen e prokurorëve të caktuar. Detyra e prokurorit të përgjithshëm duhet të jetë caktimi i prokurorëve për të trajtuar rastet e të miturve, pasi çështjet e të miturve kërkojnë trajtim të ndryshëm dhe të veçantë. Sistemi i mbrojtjes së fëmijës duhet të funksionojë, në qytete të mëdha, ku të ketë seksione në prokurori me prokurorë të posaçëm që merren me rastet e të miturve. Në qytetet më të vogla të caktohet një prokuror për trajtimin e këtyre rasteve. Edhe oficerët e policisë gjyqësore duhet të trajnohen vazhdimisht.

Për të miturit që janë nën përgjegjësi penale, mungon procedura se si të trajtohen këta të mitur kur kanë kryer vepra penale dhe janë nën moshën 14 vjeç, dmth. nën moshën e përgjegjësisë penale. Ky problem shfaqet për faktin se mungojnë qendrat e riedukimit dhe strukturat e specializuara për fëmijët që nuk kanë familje. Gjyqtarët duhet të trajnohen vazhdimisht duke e shtruar këtë si detyrë para Shkollës së Magjistraturës.

Dhoma e avokatisë të hartojë një listë me avokatë që do të merren me rastet e të miturve. Problem është mungesa e efikasitetit të avokatëve që trajtojnë rastet e fëmijëve, sidomos avokatët që kryesisht ofrojnë shërbime falas, pasi ata kanë një përgatitje të ulët profesionale dhe nuk angazhohen sa duhet.

Zbatimi i “Ligjit për gjendjen civile” paraqet shumë vështirësi. Regjistrimi i fëmijëve në regjistrat e gjendjes civile nuk mund të bëhet kur kalon afati ligjor 45 ditë. Gjykata është organi që duhet të vërtetojë faktin

e lindjes së fëmijës dhe prindërit duhet të paguajnë më pas gjobën në Zyrën e Gjendjes Civile. Të hiqen afati i mosregjistrimit si dhe procedura e gjykatës. Duhet të vendoset bashkëpunim institucional midis institucioneve shëndetësore, maternitetit dhe zyrës së Gjendjes Civile, në mënyrë që deklarimi i lindjes së fëmijës të realizohet që në momentin e lindjes së tij prej institucionit shëndetësor. Kjo gjë do të bëjë që fëmija të përfitojë çertifikatën e tij personale, e për pasojë përfiton shërbime shëndetësore dhe shmanget mundësia e trafikimit të tij.

Duhet të përmirësohet procedura e regjistrimit të fëmijëve të lindur jashtë Shqipërisë, pasi të dhënat në dokumentet e huaja kërkojnë që gjykata të vendosë për plotësimin e tyre, në mënyrë që ato të bëhen të zbatueshme në Shqipëri. Kjo është një procedurë që e ndërlikon shumë këtë proces.

Kërkohe hartimi i një ligji “Për ndihmën ligjore falas”, duke përfshirë ndihmën ligjore në fushën civile dhe penale, dhe veçanërisht ndihmën ligjore që duhet t’u ofrohet fëmijëve.

Sistemi i mbrojtjes së fëmijës ka edhe disa mangësi dhe pika të dobëta. Megjithatë, në përgjithësi, legjislacioni është i mbështetur në akte ndërkombëtare. Duhet të punohet për zbatimin e tij në praktikë. Kjo të realizohet paralelisht me forcimin e strukturave, të bashkëpunimit mes tyre, duke patur gjithmonë në fokus Konventën e Gjenevës për të Drejtat e Fëmijës.

Rekomandim i përgjithshëm

Të gjithë sektorët e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve të marrin parasysh rekomandimet e Komitetit të Drejtave të Fëmijës, mbi bazën e raportit fillestar të përgatitur nga shteti shqiptar, në zbatim të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës.

Rekomandime

- Rishikimi i ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale dhe trajtimit të të dënuarve në
- institucionet e vuajtjes së dënimit”, nxjerrja e akteve nënligjore plotësuese, duke rritur efikasitetin e zbatimit të tij;
- Hartimi i ligjit “Për shërbimin e provës”, që do të ndihmojë në zbatimin në praktikë të mbikqyrjes së një mase alternative të dënimit;
- Përmirësimi i ligjit “Për ndihmën dhe shërbimet sociale”, ku të përcaktohen më qartë kategoritë e fëmijëve në nevojë dhe shërbimet që do të përfitojnë ata;
- Rishikimin e ligjit “Për gjendjen civile”, ku sugjerohet lehtësimi i procedurave të
- regjistrimit të fëmijëve në regjistrat e gjendjes civile;
- Përmirësimi i Kodit të Proedurës Penale, në lidhje me forcimin e rolit të psikologut në fazën e hetimit dhe gjykimin të të miturve në procesin penal;
- Për zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të
- përshpejtohet procedura e nxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji;
- Përcaktimi i standarteve dhe hartimi i akteve nënligjore në lidhje me licensimin e
- punonjësit social dhe psikologut;
- Të realizohet një marrëveshje shumëpalëshe midis të gjithë sektorëve që marrin pjesë në sistemin e mbrojtjes së fëmijës.
- Të krijohet rrjeti i profesionistëve në fushën e drejtësisë për fëmijët në konflikt me
- ligjin;
- Të hartohet ligji “Për ndihmën ligjore falas”, ku të jetë një kapitull i veçantë për të
- miturit.
- Të forcohen strukturat e pushtetit lokal.

26

Sektori i Mbrojtjes dhe Policisë



Anëtarët e grupit

1. Alma Gjurgji, Ndërmjetës, Sektori për Mbrojtjen e Fëmijëve në Drejtorinë e Policisë.
2. Ilir Zhurka, Ekspert teknik, specialist për mbrojtjen e fëmijëve në Drejtorinë e Policisë Qarkut Tiranë.
3. Esin Gjurgji, Raportues, UNICEF
4. Alexandre Maouche, Anëtar, UNICEF
5. Marija Mikulan, Anëtare, Misioni PAMECA
6. Arben Lila, Anëtar, Misioni PAMECA
7. Fatjon Softa, Anëtar, Kryetar i Këshillit Bashkiak Tiranë dhe Kryetar i Komisionit të Rendit Publik dhe Mbrojtjes Civile.

Strukturat mbrojtëse të fëmijëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë

- Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel qendror (në strukturën e Drejtorisë Kundër Krimeve të Rënda);
- Seksionet e analizë-koordinimit (specialistë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, kryesisht në rolin e koordinatorit);
- Seksionet e Policisë Kriminale dhe të Rendit në nivel lokal.

Misioni : Sektori për Mbrojtjen e fëmijëve ka si mision mbrojtjen e fëmijëve nga aktiviteti kriminal, kontrollin dhe ushtrimin e veprimtarisë për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe ndërprerjen e aktivitetit kriminal nga fëmijët dhe ndaj fëmijëve.

Detyrat :

Sektori për Mbrojtjen e fëmijëve ndjek këto drejtime:

- Veprat penale kundër fëmijëve;
- Veprat penale të kryera nga fëmijët;
- Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve kur ata hyjnë në kontakt me policinë në cilësinë e dëshmitarit, personit të dëmtuar, apo autorit të dyshuar për kryerjen e një vepre penale.

Detyrat Kryesore të Sektorit në një sistem ideal Kombëtar për mbrojtjen e fëmijës, të rinjve dhe familjes:

1. Parandalimi, ndërhyrja, bashkëpunimi

Eksperiencia e punës me të mitur të përfshirë në veprime kriminale ka treguar se ekzistojnë modele të ndryshme programesh për mbrojtjen e fëmijëve. Ngritja, zbatimi dhe vlerësimi i këtyre modeleve varet nga shumë faktorë që lidhen me individin, mjedisin familjar, mjedisin komunitar, ndjekjen dhe forcimin e sjelljeve pozitive, etj.

Parandalimi dhe ndërhyrja janë dy koncepte që dallohen nga njera tjetra nga koha dhe mënyra se si realizohen.

Parandalimi nënkupton marrjen e masave për të mos lejuar shfaqjen e problemit dhe drejtohet ndaj të gjithë popullatës. Përpjekjet parandaluese duhen fokusuar, para së gjithash, tek parandalimi i sjelljeve problematike të vazhdueshme tek fëmijët dhe duhet të përqëndrohen tek fëmija, familja, shkolla, dhe komuniteti.

Ndërhyrja realizohet me të miturit e rrezikuar apo të përfshirë në veprime kriminale me synim zbutjen apo eliminimin e fenomenit.

Hap i parë i rëndësishëm në këtë drejtim është evidentimi i situatës kriminale ku janë implikuar të mitur. Këtu përfshihet:

- Vlerësimi dhe analiza e informacionit mbi implikimin e fëmijëve në aktivitetet kriminal apo të dëmtuar nga aktiviteti kriminal;
- Evidentimi i fëmijëve që manifestojnë apo kryejnë vepra penale;
- Studimi i grup-moshave dhe faktorëve që nxisin përfshirjen në veprimtari kriminale;
- Trajtimi i zonave problematike ku fëmijët janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme.

Hap i dytë është planifikimi i veprimeve të koordinuara kundër akteve dhe sjelljeve kriminale me synime, objektiva, alternativa e detyra konkrete për strukturat rajonale dhe vendore të policisë si dhe nëpërmjet strategjive, programeve të përbashkëta të aktorëve shtetërorë dhe jo shtetërorë të kësaj fushe.

Bashkëpunimi ka për qëllim koordinimin e masave për të parandaluar tendencen për veprime kriminale të të miturve, me synim:

- Ndërhyrjen në mosha sa më të vogla, pasi parandalimi i hershëm ul mundësinë që të miturit të përfshihen në veprime kriminale;
- Krijimin dhe funksionimin e ekipeve multidisiplinare për realizimin e këtyre programeve, duke ju ofruar atyre masa mbrojtëse dhe rehabilitimi.

2. Forcimi i Policimit në komunitet

- Prania e punonjësve të policisë në shkolla;
- Kontaktet/bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore;
- Kontaktet/bashkëpunimi me komunitetin, familjet;
- Mbajtja e statistikave të sakta për të bërë politika parandaluese;
- Angazhimi i punonjësve të policisë të specializuar;
- Kontakte të vazhdueshme ndërsektoriale me strukturat e tjera që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijëve.

3. Legjislacioni për mbrojtjen e fëmijëve

- Kushtetuta;
- Konventat e ratifikuara;
- Kodi Penal dhe Kodi i Procedures Penale;
- Kodi i Familjes;
- Ligji për Policinë e Shtetit;
- Ligji për Dhunën në Marrëdhëniet Familjare;
- Aktet ligjore dhe nënligjore.

Strategjitë

- Strategjia kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve 2005-2010;
- Strategjia antitrafik 2005-2007 (planet e veprimit të hartuara për zbatimin e këtyre strategjive).

Shërbimet që ofron policia

- Shërbimi shëndetësor në rastet kur fëmija ka nevojë për ndihmë mjekësore të menjëhershme (fëmija dërgohet në institucione shëndetësore dhe njoftohet familja/kujdestarët);
- Konsulencë për familjet me fëmijë që kanë probleme me ligjin;
- Prezenca e punonjësit të policisë në mjediset shkollore, kryesisht në qendrat e mëdha urbane, për të garantuar mbarëvajtjen e procesit mësimor në shkolla, kontakte të uniformave blu me drejtorët, mësuesit dhe vetë të miturit;
- Prania e psikologut gjatë intervistimit të fëmijëve (në strukturën e 12 Drejtorive të Policisë në Qarqe bën pjesë një psikolog, i cili merr pjesë gjatë intervistimit të të miturve, të shoqëruar në mjediset e policisë.)

3. Referimi i rasteve brenda sektorit

- Informacioni i inspektorit të rendit (i cili vlerëson situatën) i referohet inspektorit të krimeve dhe komisariatit përkatës;
- Inspektori i krimeve heton procesin dhe merr masat që nevojiten. Nëse viktimi ka nevojë për ndërhyrje mjekësore, ai dërgohet në spitalin më të afërt për t'i dhënë ndihmën e duhur;
- Ndjekja e procedurave ligjore (marrja në pyetje e dëshmitarëve, ekzaminime mjeko-ligjore nëse ato janë të nevojshme për përcaktimin e nivelit të dhunës së ushtruar ndaj të miturit, vlerësimi i gjendjes së të miturit) dhe kalimi i çështjes në prokurori.

Protokolle për hapat që ndërmerren nëse identifikohet një fëmijë i dhunuar

Në rastet kur dhuna ndaj një fëmije përbën një vepër penale ekzistojnë protokolle të qarta për hapat që duhet të ndërmerren. Përgjegjëse është e gjithë struktura e policisë dhe në veçanti ajo e policisë kriminale. Ekzistojnë protokolle të qarta për dhënien e ndihmës mjekësore, por nuk ekzistojnë protokolle për dhënien e ndihmës sociale apo referimin e fëmijës në shërbime sociale apo qendra rezidenciale pritëse. (Qendrat rezidenciale ekzistojnë vetëm për fëmijët e trafikuar dhe fëmijët e abuzuar seksualisht.)

Bashkëpunimi i këtij sektori me sektorët e tjerë dhe mekanizmat e referimit

- Ekzistojnë marrëveshje për fëmijët e trafikuar dhe të abuzuar seksualisht. Në këto raste fëmijët dërgohen tek qendra e pritjes në Linzë;
- Bashkëpunim i fëmijëve e të rinjve të moshës deri 21 vjeç me Shoqatën për Zgjidhjen e Konfliktëve;
- Bashkëpunim me klinikën ligjore për të miturit, e cila siguron advokaci dhe asistencë psikologjike në të gjitha rastet që është e nevojshme (në rrethet e Tiranës, Shkodrës dhe Korçës);
- Bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore dhe drejtoritë e shkollave.

Si funksionojnë këto mekanizma në praktikë?

Deri tani bashkëpunimi me organizmat e lartpërmendura ka qenë efektiv. Mungon bashkëpunimi me strukturat e shërbimit social shtetëror dhe me strukturat lokale të bashkive për dhënien e asistencës sociale fëmijëve në nevojë. Për arritur një mbrojtje efektive të fëmijëve, kërkohet bashkëpunimi midis shërbimit social shtetëror, OJF-ve të ndryshme që operojnë në fushën e mbrojtjes së të miturve dhe seksioneve në bashki që merren me mbrojtjen e fëmijëve.

Pikat e forta

- Shërbimi policor është i shtrirë në të gjithë territorin;
- Ai funksionon me kohë të plotë (24 orë në ditë);
- Në dispozicion të qytetarëve është një numër telefoni pa pagesë, i cili është bërë publik;
- Është në proces forcimi i strukturave ekzistuese të mbrojtjes së fëmijëve;
- Për herë të parë, Akademia e Policisë ka përfshirë në kurrikulat e saj (viti 2005) tema të veçanta për njohjen dhe respektimin e standarteve ndërkombëtare dhe kombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve gjatë procedimit policor;
- Akademia e Policisë, në bashkëpunim me Sektorin për Mbrojtjen e Fëmijëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe mbështetjen e UNICEF-it, po zhvillon një cikël trajnimesh me struktura të policisë së të gjitha niveleve me tematikë “Mbrojtja e Fëmijëve”. Ky cikël është në zhvillim e sipër dhe në tetor është faza përfundimtare e tij.

Pikat e dobëta

- Mungojnë seksionet e veçanta të specializuara për të mitur në strukturat rajonale dhe vendore të policisë;
- Mungojnë marrëveshjet ndër-institucionale dhe unifikimi i shërbimeve, që sigurojnë mbrojtje multidisiplinare të të miturve të dëmtuar ose në risk, ndërmjet policisë, shërbimeve mjekësore, pushtetit lokal (lidhur me mundësinë e strehimit dhe shërbimeve të tjera sociale);
- Mungojnë mjediset e veçanta në komisaritet e policisë për të miturit që shoqërohen në këto ambiente;
- Numri i punonjëseve të policisë (femra) në strukturat vendore të policisë është mjaft i kufizuar në raport me atë të meshkujve.

Rekomandimet

- Përsheptimi i punës për nxjerrjen e akteve nënligjore për dhunën në familje;
- Rritja e kapacitetit të efektivave të policisë për identifikimin, raportimin, referimin dhe sigurimin e një mbrojtjeje emergjente për fëmijët në rrezik;
- Është në proces ngritja e seksioneve të veçanta, të specializuara për të mitur, në strukturat rajonale të policisë;
- Prezenca e punonjësit social krahas psikologut;
- Marrja e informacionit të plotë në lidhje me kushtet e jetesës personale, familjare dhe shoqërore të të miturit të implikuar në veprimtari kriminale; administrimi i këtij informacioni për të krijuar një bazë të dhënash elektronike, një proces ky që do të ndihmonte në përcaktimin real të politikave si ato policore edhe ato sociale;
- Rritja e besimit ndërmjet punonjësve të policisë dhe të miturve që vijnë nga familje me nivel të ulët ekonomik dhe arsimor, me qëllim orientimin e tyre drejt shërbimeve sociale dhe organizatave të ndryshme që operojnë në zonë;
- Të synohet që këto struktura të kenë efikasitetin e duhur për të garantuar bashkëpunimin dhe koordinimin midis strukturave policore, me qëllim parandalimin e dhunës dhe abuzimeve ndaj fëmijëve;
- Të synohet që, në përbërje të tyre, të përfshihen punonjës socialë apo psikologë me kohë të plotë;
- Të punohet për krijimin e mjediseve të veçanta në komisaritet e policisë për të miturit e shoqëruar në këto mjedise;

- Rritja e numrit të punonjësve të policisë (femra) në strukturat rajonale dhe vendore të policisë, pasi komunikimi dhe intervistimi i të miturit nga një punonjëse policie femër, në mënyrë të natyrshme i pakëson elementët traumatizues që lindin nga kontakti me policinë.

Për bashkëpunimin ndërsektorial

- Të realizohen trajnime në grupe të përbashkëta, në të cilat të marrin pjesë, gjyqtarë, policë, prokurorë, punonjës socialë përmes programeve të specializuara;
- Të synohet rritja e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të policisë dhe institucioneve të përfshira në mbrojtjen e fëmijëve (shërbimi arsimor, shëndetësor etj, si dhe OJF-të që ofrojnë shërbime edukuese dhe reintegruese);
- Në mënyrë të veçantë, në të gjithë territorin, të vendoset bashkëpunim me pushtetin lokal, në të cilin është e domosdoshme të ketë struktura organizative për mbrojtjen e fëmijëve në nevojë;
- Të përgatiten protokolle për përcaktimin e roleve dhe hapave që duhet të ndërmerren nga secili aktor si dhe të zhvillohen takime periodike të këtyre aktorëve.

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore: *(Lidhur me këtë çështje nuk pati diskutime, pasi në grup nuk kishte të pranishëm specialistë të kësaj fushe).*

Strukturat

1. Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz/Zëvendës Ministri i Brendshëm.

Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore është ngritur në Nëntor të vitit 2005. Kjo është hera e parë që Shqipëria ka një zyrë me një mandat të posaçëm për antitrafikimin. Ky është tregues për rëndësinë që qeveria shqiptare i jep kësaj çështjeje. Zyra e Koordinatorit Kombëtar është pika kyçe për koordinimin e përpjekjeve antitrafik të ministrive të ndryshme si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar.

Zyra e Koordinatorit Kombëtar ka një mandat të gjerë politik dhe një nivel të lartë pavarësie në marrjen e nismave të nevojshme në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Autonomia e saj bazohet në një Urdhër të Kryeministrit.

2. Në bazë të Urdhërit të Kryeministrit nr. 203, datë 19.12.2005, pranë Koordinatorës Kombëtare për Antitrafikun/Zv.Ministres së Brendshme, është ngritur **Njësia Anti-Trafik**, detyrat kryesore të së cilës janë:
 - a. Monitorimi i aktiviteteve të institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore;
 - b. Bashkërendimi i punës me këto institucione;
 - c. Mbledhja e informacioneve dhe të dhënave për çështje që lidhen me këtë dukuri, etj;

3. Autoriteti Përgjegjës për Mekanizmin Kombëtar të Referimit

Për të ndihmuar në forcimin e bashkëpunimit dhe për të krijuar një rrjet funksional, Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve të Jashtme dhe Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta kanë nxjerrë një urdhër të përbashkët për ngritjen e një Strukture Përgjegjëse e cila do të funksionojë si Mekanizëm Referimi Kombëtar. Kjo strukturë do të bashkërendojë procesin e referimit

për ndihmë dhe mbrojtje fillestare dhe rehabilitimin afatgjatë të viktimave të trafikimit, në bashkëpunim të ngushtë me ministritë e lartpërmendura, institucionet e tjera të përfshira si dhe qendrat strehuese të viktimave të trafikimit. Të gjithë aktorët e përfshirë në këtë Autoritet kanë rol vendimtar dhe përgjegjësi të barabarta për ndihmën që ata japin.

4. Komitetet Rajonale të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

Në nivel lokal, me Urdhër të Kryeministrit, janë ngritur Komitetet Rajonale të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, të cilët kryesohen nga Prefektët dhe kanë në përbërje të tyre kryetarët e bashkive, drejtorët të drejtorive të Shërbimeve Sociale Shtetërore, Zyrës së Punësimit, policisë, Shërbimit Informativ Shtetëror, Arsimit dhe Shëndetit Publik.

Këto Komitete janë ngritur për të ndihmuar agjencitë e zbatimit të ligjit për të identifikuar viktimat dhe viktimat potenciale të trafikimit si dhe për t'u siguruar atyre mbrojtjen dhe mbështetjen e menjëhershme.

Përveç identifikimit, referimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit, Komitetet Rajonale monitorojnë situatën e trafikimit në rajonin e tyre dhe identifikojnë masat që duhet të merren për të luftuar këtë krim. Për shembull, shumë Komitete Rajonale bëjnë fushata parandaluese në bashkëpunim me policinë, prokurorinë dhe shërbimet sociale për t'i nxitur fëmijët që të mos enden rrugëve por të rregjistrohen në shkollë.

5. Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit në Njerëz (QKPVT)

Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit në Njerëz (QKPVT), qendra e vetme shtetërore e pritjes për viktimat e trafikimit ka treguar gatishmëri dhe profesionalizëm për mbrojtjen dhe ndihmën për njerëzit viktimat të trafikimit.

Duhet theksuar se:

- a. jo të gjitha vajzat e strehuara në qendra janë viktimat të trafikimit; një pjesë e tyre janë vajza të shfrytëzuara për prostitucion dhe të kthyerat;
- b. numri i vajzave që bashkëpunojnë me policinë është ende i ulët;
- c. rehabilitimi i tyre afatgjatë në praktikë ka rezultuar i vështirë;

Kuadri ligjor

1. Janë ratifikuar:
 - a. Konventa e Kombeve të Bashkuara për Krimin e Organizuar Transnacional dhe dy protokollet e tij shtesë, si dhe
 - b. Konventa e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.
2. Ndryshime janë bërë edhe në Kodin e Proçedurës Penale në lidhje me përdorimin e Mjeteve Speciale të Hetimit (survejime, veprime të simuluar dhe agjentë të infiltruar).
3. Parlamenti ka miratuar një ligj për krimin e organizuar – Ligji për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, nr. 9284, datë 30.09.2004.
4. Në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, është miratuar Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, nr. 9205, datë 15.03.2004, i cili garanton mbrojtjen fizike dhe ligjore të viktimave të trafikimit.
5. Për të parandaluar migracionin e paligjshëm, në Kodin Penal është bërë një ndryshim në Nenin 298, i cili është miratuar nga parlamenti në ligjin nr. 9686, datë 26 shkurt, 2007. Ky nen penalizon kontrabandën e qenieve njerëzore përtej kufijve të Shqipërisë.

6. Propozimi i një neni të ri në Kodin Penal Shqiptar për shfrytëzimin e fëmijëve për punë të detyruar si dhe për shitjen e fëmijëve (përkatësisht, Neni 128/c dhe Neni 128/ç), i cili do të shoqërohet me një paketë të re social-edukative për ndihmën ndaj këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre në formën e punësimit, arsimit dhe llojeve të tjera të ndihmës.
7. Është nënshkruar një Marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për përfshirjen e temave mbi trafikimin në kurrikulat shkollore.

Të tjera

1. Baza e të dhënave

Është parë i domosdoshëm krijimi i një rrjeti të informacionit të harmonizuar dhe të unifikuar, i cili jep shifra të besueshme dhe të verifikueshme mbi trafikun e qenieve njerëzore duke mundësuar në këtë mënyrë analizimin e këtij informacioni për të patur një tablo të qartë të situatës së trafikimit në vend dhe për të mundësuar evidentimin në kohë të tendencave dhe dinamikës së fenomenit, në mënyrë që edhe përgjigjja e strukturave përgjegjëse ndaj tij të jetë e shpejtë dhe efektive. Për këtë qëllim po punohet në mënyrë intensive me strukturat brenda Ministrisë së Brendshme, si dhe me OSBE-në, për të përfunduar ngritjen dhe funksionimin e **një baze të dhënash** për njerëzit që janë viktimë të trafikimit, të referuara dhe të marra në mbrojtje nga Autoriteti Përgjegjës. Synimi i ngritjes së këtij sistemi do të bëjë të mundur që, përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe të Qendrave të Mbrojtjes së Viktimave të Trafikimit të regjistrojnë raste të viktimave të kthyer, të referuara, të trajtuara dhe të mbrojtura në Shqipëri.

2. Linja telefonike kombëtare pa pagesë

Ngritja dhe funksionimi i një linje telefonike kombëtare pa pagesë për denoncimin e rasteve të trafikimit, si dhe për informimin e të interesuarve mbi migracionin e rregullt, si një instrument parandalues dhe mbrojtës, erdhi si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Ministrisë së Brendshme, IOM dhe UNODC. Nga kjo linjë përfiton e gjithë shoqëria për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Ajo u vu në dispozicion të publikut në ditët e para të muajit nëntor.

3. Kodi i Sjelljes për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në turizëm

Në funksion të kontrollit të trafikimit të fëmijëve brenda vendit, një zhvillim pozitiv ka qenë nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Prezencës në Shqipëri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për promovimin dhe zbatimin e Kodit të Sjelljes për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në turizëm.

Në këtë memorandum, në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet tyre, palët marrin përsipër një sërë detyrimesh si: Përfshirjen në Kodin Global të Etikës edhe Kodin e Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm si pjesë e Rregullores së Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve lidhur me procedurat e dhënies ose heqjes së licensave dhe rregullave për kualifikimin/standartizimin e shërbimeve të ofruara nga operatorët turistike në Shqipëri.

4. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar është thelbësor në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Duke marrë në konsideratë këtë fakt, me nismën e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar të Luftës kundër Trafikimit

të Qenieve Njerëzore, u nënshkrua Marrëveshja me Greqinë për Mbrojtjen dhe Asistencën e Fëmijëve-Viktima të Trafikimit. Ky është ndër hapat më të rëndësishëm në këtë aspekt.

Kjo Marrëveshje u ratifikua nga Parlamenti Shqiptar në Maj të vitit 2006 dhe, së shpejti, pritet ratifikimi i saj edhe nga Parlamenti Grek. Kjo Marrëveshje i hap rrugën fillimit të identifikimit dhe kthimit në Shqipëri të fëmijëve shqiptarë që ndodhen në Greqi.



Grupi Ndërsektorial



Anëtarët e grupit të punës:

1. Brixhida Xheka, Shoqata Kombëtare “Edukim për Jetën”
2. Merita Meçe, Terre des Homes
3. Vaslemy Naerland, Save the Children
4. Jeremy Berlando, Ekpert
5. Dajana Berisha, Ministria e Punëve dhe Çështjeve Sociale
6. Doriona Veli, Aleanca për Fëmijët
7. Teitt Tabaku, “Tjetër Vizion”
8. Dhionis Vllaku, “Partnerë për fëmijët”
9. Arda Lazareni, Ministria e Punëve dhe Çështjeve Sociale
10. Izela Tahsini, Shoqata Kombëtare e Punonjësve Sociale
11. Milika Dharmo, Departmenti i Psikologjisë dhe Edukimit, Faculteti i Shkencave Sociale
12. Vasilika Laçi, “Terre des Hommes”
13. Miranda Pashaj, Ministria e Punëve dhe Çështjeve Sociale, Sektori Teknik
14. Marçela Bardhi, Terre des Hommes
15. Lavdrim Shehu, VMA-Kukes

Rekomandime

Më poshtë janë rekomandimet që dolën si rezultat i grupit të punës ndërsektorial. Duhet marrë parasysh pikat e mëposhtme:

Legjislacioni dhe Politika

- Të përmirësohet legjislacioni në fushën e mbrojtjes së fëmijëve (aktet normative, nënligjore, etj.) Në të mund të specifikohet: paketa ligjore e mbrojtjes së fëmijëve.
- Të përcaktohen protokollat dhe procedurat e sakta dhe mandate të qarta ligjore për ata që punojnë me fëmijët (punonjës social në bashki; në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit në nivel lokal) për të ndihmuar ose mbrojtur fëmijën.
- Ndërhyrja nuk përcaktohet me ligje apo protokolle fikse. Ndërhyrja ose sikurse quhet ndryshe “plani i trajtimit” është individuale dhe përcaktohet nga këshilluesi. Në shumicën e rasteve ai standardizohet në kushtet ku veprojnë bordet e etikës, apo struktura që mbulojnë shpenzimet e këshillimit. Këtu bëhet fjalë për protokolle të referimit të fëmijëve nga një shërbim tek tjetri (arsimor, shëndetësor, policor drejt shërbimit psikologjik dhe social, shërbimi psikosocial drejt shërbimeve ligjore për fëmijët, shërbimet ligjore drejt shërbimeve permanente sociale).
- Të përcaktohen rregullat apo protokollat e bashkëpunimit ndërmjet gjithë sektorëve si dhe të hartohen manualat udhëzuese për koordinimin ndërsektorial midis strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve.
- Të zbatohet ligji për fëmijët që vuajnë nga fenomeni i gjakmarrjes. Ata gëzojnë të drejtën për arsimim. Kjo çështje merr një rëndësi të veçantë. Shteti duhet të marrë masa që të sigurojë zbatimin e dispozitave përkatëse, në mënyrë të veçantë përgjegjësitë e Drejtorive Arsimore për identifikimin dhe arsimimin e këtyre fëmijëve.
- Të shndërrohen të dhënat në politika të mbrojtjes së fëmijëve nga strukturat përgjegjëse. Duhet të fuqizohen organizatat dhe strukturat bamirëse që ofrojnë shërbime social.

Ngritja e Strukturave institucionale dhe funksionimi i tyre

- Të krijohen njësitë për mbrojtjen e fëmijëve në nivel lokal dhe në nivel qarku dhe të përcaktohet mandatimi i tyre për ndërhyrje (personat me arsimimin dhe përvojën e duhur për mbrojtjen e fëmijëve);
- Të përcaktohen mandatete, ndarja e detyrave dhe përgjegjësive për personat që punojnë me fëmijët;
- Të shkëmbehet informacion i strukturuar ndërmjet të gjitha niveleve.
- Të qartësohet roli i shoqërisë civile.

Ofrimi i shërbimeve

- Të bëhet vlerësimi individual. Jo çdo rast ka nevojë për referim. Të jemi proaktivë dhe të flasim për referimin në shërbime të specializuara dhe jo kufizimin e tij;
- Fëmijët të trajtohen nga një ekip multidisiplinar (të përbërë nga punonjës socialë, psikologë, juristë, mjekë) sa herë që është e nevojshme;
- Të ekzistojnë struktura dhe mjete për monitorimin dhe vlerësimin e punës.

Shoqërimi i fëmijës me dosjen personale nënkupton dosjen e raportimit, kur rasti identifikohet në të gjithë sektorët. Por kjo nuk është kaq e lehtë. Shtrohet pyetja: A do të përcillet fëmija me gjithë dosje nga një shërbim tek tjetri? Fëmija nuk duhet të referohet tek shërbimi tjetër, duke u bazuar në shqetësimin fillestar. Dosja e shoqëron fëmijën vetëm në rastet kur përcillet brenda të njëjtit shërbim (nga një shërbim social tek një tjetër, nga një psikolog tek një psikolog tjetër).

Ngritja e Linjës telefonike pranë Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve duhet të zbatohet parimi i konfidencialitetit dhe të nënvizohen sanksionet ndëshkuese në rastet kur shkelet ky parim.

Ngritja e Kapaciteteve

- Të fuqizohen strukturat ekzistuese në bazë;
- Të rriten niveli profesional i specialistëve që punojnë me fëmijët (trajnim i vazhdueshëm për të gjithë ata që punojnë me fëmijët);
- Të ndërjegjësohet opinioni publik dhe profesionistët mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Mekanizmat e nevojshme të referimit ndërsektorial janë:

- Të përcaktohen protokollet dhe procedurat e sakta si dhe mandate të qarta ligjore për ata që punojnë me fëmijët (punonjës social në bashki; në sektorin e shëndetësisë dhe arsimin në nivel lokal) për të ndihmuar dhe mbrojtur fëmijën;
- Të përcaktohen rregullat apo protokollet e bashkëpunimit ndërmjet gjithë sektorëve;
- Të hartohen manualët udhëzues për koordinimin ndërsektorial për strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve;
- Të shkëmbehet informacion i strukturuar ndërmjet të gjitha niveleve.
- Të ndërjegjësohet opinioni publik dhe profesionistët mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

28

Seancë pyetje – përgjigje

Pyetje: Si e shikon grupi i shëndetit çështjen e motivimit të stafit shëndetësor sepse sektori i shëndetësisë mund të ketë burime dhe trajnime, por ai mund të mos jetë i motivuar për ta kryer punën me përkushtim?

Përgjigje: Motivimi i personelit shëndetësor është në kuadrin e të gjithë politikave shëndetësore që po ndërmerren nga institucionet shëndetësore.

Pyetje: Në disa prezantime doli nevoja e bashkëpunimit të sektorëve të ndryshëm në përpjekjet që bëhen për mbrojtjen e fëmijëve. Si mund të institucionalizohet kjo?

Përgjigje: Kjo është një nga pikat më të nxehta dhe më urgjente dhe është objekt i një diskutimi të gjatë dhe urgjent midis institucioneve të ndryshme që merren me mbrojtjen e fëmijës.

Sugjerim: Të futet koncepti i shkollave mike për fëmijët pasi ato i përfshijnë të gjitha tematikat që u trajtuan në konferencë. Kjo ide është në mbështetje të ngritjes dhe funksionimit të grupeve shumësektoriale.

Sugjerim: Lidhur me manaxhimin e informacionit në bazë shkolle, të futet edhe ruajtja e informacionit elektronik me bazë komunitare. Pra shkolla të marrë informacion nga shoqëria civile por edhe të japë informacion.

Sugjerim: T'i kushtohet rëndësi e veçantë punonjësit social në shkollë, pasi ai është shumë i rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Problem: Rregjistrimi në shkolla është shqetësim për shumë OJF, dhe në shumë komunitete, veçanërisht për fëmijët romë dhe egjiptianë.

Përgjigje: Ka program pune edhe në strategjinë kombetare të MASH si për nxënësit romë edhe për fëmijët e rrugës.

Koment dhe sugjerim: Në shumicën e prezantimeve u theksua nevoja e psikoterapisë, por kjo është një punë shumë e kualifikuar që mësuesi nuk mund ta bëjë. Në fund të fundit kjo nuk është detyrë e mësuesit. Shkolla është vendi më i përshtatshëm për zbatimin e programeve për mbrojtjen e fëmijëve. Nëse ju nuk arrini dot që të bëni programet tuaja, mund të kopjoni programet e ndërhyrjes nga vende të tjera.

Pyetje: Ligji i arsimit për të gjobitur prindët kur nuk i dërgojnë fëmijët e tyre në shkolla nuk funksionon. Si keni menduar ta zgjidhni këtë problem për të mos i lënë fëmijët jashtë shkollimit?

Përgjigje: Dispozita ligjore ka. Ka komuna që e zbatojnë, ka që nuk e zbatojnë. Ardhja e popullsisë nga rrethet e tjera të vendit në kryeqytet ose nga fshatrat në qytete të tjera e bën këtë problem të vështirë sepse mungojnë adresat e tyre.

Pyetje: Në kushte kur decentralizimi ende nuk po funksionon si duhet, si do t'i trajtojë shkolla problemet që ka në këtë drejtim?

Përgjigje: Dispozitat normative po rishikohen; ka vakum për nxënësit, mësuesit dhe prindët. Shkollës nuk i është dhënë ajo shkallë decentralizimi që i duhet. E njëjta gjë është edhe për pushtetin lokal. Nëse këtë buxhet minimal do ta kishte një drejtor shkolle, ai mund ta shpenzojë për përmirësimin e punës në shkollë. Nevojat ndryshojnë nga një shkollë në tjetrën. Është kërkuar që shkollat dhe bashkitë të punojnë bashkë.

Pyetje: Emërimet dhe ç'emërimet i personelit mësues bëhet nga Drejtoritë Arsimore. A ndjeheni mirë me këtë mënyrë pasi kjo ka të bëjë me performancën dhe cilësinë e mësimit?

Përgjigje: Aktualisht kjo është një nga pikat e dobëta të arsimit sot në përgjithësi. Ka ende mësues që janë të pakualifikuar e që nuk mund t'i kuptojnë dhe mbështesin si duhet përpjekjet që po bëhen për mbrojtjen e fëmijëve. Drejtori duhet të jetë menaxher kryesisht për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Është diskutuar që të ketë një bord arsimor që ta zgjedhë drejtorin me konkurs; po kështu edhe mësuesin. Është përgatitur një draft që do të diskutohet së shpejti. Në shkollën tonë fëmija flet hapur për mësuesin dhe jo në mënyrë anonime.

Ka kërkesa nga nënat e reja për trajtimin e fëmijëve. Tani 50 % dhunohen nga nënat (krahasuar me 10 vjet me parë ku fëmijët dhunoheshin kryesisht nga baballarët.) Kjo nënkupton se nënat e reja duhet të trajtohen se si të merren me fëmijët e tyre.

Koment: Kur flasim për trajnimin dhe kualifikimin e mësuesve, drejtuesve, përfshihen të gjitha llojet e trajnimit. Është punuar me mësuesit e gjithë Shqipërisë dhe me fakultetet që përgatisin mësues dhe janë përfshirë në kurrikul tema mbi të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre. Janë lënë edhe 2 orë në javë në arsimin 9 vjeçar për këto tema.

Për fëmijët romë janë zhvilluar aktivitete trajnuese dhe është krijuar një rrjet kombëtar me informacion mbi popullsinë romë bazuar në të dhënat lokale. Në këtë grup përfshihen edhe prindërit. Punohet me ta me qëllim që të kemi rezultate me fëmijët.

Koment: Është i rëndësishëm angazhimi i komunitetit, që edhe ai të thotë fjalën e tij për problemet që ka shkolla dhe që të arrihen objektivat që janë përcaktuar.

Koment: Qeveria e nxënësve mund të ulë dhunën në shkolla. Qeveria e nxënësve është partnere e rëndësishme në këtë lëvizje. OJF-të janë angazuar në këtë drejtim. Qeveritë e nxënësve i shohin disa gjëra më ndryshe nga ne dhe mund të na ndihmojnë.

Pyetje: Cila është detyra e medias për të na mbështetur në këtë nismë të rëndësishme?

Përgjigje: Media jonë e shkruar dhe elektronike pothuaj nuk ka gazetarë socialë. Detyra e medias është ajo e investigatorit publik. Shpesh ajo loz një rol negativ duke dhënë detaje, duke përgojuar raste, duke i sjellë në këtë mënyrë një dëm të konsiderueshëm çështjes në fjalë. UNICEF ka investuar për trajnimin e gazetarëve.

Shqetësim: Në shumë raste punonjësit socialë nuk mbështeten sa duhet në punën e tyre. Fakulteti i Punës Sociale është fakulteti kryesor që përgatit punonjësit socialë, që i pajis ata me njohuri dhe jo akademizëm sikurse pretendohet në ndonjë rast. Ndaj kërkojmë mirëkuptimin e të gjithëve që t'i mbështesni punonjësit socialë që janë të rinj, me qëllim që edhe ata të bëhen të vlefshëm.

Pyetje: Po punohet për hartimin e strategjisë kombëtare për shërbimin social pranë bashkisë. Sa hapa janë bërë dhe sa ekspertë janë përfshirë në këtë nismë? Shpesh përfshihen ekspertë që nuk kanë dijeni fare për problemin.

Përgjigje: Fillimisht duhen sqaruar termat. Strategji, sipas gjykimit tim, është një plan afatgjatë. Të gjitha këto bashki dhe komuna hartojnë politika rajonale të cilat përfshihen në këtë strategji. Njësia për sektorin e shërbimeve sociale në bashki, në bashkëpunim me sektorin e arsimit, po punon për të bërë një strategji. Sapo të përfundojë drafti i parë, ajo do të diskutohet në një grup më të madh specialistësh.



Konkluzione përfundimtare

- Në këtë konferencë pjesëmarrësit u përpoqën që t'i bëjmë sistemit tonë një operacion vertikal në nivel politikëbërësish, roleve të Ministrive e me radhë;
- Në nivel horizontal pati shumë debat. U theksua që është e rëndësishme që të krijohen raporte të reja bashkëpunimi;
- Pika kryesore e sistemit të ri të jetë ridimensionimi i pushtetit lokal;
- Parësor është DECENTRALIZIMI I PUSHTETIT LOKAL, vendosja e tij në rolin që i takon në shërbimet sociale;
- Të gjithë sektorët janë të rëndësishëm dhe duhet të përfshihen të gjithë, POR duhet arritur sinergji midis sektorëve;
- Nevojiten burime për zbatimin e rekomandimeve të bëra;
- Duhet gjetur mënyra më efikase për angazhimin e medias;

Cilat janë hapat e mëtejshme?

- Komiteti Këshillimor të shqyrtojë dhe të gjejë mënyrat për zbatimin e Rekomandimeve;
- Të përgatitet një raport përfundimtar i cili do të përfshijë diskutimet dhe rekomandimet e bëra nga sektorë të ndryshëm;
- Ky raport t'u dërgohet Ministrive përkatëse në rrugë elektronike dhe krahas rekomandimeve të vendosen edhe Institucionet përkatëse;
- Në çdo Ministri të caktohet një pikë kontakti që të merret me zbatimin e rekomandimeve të bëra në konferencë dhe ato të mos mbeten thjesht në letër, por të mendohet se ç'detyrime ka secila Ministri për zbatimin në praktikë të këtyre rekomandimeve.



Lista e pjesëmarrësve në konferencë

Nr.	Name/Surname	Name of the organization	Email
1	Jeremy Berland	(Qeveria Kanadeze)	jbernard@shaw.ca
2	Dhionis Vllaku	Partnere për Fëmijët	denisvllahu1@yahoo.com
3	Rigers Gjoka	Sh.K.B. Sh.	rigersgjoka@yahoo.com
4	Xheladin Qahi	Q.K.P.V.T.	qkombetare@yahoo.com
5	Suela Hana	Q.K.P.V.T.	sulahana@yahoo.com
6	Izela Tahsini	Shoqata Kombëtare e Punonjësve Sociale	irelat@yahoo.com
7	Mariana Meshi	Të ndryshëm dhe të barabartë	mmeshi@yahoo.com
8	Rovena Bregu	Hope and homes	rovenabregu@yahoo.com
9	Erjona Kapllanaj	Hope and homes	albaniachildren@yahoo.com
10	Albana Maliko	ShSSH.	amalikogjG@yahoo.com
11	Çerçiz Loloçi	SOROS	cerciz@galas.com
12	Myzejene Zejnati	MPÇSSHB	jena29_82@hotmail.com
13	Anisa Subashi	Drejtoria Arsimore e Tiranës	anisubashi@yahoo.com
14	Arjan Kurti	Ministria e Brendshme	
15	Nuri Loca	Ministri e Brendshme	
16	Vasilika Laci	TdH	vasilika.loci@tdhalbania.org
17	Marcela Bardho	TdH	marcela.bardho@tdhalbania.org
18	Alketa Drenova	Every Child	alketak@yahoo.com
19	Lirije Gjana	S.M.T, Kukës	lirijegjana@yahoo.com
20	Bilbil Keraj	Bashkia Kukës	bilbil.keraj@yahoo.com

21	Tatjana Kondi	Ministria e Financave	tianofilko@yahoo.com
23	Miranda Mulgeci	SHIS Tirana	
24	Amarilda Kadriu	ShSSH, Tirana	amarildakadriu@yahoo.com
25	Anila Kristani	Gj. Br. Tirana	gkristani@yahoo.it
26	Migena Kika	QKMZHRF	bedenimigena@hotmail.com
27	Erla Gjokolli	ATSH	ergjokolli@hotmail.com
28	Anila Selmani	MPÇSSHB	
29	Mimoza Bajrami	MPÇSSHB	mozbajrami@yahoo.com
30	Ilda Poda	MPÇSSHB	ildapoda@yahoo.com
31	Sabina Çarçani	Amici dei bambini	aibialbania@gmail.com
32	Arda Lazareni	MPÇSSHB	ardalazareni@yahoo.com
33	Mimoza Malushaj	Forumi i Grave, Elbasan	forumi_gruas@yahoo.com
34	Rezarta Abdiu	QSHPLI	legalclinic@albaniaonline.net
35	Blerina Metaj	CRCA	crc@crca.org.al
36	Alma Kordoni	CRCA	alma@crca.org.al
37	Alpina Qiriazi	DEID	a-qiriazi@dfid.gov.uk
38	Alfred Çerepi	Avokati i Popullit	a_cerepi@yahoo.com
39	Marco Conte	VIS Albania	vistirana@albaniaonline.net
40	Rosalba Pastena	VIS Albania	vistirana@albaniaonline.net
41	Artan Broci	Gjykata e Tiranës	broci_artan@yahoo.it
42	Francesca Fondi	Kooperacioni Italian	francescafondi@esteri.it
43	Delphine Freymann	Këshilli i Evropës	delphine.freymann@coe.int
44	Shefki Lika	Bashkia Elbasan	
45	Ditika Shehi	MCMCM	chabuse@albaniaonline.net
46	Tomas Stravinska	OSBE	tomas.stravinska@osce.org
47	Almanduza Guma	SOS fshatrat	almanduza@soskd.org.al
48	Spiro Cionxis	Ambasada Greke	
49	Maria Esposito	Delegacioni i Komisionit Evropian	maria.esposito@ec.europa.eu
50	Rajmonda Bozo	BKTF	rbozo@tlas.org.al
51	Enkelejda Sula	SDC	enkelejdasula@sdcc.net
52	Galsvinda Fili	"The experts"	
53	Robert Stratobërdha	Ndihmë për fëmijët	robert_npf@hotmail.com
54	Oliana Ifti	ShSSH	olijana_ifti@yahoo.com
55	Marilda Menkshi	Avokati i Popullit	nancy2mary@yahoo.com
56	Esin Gjurgji	Unicef	esin_gjurgji@hotmail.com
57	Elidjana Metani	ACA, Tirana	admin@crca.org.al
58	Nedine Ceka	Ministria e Shëndetësisë	admin@crca.org.al
59	Pranvera Shehu	Ministria e Shëndetësisë	--
60	Jason Evans	World Vision Albania	jason_evans@wvi.org
61	Naum Kelli	RTVSH	
62	Antonello Assenti	CIES	cies@icc.al.org
63	Miranda Spahiu	MSH	mspahiu@mak.gov.al
64	Anduena Gega	NTV	--
65	Dritan Deda	DPQ, Tirana	--
66	Suela Kusi	MTKRS	kusisuela@yahoo.com
67	Aurora Bushati	UNICEF	abushati@unicef.org
68	Illir Zhurka	Drejtorja e Policisë, Tirana	izhurka@hotmail.com
69	Mirela Salla	Tjetër Vizion, Elbasan	miras_el@hotmail.com
70	Kelly Kronen	USAID	keronen@usaid.gov

71	Gjergj Lulaj	DSSHS, Lezha	--
72	Manuel Lackaj	Zyra Rajonale, Lezhë	
73	Erinda Shah	FSHS	
74	Manuela Murthi	SOS	manuelamurthi@sos.org.al
75	Valerie Moretti	City of Como	lunaebissi@yahoo.com
76	Greta Mato	IKT	e_celuata@hotmail.com
77	Lantona Sado	SRC – INSTAT	lsado@mstat.gov.al
78	Alma Metko	SHKBSH	ametko@gmail.com
79	Zana Lita	PAMECA	zanalita@hotmail.com
80	Manuela Bello	UNFPA	mbello@unfpa.org.al
81	Aleksandra Mauche	UNICEF	alex3936@hotmail.com
82	Erlinda Gorishti	SHSSH	erindah@yahoo.com
83	Aida Nova	SOS	aidanova72@yahoo.com
84	Erjona Kapllanaj	NHC	albaniachildren@yahoo.com
85	Servete Qaniu	SHSSH	--
86	Anxhela Bardhyli	Përkthyesë	abardhyli@yahoo.com
87	Gëzim Turdiu	SHSSH	--
88	Suada Lazimi	APRAD	aprad_oaprad_05@yahoo.com
89	Violeta Xhanani	Shkolla “Sabaudin Gabrani”	violetaxhanani@yahoo.com
90	Kadri Alia	Shoqëria e Jetimëve	--
91	Suzana Sakiqi	Every child	ssakiqi@yahoo.com
92	Brend Mur	COE	bmusri@cde.ct.org
93	Ruben Vellina	TdH	
94	Abele Kamminga	Ambasada Hollandeze	abele.kaminga@minbuz...?
95	Rovena Prifti	INSTAT	rprifti@instat.gov.al
96	Doriana Veli	Aleanca për Fëmijët në Shqipëri	dorianapapa@yahoo.com
97	Leonard Guni	FBSH – DN	fbsh_dn@yahoo.com
98	Dafina Kavaci	NjPÇSSHB	dafinakavaci@yahoo.com
99	Selema Dushku	SHSSH	selema_i@yahoo.com
100	Adila Zifa	SOS fshatrat e fëmijëve	
101	Orjola Çaçellari	SHSSH	acacellari@yahoo.it
102	Eralda Methasani	Qendra “Fëmijët sot”	eraldamethasani@yahoo.com
103	Anilda Gurakuqi	AV POP Shkodër	agnaturqi@yahoo.com
104	Nexhedin Drenova	MPÇSSHB	--
105	Merita Meçe	TdH	mmece_terre@yahoo.com
106	Lumturi Mësheni	ISHP	lumturimesheni@hotmail.com
107	Nirdeta Çupllari	Bashkia Korçë	--
108	Mariela Sino	TdH	m_simo14@yahoo.com
109	Alfred Koçobashi	Avokati i Popullit	alfredkocobashi@yahoo.com
110	Mihal Naço	Drejtoria e ShSSH	nacomihal@yahoo.com
111	Skënder Veliu	Unioni Amara Drom	--
112	Soniana Simoni	IKT	--
113	Eriketa Korini	Ministria e Drejtësisë	eriketa_korini@yahoo.com
114	Bledina Bushi	SHIS	--
115	Julia Gallo	CESAL	lgallo@cesal.org
116	Eriola Sulejmani	SHIS	ertola@hotmail.com
117	Simone Andreozzi	AVSI	
118	Alex Finnen	OSBE	alex.finnen@osce.org
119	Rahel Besch	Kooperacioni Zviceran për Zhvillim	rahel.bosch@sdc.net

120	Juliana Rexha	OSBE	juliana.rexha@osce.org
121	Edlira Ngjeçi	OSBE	edlira.ngjeci@osce.org
122	Arenca Dhamo	UT/Bethany	mdhamo@albmail.com
123	Alma Sefaj	IOM	asefa@iomtirana.org.al
124	Holta Koçi	IOM	hkoci@iomtirana.org.al
125	Anila Sulstarova	UT	anilasulstarova@gmail.com
126	Gladiola Musabelliu	Bashkia e Tiranës	gladiolamusabelliu@yahoo.com
127	Migena Spaho	Bashkia e Tiranës	migenaspaho@yahoo.com
129	Nikoleta Garufo	CEFA Albania	garufo@hotmail.it
130	Paola Pinto	CEFA Albania	pafao@libero.it
131	Teit Tabaku	Tjetër vizion	tjetervizion@gmail.com
132	Zamira Muça	SH.K.E.J	shkej@albmail.com
133	Mirela Andreozzi	SH.K.E.J	shkej@albmail.com
134	Brixhida Xheka	SH.K.E.J.	shkej@albmail.com
135	Elda Kalaja	Avokati i Popullit	ekalaja@avokatiipopullit.gov.al
136	Anila Nepravishta	Avokati i Popullit	anepraqvishta@avokatiipopullit.gov.al
137	Rika Podo	Avokati i Popullit	rpodo@avokatiipopullit.gov.al
138	Mirela Mena		
139	Florenc Qosja	Ambasada Austriake	florenc.qosja@ada.gv.at
140	Vilma Premti	MPÇSSHB	v-premti@yahoo.com
141	Gledis Gjipali	MIE	ggjipali@yahoo.com
142	Anduena Shkurti	Save the children	
143	Shpresa Spahiu	Ndihmë për fëmijët	npftirana@icc-al.org
144	Jorida Ilhal	TIKA	--
145	Murat Akarsu	TIKA	--
146	Artur Rohmani	OSHMI	--
147	Natassa Arapidou	ARSIS	infotirana@arsis.gr
148	Albana Demirxhiu	MSH	ademirxhiu@moh.gov.al
149	Arta Vorpsi	Gjykata Kushtetuese	arta.vorpsi@gjk.gov.al
150	Erion Likaj	MPÇSSHB	erion_likaj@yahoo.com
151	Jonuz Kola	VMA Kukës	--
152	Helidon Shehu	VMA, Kukës	--
153	Etleva Veliu	Aksion +	evaveliu@hotmail.com
154	Adem Tamo	Universiteti i Tiranës	hdc@abissnet.com.al
155	Blerina Zoto	SHSSH, Tepelena	
156	Marçel Laçaj	Zyra Rajonale e ShSSH, Lezhë	mlacaj@yahoo.it